



Instituti i Kosovës për Drejtësi
Kosovo Law Institute
Kosovski Institut Pravde

AMNISTIA E KRIMEVE TË LUFTËS NË KOSOVË

Prishtinë, shtator 2020.

Autorët: Sabina Pergega, Mirvet Thaqi dhe Medina Kadriu

Ekipi redaktues: Betim Musliu, Ehat Miftaraj, Gzim Shala dhe Yll Zekaj

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Institutit të Kosovës për Drejtësi - IKD dhe ajo nuk pasqyron pikëpamjet e Byrosë së Narkotikëve Ndërkombëtar dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL) - Departamenti i Shtetit Amerikan dhe NED-it.

Ky botim është produkt i projektit “Kërko Drejtësi: Fuqizimi i qasjes në drejtësi në Kosovë”, i cili mbështetet nga Departamenti i Shtetit Amerikan përmes Byrosë Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL) dhe zbatohet nga Instituti i Kosovës për Drejtësi – IKD në partneritet me Iniciativa për Progres – INPO.

RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD

Rr. Rustem Statovci

Prishtinë

E: info@kli-ks.org

www.kli-ks.org

Shtator, 2020

Prishtinë, Republika e Kosovës

Përkrahur nga:



**National Endowment
for Democracy**
Supporting freedom around the world

Përmbajtja

1.	Përmbledhje ekzekutive	5
2.	Metodologjia	7
3.	Nocioni i krimeve kundër të drejtës ndërkombëtare	8
3.1.	Përgjegjësia penale për krimet kundër të drejtës ndërkombëtare	8
3.2.	Kuptimi i krimeve të luftës sipas akteve ndërkombëtare	10
3.3.	Krimet e luftës sipas legjislacionit të Republikës së Kosovës	13
4.	Fakte mbi luftën në Kosovë për periudhën 1998-1999	16
5.	Tribunali i Hagës për krimet në Ish-Jugosllavi	17
6.	Organizimi i sistemit gjyqësor në Kosovë pas vitit 1999	19
7.	Trajtimi i krimeve të luftës nga misioni i UNMIK-ut	21
7.1.	Performanca e UNMIK-ut në trajtimin e krimeve të luftës në Kosovë	21
8.	Trajtimi i krimeve të luftës nga misioni i Bashkimit Europian (EULEX)	24
8.1.	Performanca e EULEX-it në trajtimin e krimeve të luftës në Kosovë	25
9.	Trajtimi i krimeve të luftës nga autoritetet e Republikës së Kosovës	28
9.1.	Performanca e sistemit kosovar të drejtësisë në trajtimin e rasteve të krimeve të luftës	30
9.1.1.	Ngarkesa e PSRK-së më lëndë të krimeve të luftës gjatë viteve 2016, 2017, 2018 dhe 2019	30
9.1.2.	Ngarkesa e DKR-ve të GjTh më lëndë të krimeve të luftës gjatë viteve 2017, 2018 dhe 2019	33
9.2.	Strategjia e KPK-së për Krime të Luftës	37
10.	Trajtimi i krimeve të luftës sipas etnisë	40
11.	Krimet makabre pa përgjegje nga drejtësia	42
12.	Trajtimi i krimeve të luftës nga perspektiva e familjarëve të viktimave	45
13.	Themelimi dhe aktiviteti i Gjykatës Speciale	57
14.	Adresimi i hetimit dhe gjyimit të krimeve të luftës në adresë të gabuar	61
15.	Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rasteve të krimeve të luftës	64
16.	Anex 1: Analizë e detajuar e rasteve karakteristike që kanë përfunduar me aktgjykim të formës së prerë	73
17.	Anex II: Analizë e detajuar e rasteve karakteristike që janë në proces	86
18.	Historiku i disa rasteve të tjera të krimeve të luftës	115
19.	Rekomandimet	123

LISTA E SHKURTESAVE

IKD	Instituti i Kosovës për Drejtësi
KPRK	Kodi Penal i Republikës së Kosovës
KPPK	Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës
KPK	Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës
KPPPK	Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale i Kosovës
KRPRK	Kodi i Ri Penal i Republikës së Kosovës
PSRK	Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës
KPK	Këshilli Prokurorial i Kosovës
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
GjTh	Gjykata Themelore
PTh	Prokuroria Themelore
EULEX	Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë
GjEDNj	Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
KEDNJ	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
UNMIK	United Nations Mission in Kosovo/ Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë
NHKL	Njësia për hetimin e krimeve të luftës të Policisë së Kosovës
UÇK	Ushtria Çlirimtare e Kosovës
RSFJ	Republika Socialiste. Federative e Jugosllavisë
EUROPOL	The European Union Agency for Law Enforcement Cooperation
INTERPOL	The International Criminal Police Organisation
CIVPOL	Policia Civile (UNMIK)
KFOR	Forca e Kosovës (NATO)
KB	Kombet e Bashkuara
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PSSP	Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm
SEGJ	Sistemi Emergjent Gjyqësor
ShM	Shefi i Misionit të EULEX-it
RAE	Komuniteti Rom, Ashkali dhe Egjiptas

1. Përmbledhje ekzekutive

Sipas Fondit për të Drejtën Humanitare dhe Fondit për të Drejtën Humanitare Kosovë, në Luftën në Kosovë janë vrarë ose janë zhdukur gjithsej 13.535 njerëz, ndërsa si pasojë e kësaj lufte, vlerësohet se janë edhe gjithsej një mijë e gjashtëqind (1.600) persona të pagjetur. Krahas vrasjeve dhe humbjeve në jetë njerëzore, vlerësohet se janë shkatërruar më se 188 mijë objekte banimi dhe janë dëbuar me dhunë nga Kosova më se 1 milion banorë. Ndërsa, si pasojë e luftës në Kosovë, edhe pse nuk ka një shifër zyrtare, nga zyrtarë qeveritarë dhe analistë vlerësohet se mbi 22 miliardë euro është kostoja e dëmeve të luftës që Serbia ka shkaktuar në Kosovë para dhe gjatë luftës së fundit (1990-1999).

Aktakuzat e para për krime lufte ishin ngritur nga prokurorët vendorë në vitin 1999, menjëherë pas përfundimi të luftës. Nga viti 1999 deri në vitin 2000, nga prokurorët vendorë janë ngritur aktakuza ndaj 29 serbëve, një (1) shqiptari, dhe tre (3) malazezëve. Por, për shkak të pranisë jo e madhe të komuniteteve pakicë në sistemin e gjyqësor, si dhe fakti se në cilësinë e të akuzuarve për veprat penale të krimeve të luftës kanë qenë kryesisht serb, ishin ngritur shqetësime për anshmëri të gjyqësorit dhe prokurorisë vendore gjatë fazës së Sistemit Emergjent Gjyqësor (SEGJ), për të cilën arsye UNMIK-u zgjeroi autoritetin e saj edhe në këto raste. Rezultati i prokurorëve dhe gjyqtarëve të UNMIK-ut në trajtimin e rasteve të krimeve të luftës ka qenë minimal, për të mos thënë pa asnjë rezultat. Nga viti 2000 deri në vitin 2008 nga prokurorët e UNMIK-ut janë ngritur aktakuza ndaj tre (3) serbëve, 19 shqiptarëve dhe një (1) malazezi, derisa gjatë kësaj periudhe kohore nga gjyqtarët e UNMIK-ut është dënuar vetëm një (1) person për krime lufte.

Pas përfundimit të misionit të UNMIK-ut, rastet e krimeve të luftës nga viti 2009 janë trajtuar nga Misioni i Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë (EULEX). Nga prokurorët e misionit të EULEX-it, nga viti 2009 deri në vitin 2018, janë ngritur aktakuza ndaj 11 serbëve, 39 shqiptarëve, një (1) malazezi, dhe një (1) personi nga komuniteti RAE. Ndërsa, me aktgjykime dënuese të formës së prerë të shqiptuara nga gjyqtarët e EULEX-it kanë përfunduar ndaj 38 personave.

PSRK-ja gjatë vitit 2016 kishte themeluar një departament të posaçëm për hetimin e krimeve të luftës dhe krimeve të tjera ndërkombëtare. Që nga viti 2014, kjo prokurori ka pasur kompetenca në të gjitha rastet, përjashtimisht “*rasteve në proces*” për të cilat ka pasur kompetencë EULEX-i. Nga qershori i vitit 2018, të gjitha kompetencat i kanë kaluar PSRK-së.

Numri i aktakuzave të ngritura përballë fakteve mbi krimet që kanë ndodhur në Kosovë gjatë luftës së fundit si dhe numri i përgjithshëm i rasteve të zgjidhura nga PSRK-ja manifestojnë dështim të së njëjtës për trajtimin e rasteve të krimeve të luftës. Në të gjitha rastet e zgjidhura nga sistemi gjyqësor, vetëm një (1) aktakuzë e PSRK-së ka arritur të ketë sukses në Gjykatë. Në anën tjetër, sipas statistikave zyrtare të KGJK-së, vërehet se edhe sistemi gjyqësor në Kosovë ka dështuar të vendos në prioritet gjykimin e rasteve të krimeve të luftës, e krejt kjo pasi vërehet se kanë zgjidhur një numër të vogël të lëndëve të krimeve të luftës.

Një ndër ndryshimet më të rëndësishme dhe më rrënjësore në Kodin e Procedurës Penale ka qenë mundësia e hetimit, akuzimit dhe gjyqimit të të pandehurve në mungesë, të cilët pretendohet se kanë kryer vepra penale kundër të Drejtës Ndërkombëtare Humanitare. Por, me anë të një komunikate për media, PSRK kishte deklaruar se ka vështirësi në zbatimin e këtij ligji.

Përkundër faktit se sipas të gjitha raporteve kredibile vendore dhe ndërkombëtare Republika e Serbisë paraqitet si agresor përballë viktimës kosovare, ndjekjet dhe gjykimet penale ndaj shqiptarëve, kanë qenë shumë më evidente se sa ndaj serbëve dhe ndaj zyrtarëve serb që kanë përfaqësuar dhe kanë kryer krime lufte në emër të Republikës së Serbisë, e cila në atë kohë ishte në kuadër të Republikës Federale të Jugosllavisë. Në këtë drejtim, përballë disbalancit të madh etnik në numrin e viktimave nga lufta e fundit në Kosovë, paradoksalisht, në hetimin dhe gjykimin e krimeve të luftës, ky disbalanc ndryshon kahje. Nga tetori i vitit 1999 e deri në qershor të vitit 2020, kanë qenë gjithsej 117 të akuzuar. Nga ky total i numrit të të akuzuarve, 62 prej tyre kishin qenë shqiptarë, 49 serbë, 5 malazezë dhe një nga komuniteti RAE.

Ky disbalanc mbi baza etnike është jashtëzakonisht edhe më i thekuar në rastin e numrit të personave të dënuar për krime lufte gjatë luftës së fundit në Kosovë. Gjatë periudhës kohore tetor 1999 – qershor 2020, nga gjyqtarë të UNMIK-ut, EULEX-it dhe atyre vendorë, me aktgjykime të formës së prerë janë dënuar gjithsej 40 persona, prej tyre plot 35 shqiptarë dhe vetëm katër (4) serbë, derisa për krime lufte me aktgjykim të formës së prerë është dënuar edhe një (1) person i nacionalitetit malazezë. Shprehur në përqindje, i bie se nga të gjithë të dënuarit për krime lufte nga UNMIK-u, EULEX-i dhe gjyqtarët vendorë, 87.5% e tyre janë të etnisë shqiptare dhe vetëm 10% e tyre janë të etnisë serbe, derisa 2.5% janë të etnisë Malazeze.

Lidershipi politik në Kosovë dhe partitë politike asnjëherë nuk i kanë marrë seriozisht hetimin, ndjekjen dhe gjykimin e krimeve të luftës në Kosovë. Ka pasur mungesë të vullnetit politik dhe strategjisë për të vënë drejtësi për viktimat e krimeve të luftës dhe dëmet e shkaktuara nga aparati shtetëror Jugosllav. Ky mos veprim dhe neglizhim i politikës në Kosovë, përfshirë mungesën e kërkesës dhe mbajtjes llogaridhënës Misionet e UNMIK-ut dhe EULEX-it për të përmbushur mandatin e tyre është përcjellë me mungesën e rezultateve, dhe drejtimin e ndjekjes dhe gjyqimit kryesisht të shqiptarëve dhe amnistisë ndaj aparatit shtetëror serb dhe serbëve që kanë kryer krime në Kosovë.

E njëjta qasje vazhdon edhe pas vitit 2014, kur kompetencat transferohen tek vendoret (përfshirë *“rasteve në proces”*). Politika në Kosovë, krimet e luftës në Kosovë i kujton kryesisht në muajt mars, prill, maj dhe qershor kur janë përvjetorët e krimeve të luftës në Kosovë, përderisa nuk ka ndërmarr asnjë veprim apo iniciativë shtetërore për luftimin e krimeve të luftës, rrjedhimisht praktikisht duke ofruar amnisti të plotë ndaj kryesve të krimeve të luftës në Kosovë.

2. Metodologjia

IKD me qëllim që të përpilojë një raport sa më gjithëpërfshirës dhe analitik, në lidhje me trajtimin e rasteve të krimeve të luftës nga sistemi prokurorial dhe gjyqësor, ka përdorur metodologji të përzier të hulumtimit.

Për draftimin e këtij hulumtimi, IKD ka përdorur dokumente të ndryshme zyrtare si legjislacionin primar dhe sekondar, raporte të ndryshme zyrtare të KGJK-së, raporte të ndryshme zyrtare të KPK-së, të dhëna të tjera të siguruara nga këto institucione përmes kërkesave për qasje në dokumente publike si dhe raporte të tjera zyrtare dhe jo zyrtare që kanë të bëjnë me hetimin dhe gjykimin e rasteve të krimeve të luftës. Po ashtu, me këtë rast janë përdorur dokumente ndërkombëtare, të cilat janë të obligueshme dhe drejtpërdrejtë të zbatueshme në sistemin e drejtësisë.

Krahas këtyre dokumenteve, draftimi i këtij raporti është bazuar në monitorimin e drejtpërdrejtë të performancës së prokurorive dhe gjykatave në zbatimin e ligjit, politikave dhe planeve të veprimit për trajtimin e rasteve në Departamentin e Krimeve të Rënda. Për të dhënat e grumbulluara gjatë procesit të monitorimit të sistemit të drejtësisë, IKD tanimë ka lansuar për publikun edhe Platformën e Monitorimit të Gjyqësorit (<https://ejudiciary.org/>).

IKD bazuar në obligimet ligjore dhe planet e veprimit ka krijuar indikatorë të qartë për matjen e progresit dhe regresit të sistemit prokurorial dhe atij gjyqësor.

Në këtë raport, IKD ka pasqyruar kronologjikisht hetimin dhe gjykimin e krimeve të luftës në Republikës së Kosovës. Me këtë rast, ky raport trajton sukseset dhe dështimet e të gjitha institucioneve vendore dhe ndërkombëtare, që kanë pasur dhe kanë kompetenca në fushën e hetimit dhe gjykimin të krimeve të luftës.

Sa i përket trajtimit të kësaj fushe, IKD me qëllim të detajimit të suksesit dhe dështimit, ka paraqitur punën e secilit institucion, me kompetenca prokuroriale dhe gjyqësore në Republikën e Kosovës. Ky trajtim është bërë për periudhën që nga viti 1999 e deri në qershor 2020, derisa trajtim i veçantë i është kushtuar periudhës kohore 2016 – Qershor 2020.

Krejt në fund, IKD ka trajtuar në mënyrë të detajuar rastet e përzgjedhura karakteristike, të cilat kanë të bëjnë me hetimin dhe gjykimin e krimeve të luftës.

3. Nocioni i krimeve kundër të drejtës ndërkombëtare

Veprat penale për të cilat aplikohet përgjegjësia penale përgjithësisht janë të sanksionuara në legjislacionet penale kombëtare, por jo çdo vepër penale mund të konsiderohet krim ndërkombëtar¹. Veprat penale ndërkombëtare, sipas një koncepti të pranuar në të drejtën penale nacionale dhe në të drejtën ndërkombëtare, si edhe në jurisprudencën penale ndërkombëtare, paraqesin shkelje të të mirave dhe të vlerave të rëndësishme ndërkombëtare. Në epiqendër të këtyre vlerave ndërkombëtare, të cilat shkelen me këto vepra penale, gjendet korpusi i të drejtave universale të njeriut.² Shkelja e rregullave themelore, të cilat njerëzimi i ka krijuar për të rregulluar përdorimin e forcës nga shtetet, si gjatë konflikteve të armatosura, ashtu edhe në kohë paqeje, kanë pasur për pasojë kryerjen e krimeve më të rënda.³

Jurisprudenca penale ndërkombëtare, ka përvetësuar disa parime të përbashkëta mbi krimet kundër të drejtës ndërkombëtare, si në vijim:

- “Krimet ndërkombëtare janë shkelje të rregullave të parashikuara me instrumentet ndërkombëtare si konventat, traktate ose statute. Një tipar i tillë përputhet plotësisht me parimin e legalitetit, si postulat themelor në të drejtën penale, sipas të cilit vepra penale duhet të jetë e parashikuar me ligj.
- Këto rregulla kanë si qëllim primar mbrojtjen e disa vlerave të cilat konsiderohen si të rëndësishme nga bashkësia ndërkombëtare, në themel të të cilave qëndrojnë të drejtat themelore të njeriut.
- Në bashkësinë ndërkombëtare mbizotëron një interes universal në dënimin e këtyre krimeve. Si rrjedhojë, autorët e këtyre krimeve, parimisht mund të ndiqen penalisht dhe të ndëshkohen për këto krime nga çdo shtet, pavarësisht nga lidhje territoriale apo e kombësisë që mund të ekzistojë me autorin ose viktimën.
- Subjekte të krimeve ndërkombëtare janë kryesisht subjekte të posaçme si komandantë ushtarakë, zyrtarë shtetërorë ose persona të urdhëruar apo inkurajuar prej tyre.
- Në përputhje me rregullat e së drejtës ndërkombëtare, kryesit e këtyre krimeve gjykohen si nga gjykatat e shteteve, ashtu edhe nga gjykatat penale ndërkombëtare”.⁴

3.1.Përgjegjësia penale për krimet kundër të drejtës ndërkombëtare

Përgjegjësia penale ka qenë në vazhdimësi objekt diskutimi në fushën e të drejtës ndërkombëtare. Për këtë çështje, në sferën e të drejtës ndërkombëtare është arritur konsensusi se përgjegjësia penale ndërkombëtare është shumëdimensionale dhe në vetvete ngërthen shumë lloje dhe subjekte, të cilat i nënshtrohen kësaj lloji përgjegjësie. Sipas një parimi të tillë, një person mund të ndiqet penalisht dhe të ndëshkohet për vepra penale ndërkombëtare, vetëm nëse janë përmbushur të gjitha elementet e fajësisë: përgjegjshmëria, dashja apo pakujdesia dhe vetëdija për kundërligjshmërinë, koncept ky i pranuar edhe në legjislacionin penal të

¹ Xhafo, J. “E Drejta Penale Ndërkombëtare”. Tiranë. 2012. F. 49.

² Salihu, I. “E Drejta Penale Ndërkombëtare”. Prishtinë. Mars 2011. F.343.

³ Bellelli, Roberto: “International Criminal Justice”, Ashgate Publishing Limited, Angli, 2010, F.5.

⁴ Xhafo, J. “E Drejta Penale Ndërkombëtare”. Tiranë. 2012. F. 50.

Republikës së Kosovës, më konkretisht në nenin 7 dhe 17 të Kodit nr.06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës.

Prandaj, në të drejtën penale moderne mbizotëron parimi për përgjegjësinë penale ndërkombëtare individuale, gjegjësisht parimi i përgjegjësisë kolektive nuk është më i pranueshëm dhe si rezultat i kësaj në të drejtën penale moderne dhe kryesisht në të drejtën penale ndërkombëtare është rrënjësuar thellë parimi i autonomisë individuale, me ndihmën e të cilit individ i është i lirë, që në bazë të vullnetit të lirë dhe pa ndikimin e askujt, të zgjedhë mënyrën e sjelljes. Sipas kësaj doktrine, krimet në të drejtën ndërkombëtare kryhen nga qenie njerëzore dhe jo entitete abstrakte, siç janë shtetet, dhe se vetëm duke dënuar njerëzit për krimet e tilla, mund të arrihet në forcimin e drejtësisë penale.⁵

Ndërsa, sa i përket përgjegjësisë penale ndërkombëtare të personave, kryesisht kemi të bëjmë me atë përgjegjësi të personave, të cilët si bartës të funksioneve të caktuara shtetërore në periudhën e luftës, para saj ose pas përfundimit, kryejnë veprime, të cilat janë në kundërshtim me rregullat e gjithë pranuar ndërkombëtare. Një koncept i tillë fillimisht u përfshi në Statutin e Gjykatës Ushtarake të Tokios dhe Nurembergut, e më pas u inkorporua edhe në instrumentet ndërkombëtare si Konventa mbi parandalimin dhe ndëshkimin e krimit të gjenocidit (Neni 4) dhe Konventa e Gjenevës mbi të drejtën humanitare (Neni 51 dhe 52). Po ashtu, parimi i përgjegjësisë penale individuale u afirmua edhe në nenin 25.2 të Statutit të Romës për Gjykatën Penale Ndërkombëtare, ku përcaktohet se “*Personi që kryen një krim brenda juridiksionit të Gjykatës, do të jetë përgjegjës personalisht dhe i nënshtrohet dënimit, në pajtim me këtë Statut*”.⁶

Po ashtu, me qëllim të zbatimit më me efikasitet në praktikë, parimi i përgjegjësisë penale është pasuruar edhe me një sërë parimesh, të tilla si irelevanca apo mos marrja parasysh e pozitës zyrtare të autorit të krimit, apo zbatimi i urdhrave të eprorit, si shkak për përjashtimin nga përgjegjësia penale. Një koncept i tillë është inkriminuar edhe në nenin 16.2 të Kodit Nr.06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës, sipas të cilit “*Urdhrat për të kryer gjenocid, krime lufte apo krime kundër njerëzimit janë të paligjshëm në të gjitha rrethanat*”.⁷

⁵ Xhafo, J. “*E Drejta Penale Ndërkombëtare*”. Tiranë. 2012. F.96.

⁶ “Ligji për ratifikimin e statutit të Romës për Gjykatën Penale Ndërkombëtare”, i miratuar nga Konferenca Diplomatike e të Plotfuqishmeve në Kombet e Bashkuara për themelimin e Gjykatës Ndërkombëtare Penale, më 17 korrik 1998, dhe i hyrë në fuqi më 1 korrik 2002. (Shih linkun http://www.pp.gov.al/web/statuti_i_romes_per_gjykatën_nderkombetare_penale_813.pdf). (Qasur së fundi më 19 maj 2020).

⁷ “Kodi NR. 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës”. Neni 16.2.

3.2.Kuptimi i krimeve të luftës sipas akteve ndërkombëtare

Përpyjekjet që ka bërë bashkësia ndërkombëtare për parandalimin e luftërave dhe konflikteve të armatosura, fatkeqësisht janë treguar të pasuksesshme. Mirëpo, një mossa e tillë, bashkësia ndërkombëtare e ka kompensuar pjesërisht duke përcaktuar dhe imponuar rregulla të caktuara, të cilat duhet të respektohen gjatë luftës apo konfliktit të armatosur⁸.

Krimet e luftës përkufizohen si shkelje serioze të rregullave ndërkombëtare që burojnë nga traktatet ndërkombëtare ose ligji ndërkombëtar humanitar në konfliktet e armatosura,⁹ dhe zakoneve ndërkombëtare të aplikueshme në konflikte të armatosura.¹⁰ Tradicionalisht, krimet e luftës ndërlidheshin me shkeljet e tilla serioze të kryera gjatë një konflikti të armatosur ndërkombëtar, mirëpo në të drejtën penale moderne, shumica e shteteve kanë paraparë që një person mund të përgjigjet penalisht edhe për shkeljet e kryera gjatë konfliktit të brendshëm të armatosur.¹¹

E drejta ndërkombëtare humanitare deri me 1949 (prej vitit 1899-1949), ka ofruar mbrojtje legale ndërkombëtare vetëm për ata që luftonin në emër të shtetit, ndërsa privilegjet e luftës kanë qenë të njohura vetëm kundrejt forcave të armatosura shtetërore, policisë ose trupave vullnetare, lëvizjeve të rezistencës që u takonin shteteve palë në konflikt dhe që respektonin nenin 4 (2) të Konventave të Gjenevës.¹²

Këto iniciativa të bashkësisë ndërkombëtare, filluan të intensifikohen sidomos pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore. Prandaj, u synua që me rregulla dhe norma të karakterit obligues, të parapara kryesisht me konventa ndërkombëtare, të humanizohet lufta. Për arritjen e këtij qëllimi, një kontribut madhor në kodifikimin e krimeve të luftës kanë dhënë katër Konventat e Gjenevës për Humanizimin e Luftës, të vitit 1949:

1. Konventa e Gjenevës për përmirësimin e fatit të të plagosurve dhe të sëmurëve të forcave të armatosura në luftë;
2. Konventa e Gjenevës për përmirësimin e fatit të të plagosurve, të sëmurëve dhe anijeve të përmblytura të forcave të armatosura detare;
3. Konventa e Gjenevës lidhur me sjelljen ndaj robërve të luftës;
4. Konventa e Gjenevës për mbrojtjen e personave civilë gjatë kohës së luftës.

Këto instrumente ndërkombëtare kanë ndikuar në zbatimin e përgjegjësisë ndërkombëtare, duke u'ar imponuar shteteve anëtare detyrimin që të dënojnë shkeljet e rënda të normave dhe rregullave të luftës.¹³

⁸ Haye E. "War crimes in internal armed conflicts". Cambridge University Press. 2008. F.33.

⁹ Xhafo, J. "E Drejta Penale Ndërkombëtare". Tiranë. 2012. F.69.

¹⁰ Cryer, R. Friman, H. Robinson, D: Wilmschurst, E. "An Introduction to INTERNATIONAL CRIMINAL LAW AND PROCEDURE". Cambridge University Press. 2007. F.221.

¹¹ Murphy, D.S. "Principles of International Law". St. Paul. 2006. f.420.

¹² Hasani, E. "Tema të zgjedhura nga e drejta dhe marrëdhëniet ndërkombëtare". Universiteti i Prishtinës/Jalifat. Hjuston. 2016.

¹³ Xhafo, J. "E Drejta Penale Ndërkombëtare". Tiranë. 2012. F.69-70.

Po ashtu, lidhur me këto konventa të Gjenevës të vitit 1949, si mjaft të rëndësishme janë edhe dy Protokolle plotësuese të këtyre konventave, të nxjerra në vitin 1977:

- *Protokolli i parë i cili i referohet mbrojtjes së viktimave të konflikteve të armatosura dhe;*
- *Protokolli i dytë i cili i referohet konflikteve të armatosura të brendshme, brenda një shteti.*¹⁴

Sa i përket ndëshkimit të krimeve të luftës, të një rëndësie të veçantë janë edhe Rregullat mbi ligjet dhe zakonet e zhvillimit të luftës, rregulla këto që janë aneks i Konventës së Hagës të vitit 1907, si dhe Konventa për mbrojtjen e vlerave kulturore në rastet e konfliktit të armatosur e vitit 1954.

Si krime të luftës, mbështetur në konventat e sipër përmendura të Gjenevës dhe të Protokollit të I-rë, konsiderohen këto vepra penale kundër personave të mbrojtur apo vlerave të mbrojtura:

- Tortura dhe sjellja jonjerëzore, përfshirë edhe eksperimentet biologjike ndaj personit të mbrojtur, robërve të mbrojtur të luftës apo personit civil të mbrojtur;
- Shkaktimi i qëllimshëm i mundimeve të mëdha apo lëndimeve të rënda trupore apo dëmtimet e rënda të shëndetit;
- Shkatërrimi dhe përvetësimi i kundërligjshëm dhe arbitrar i pasurisë së huaj, e cila nuk është e arsyeshme për nevojat ushtarake;
- Detyrimi i personit të mbrojtur që të shërbejë në formacionet ushtarake të armikut;
- Privimi i qëllimshëm i të drejtës për gjykim të ndershëm dhe objektiv i garantuar me konventa;
- Shpërngulja e kundërligjshme, kolonizimi apo kufizimi i lirisë së personave të mbrojtur (ky krim kryhet në rastet kur me dhunë shpërngulet një pjesë apo e tërë popullsia civile në territorin e shtetit tjetër);
- Marrja e pengjeve;
- Shpërngulja e popullsisë civile nga vendbanimet e okupuara brenda shtetit apo jashtë shtetit;
- Prolongimi i padrejtë i kthimit të robërve të luftës në shtetin e tyre;
- Imponimi i aparteidit apo praktikës tjetër nënçmuese, që bazohet në diskriminimin racor;
- Sulmi në monumentet historike, në vepra artistike apo vende të tjera fetare të cilat vërehen qartë dhe të cilat paraqesin trashëgimi kulturore dhe shpirtërore të popullit, që gëzojnë mbrojtje të posaçme¹⁵.

Sipas Konventës së Hagës lidhur me ligjet dhe zakonet e luftës të vitit 1907 dhe Rregullores së saj, si krime të luftës konsiderohen edhe: mënyra e ndaluar e luftës dhe mjetet e ndaluara të luftës. Si mënyra të ndaluara të luftës, të cilat shkaktojnë vdekjen apo lëndime të rënda trupore, ose dëmtime të rënda të shëndetit, përfshihen veprimet si në vijim:

¹⁴ Salihu, I. “E Drejta Penale Ndërkombëtare”. Prishtinë. Mars 2011.. F.358.

¹⁵ Po aty. F. 358-359.

- Sulmi në vendbanime civile apo ndaj personave të caktuar civilë;
- Sulmi ndaj personave, të cilët janë “jashtë luftës” (të cilët nuk janë të angazhuar në luftë);
- Sulmi pa i zgjedhur caqet apo sulmi ndaj objekteve apo instalimeve të cilat për nga natyra e tyre shkaktojnë rreziqe, duke ditur se sulmi i tillë shkakton humbjen e jetës të shumë njerëzve, dëmtime të popullsisë civile apo që shkakton dëme së tepërmi në objekte civile;
- Sulmi në territore të demilitarizuara apo territore të pambrojtura;
- Përdorimi perfid i shenjave të dukshme të Kryqit të Kuq, Gjysmëhënës apo të shenjave të tjera, që janë të mbrojtura me të drejtën ndërkombëtare.

Ndërsa, si mjete të ndaluara të luftës, sipas konventës së lartcekur konsiderohet përdorimi i armëve:

- Të cilat shkaktojnë mundime të panevojshme;
- Të cilat për shkak të pasaktësisë apo efektit të tyre i godasin si pjesëtarët e forcave të armatosura ashtu edhe personat civilë;
- Efekti i të cilave nuk mund të kontrollohet në kohë dhe hapësirë.¹⁶

Të gjitha përkufizimet e lartpërmendura mbi krimet e luftës janë të parapara si të tilla edhe me nenin 8 të Statutit të Romës, mirëpo duhet theksuar se me këtë dokument themelues të GjNP-së, krimet e luftës janë definuar në mënyrë më të qartë dhe më të detajuar, krahasuar me dispozitat e konventave të cekura si më lartë.

Nisur nga fakti se krimet e luftës, gjenocidi dhe krimet kundër njerëzimit i kanë shkaktuar njerëzimit humbje të mëdha dhe janë ndër krimet më të rënda të së drejtës ndërkombëtare, konform nenit 1 të Konventës për Mosparashkrimin e Krimeve të Luftës dhe të Krimeve kundër Njerëzimit, theksohet se ato nuk parashkruhen, pa marrë parasysh kohën në të cilën këto krime janë kryer¹⁷.

¹⁶ “Konventa e Hagës lidhur me ligjet dhe zakonet e luftës”. Nënshkruar më 18 tetor 1907. Neni 23. (Shih linkun <https://www.loc.gov/Law/help/us-treaties/bevans/m-ust000001-0631.pdf>). (Qasur së fundi më 19 maj 2020).

¹⁷ “Konventa për Mosparashkrimin e Krimeve të Luftës dhe të Krimeve kundër Njerëzimit”. Miratuar me Rezolutën 2931 (XXIII) të Asamblesë së përgjithshme. 23 nëntor 1968. Neni 1. “Krimet e mëposhtme janë të paparashkrueshme, cilado qoftë data në të cilën ato janë kryer: a) Krimet e luftës, ashtu siç përkufizohen në Statutin e Gjykatës Ushtarake Ndërkombëtare të Nurembergut të datës 8 gusht 1945 dhe pohohen nga Rezolutat 3 (I) dhe 95 (I) të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, në datat 13 shkurt 1946 dhe 11 dhjetor 1946, sidomos “veprat rënda” të numëruara në Konventat e Gjenevës të 12 gushtit 1940 për mbrojtjen e viktimave të luftës”. b) Krimet kundër njerëzimit, qofshin ato të kryera në kohë lufte apo në kohë paqeje, ashtu siç përkufizohen ato në Statutin e Gjykatës Ushtarake Ndërkombëtare të Nurembergut të datës 8 gusht 1945 dhe pohohen nga Rezolutat 3 (I) dhe 95 (I) të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, në datat 13 shkurt 1946 dhe 11 dhjetor 1946, dëbimi me një sulm të armatosur ose pushtimi dhe aktet çnjerëzore që rrjedhin nga politika e aparteidit, si edhe krimi i gjenocidit, ashtu siç përkufizohet ai në Konventën e vitit 1948 për Parandalimin dhe Shtypjen e Krimit të Gjenocidit, edhe në qoftë se këto akte nuk përbëjnë ndonjë shkelje të së drejtës së brendshme të vendit ku janë kryer”.

3.3.Krimet e luftës sipas legjislacionit të Republikës së Kosovës

Juridiksionet kombëtare dhe instancat ndërkombëtare kanë definuar në mënyra të ndryshme aktet e paligjshme, të cilat ndërmerren nga palët ndërluftuese kundrejt asaj pjese të popullatës të pambrojtur, e cila nuk është pjesë aktive e konfliktit të armatosur. Por megjithatë, aktet e tilla paraqesin shkelje serioze të Konventave të Gjenevës, protokolleve të tyre, ose të ligjeve dhe zakoneve të luftës, lidhur me shkelje të ligjit ndërkombëtar humanitar, për krime lufte, krime kundër njerëzimit dhe gjenocid.

Fillimisht, gjykimi i krimeve të luftës në shtetin e Kosovës, pas përfundimit të konfliktit të armatosur është bërë sipas ligjit penal, i cili ka qenë në fuqi para datës 29 mars 1989 (Ligji Penal i Republikës Socialiste Federative të ish-Jugosllavisë), meqë Kosova akoma nuk kishte nxjerrë legjislacion penal për të sanksionuar krime të tilla, dhe ekzistonin zbrazëti juridike për rregullimin juridiko-penal të kësaj fushe mjaft komplekse.

Po ashtu, edhe procedura penale në këto gjykime deri në muajin prill të vitit 2004, është zhvilluar duke u mbështetur në ligjin mbi procedurën penale, i cili ka qenë në fuqi deri më 29 mars 1989, pra sipas ligjit mbi procedurën penale të ish-Jugosllavisë, por se duhet theksuar se shumë çështje janë zgjidhur edhe me rregullore të miratuara nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) me zbatimin e normave ndërkombëtare.

Prandaj, bazuar në legjislacionin penal dhe procedural që zbatohet deri në mars të vitit 1989 në ish-Jugosllavi, deri në vitin 2004 janë organizuar gjykimet për krimet, për shkeljen e të drejtave të njeriut si dhe shkeljen e rregullave vendore dhe ndërkombëtare, që kanë ndodhur gjatë luftës në Kosovë nga data 28 shkurt të vitit 1998 e deri në mesin e muajit qershor të vitit 1999.

Megjithatë, një legjislacion i tillë është zbatuar deri në vitin 2004, ngase që nga muaji prill i vitit 2004 ka hyrë në fuqi Kodi i Përkohshëm Penal¹⁸ dhe Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale¹⁹. Deri në shpalljen e pavarësisë së Republikës së Kosovës më 17 shkurt 2008, këto dy ligje e kanë pasur statusin e ligjeve të përkohshme, dhe gjatë vitit 2008, me ligje të posaçme të Kuvendit të Republikës së Kosovës ato janë shpallur si ligje të Kosovës, përkatësisht përmes Ligjit Nr. 03/L-002 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës dhe Ligjit Nr. 03/L-003 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës nr.2003/26.

Sipas Kodit të Përkohshëm Penal (KPK), krimet e luftës kategorizoheshin në Kapitullin e XIV ku sanksionoheshin **“Veprat Penale Kundër të Drejtës Ndërkombëtare”**, dhe në këtë kod penal ishin përfshirë të gjitha llojet e krimeve të luftës, të cilat sanksionoheshin sipas katër Konventave të Gjenevës të vitit 1949, pastaj Konventës së Hagës lidhur me ligjet dhe zakonet e luftës dhe Rregullores së saj, si dhe inkriminimet që burojnë nga aktet më të rëndësishme ndërkombëtare dhe ato që konsiderohen si e drejtë ndërkombëtare zakonore. Si rrjedhojë,

¹⁸ “Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale i Kosovës”. Hyrë në fuqi më 6 prill 2004.

¹⁹ Po aty.

veprat penale që cilësoheshin si krime të luftës sipas KPK-së, listoheshin nga neni 118 deri tek neni 122, dhe përfshinin këto vepra penale:

- “Krimet e luftës në kundërshtim të rëndë me Konventat e Gjenevës” (Neni 118), e dënueshme me së paku pesë vjet burgim ose me burgim afatgjatë;
- “Krimet e luftës si shkelje e rëndë e ligjeve dhe e zakoneve që zbatohen në konfliktin e armatosur ndërkombëtar” (Neni 119), e cila dënohet me së paku pesë vjet burgim ose me burgim afatgjatë për veprat penale;
- “Krimet e luftës për shkelje të rëndë të nenit 3 të përbashkët me Konventat e Gjenevës” (120) e dënueshme sipas KPK-së me së paku pesë vjet burgim ose me burgim afatgjatë;
- “Krimet e luftës të cilat paraqesin shkelje të rëndë të ligjeve dhe zakoneve që zbatohen në konfliktet e armatosura që nuk janë të karakterit ndërkombëtar” (Neni 121), e cila dënohet qoftë me burgim prej së paku pesë apo 10 vjet dhe me burgim afatgjatë;
- “Sulmet në konfliktet e armatosura të një karakteri jo ndërkombëtar kundër instalimeve që përmbajnë forca të rrezikshme” (Neni 122), dënohet me burgim prej së paku dhjetë vjet ose me burgim afatgjatë.

Në pajtim me të drejtën ndërkombëtare, përkatësisht në pajtim me Konventën për Mosparashkrimin e Krimeve të Luftës dhe të Krimeve Kundër Njerëzimit të vitit 1968, në nenin 95 të KPK-së ishte përcaktuar në mënyrë shprehimore se krimet e luftës nuk parashkruhen pa marrë parasysh kohën e kryerjes së tyre.²⁰

Ndërsa, nga 1 janari i vitit 2013, kishte hyrë në fuqi Kodi Penal i Republikës së Kosovës, i cili krimet e luftës i kategorizonte në Kapitullin e XV tek kategoria e **Veprave penale kundër njerëzimit dhe vlerave të mbrojtura me të drejtën ndërkombëtare**. Si veçori e miratimit të këtij Kodi ka qenë edhe rritja e dënueshmërisë së këtyre veprave penale, duke paraparë edhe mundësinë e shqiptimit të burgimit të përjetshëm ndaj kryesve të këtyre veprave penale.²¹

Ndryshimet në legjislacionin penal pasuan me nxjerrjen e një kodi të ri, i cili ka hyrë në fuqi më 14 prill 2019. Mirëpo, edhe me kodin e ri penal, krimet e luftës janë kategorizuar në kapitullin e XV, ku janë të listuara **Veprat penale kundër njerëzimit dhe vlerave të mbrojtura me të drejtën ndërkombëtare**. Sipas dispozitave të kodit të ri penal, si krime të luftës përfshihen po të njëjtat inkriminime siç parashiheshin me kodin penal, i cili është shfuqizuar në prill të vitit 2019, dhe për to parashikoheshin të njëjtat dënime, ndërsa si dallim i vetëm mund të cilësohet renditja e tyre në nene të ndryshme nga kodi paraprak. Në këtë kod, krimet e luftës janë të përcaktuara me nenet 144-148.

Sipas legjislacionit tonë penal, krimet e luftës kryhen gjatë kohës së luftës, konfliktit të armatosur apo okupimit dhe se edhe tentativa për kryerjen e krimeve të luftës është e ndëshkueshme.

²⁰ “Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale i Kosovës”. Neni 95 [MOSZBATUESHMËRIA E PARASHKRIMIT TË GJENOCIDIT DHE TË KRIMEVE TË LUFTËS]. “Nuk zbatohet asnjë afat i parashkrimit mbi ekzekutimin e dënimit për gjenocid, krime të luftës dhe krime kundër njerëzimit, si dhe për vepra të tjera penale për të cilat sipas të drejtës ndërkombëtare nuk mund të zbatohet parashkrimi”.

²¹ “Kodi NR. 04/L-082 Penal i Republikës së Kosovës”. Hyrë në fuqi më 1 janar 2013. Nenet 151-154.

Siç përmendëm edhe më lartë, Kodi i ri penal, ngjashëm si kodet penale paraprake dhe në pajtim të plotë me të drejtën ndërkombëtare, konkretisht me Konventën për Mos parashkrimin e Krimeve të Luftës dhe të Krimeve kundër Njerëzimit, ka përcaktuar në nenin 104 të tij, se asnjë afat i parashkrimit nuk zbatohet për veprat penale të gjenocidit, krimeve të luftës, krimeve kundër njerëzimit, ose për vepra tjera penale të cilat sipas të drejtës ndërkombëtare nuk parashkruhen.²²

²² “Kodi NR. 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës”. Neni 104 [Mosbatueshmëria e parashkrimit për veprat penale kundër të drejtës ndërkombëtare dhe vrasjes së rëndë]. “1. Asnjë afat i parashkrimit nuk zbatohet për veprat penale të gjenocidit, krimeve të luftës, krimeve kundër njerëzimit, ose për vepra tjera penale të cilat sipas të drejtës ndërkombëtare nuk parashkruhen”.

4. Fakte mbi luftën në Kosovë për periudhën 1998-1999

Luftërat dhe konfliktet e armatosura rrallë herë nxjerrin një fitues, ngase krahas dëmeve materiale, humbjet në jetë njerëzore janë të panumërta, dëmet materiale janë të shumta, ndërsa popullata, e cila ka përjetuar tmerret e luftës, ballafaqohet me trauma, të cilat do ta shoqërojnë atë tërë jetën.

Për fat të keq, edhe shteti i Kosovës, si një shoqëri e dalë nga një luftë e përgjakshme, e ballafaquar me një agresion të aparatit shtetëror të dhunës sistematike nga ish-regjimi Jugosllav, po vuan pasojat e një lufte të drejtë dhe legjitime, ku populli i Kosovës luftoi për të realizuar aspiratat e saj legjitime për liri.

Kosova akoma nuk ka hapur një kapitull të ri në historinë e saj, ngase akoma janë të hapura plagët e luftës së fundit. Fondi për të Drejtën Humanitare, në shkurt të vitit 2015, ka prezantuar Bazën e të Dhënave të Librit të Kujtimit të Kosovës, ku përmbledheshin të dhëna mbi numrin e personave që kishin humbur jetën ose ishin zhdukur gjatë luftës së fundit në Kosovë, që i referohet periudhës kohore 1 janar 1998 – 31 dhjetor 2000.

“Sipas bazës së të dhënave të LKK, gjatë dhe në kontekstin e konfliktit të armatosur në Kosovë janë vrarë ose janë zhdukur gjithsejtë 13.535 njerëz. Deri te këto të dhëna është arritur në bazë të analizës së 31.600 dokumenteve nga burime të ndryshme, në mesin e tyre edhe nga një numër i madh i deklaratave të viktimave dhe të dëshmitarëve të krimeve të luftës. Shqiptarët përbëjnë 10.812, serbët 2.197, kurse romët, boshnjakët, malazezët dhe joshqiptarët e tjerë i përbëjnë 526 viktima”, thuhet në Librin e Kujtimit të prezantuar nga Fondi për të Drejtën Humanitare.²³

Ndërsa, si pasojë e luftës, vlerësohet se janë edhe gjithsej një mijë e gjashtëqind (1.600) persona të pagjetur. Krahas vrasjeve dhe humbjeve në jetë njerëzore, vlerësohet se janë shkatërruar më se 188 mijë objekte banimi dhe janë dëbuar me dhunë nga Kosova më se 1 milion banorë.

Edhe në aspektin ekonomik, dëmet e luftës janë të larta, edhe pse nuk ka një shifër zyrtare, nga zyrtarë qeveritarë dhe analistë vlerësohet se mbi 22 miliardë euro është kostoja e dëmeve të luftës që Serbia ka shkaktuar në Kosovë para dhe gjatë luftës së fundit (1990-1999).²⁴

²³ “Baza e të Dhënave të Librit të Kujtimit të Kosovës”, Fondi për të Drejtën Humanitare. (Shih linkun <http://www.hlc-rcd.org/?p=28185&lang=zh>; http://www.kosovomemorybook.org/?page_id=48&lang=zh). (Qasur së fundi më 20 maj 2020).

²⁴ “Mbi 22 miliardë euro dëme të luftës”. Radio Evropa e Lirë. 23 shtator 2018. (Shih linkun <https://www.evropaelire.org/a/mbi-22-miliarde-euro-deme-te-luftes-/29505183.html>). (Qasur së fundi më 22 maj 2020).

5. Tribunali i Hagës për krimet në Ish-Jugosllavi

Gjykata Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë është formuar nga Kombet e Bashkuara për ndjekjen penale të personave, të cilët kanë kryer vepra penale gjatë luftës në Jugosllavi. Mandati i kësaj gjykate ka qenë nga viti 1993 deri në vitin 2017.

Lidhur me luftën në Kosovë, në këtë gjykatë me drejtësi janë ballafaquar komandanti i UÇK-së, Fatmir Limaj, bashkë me Isak Musliu e Hajredin Balaj. Limaj e Musliu në vitin 2005 janë liruar, ndërkaq Balaj ishte dënuar me 13 vite burgim, 10 nga të cilat i kishte vuajtur para se të lirohej nga tribunali.

Edhe komandanti i zonës së Dukagjinit, Ramush Haradinaj, bashkë me Idriz Balaj and Lahi Brahimag ishin akuzuar për krime lufte. Në vitin 2008, Haradinaj e Balaj ishin shpallur të pafajshëm, përderisa Lahi Brahimag ishte dënuar me gjashtë (6) vite heqje lirie. Në vitin 2010, ky rast ishte kthyer në rigjykim, përderisa në vitin 2012, pas rigjykimit, tre të akuzuarit ishin shpallur të pafajshëm.

Sipas të dhënave të Organizatës Për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian (OSBE), nga kjo gjykatë, gjykime janë zhvilluar edhe ndaj serbëve për krimet e kryera në Kosovë. Në rastin kundër Millosheviqit, gjykimi ishte ndërprerë gjatë fazës së gjykimit për shkak të vdekjes së tij. Ndërkaq, gjykim është zhvilluar edhe ndaj ish-udhëheqësve të kohës së Millosheviqit, ndaj Milan Milutinović, Nikola Šainovic, Ojdanić, Nebojša Pavković, Vladimir Lazarević dhe Sreten Lukić²⁵. Në një raport të OSBE-së, thuhet se sipas Zyrës Informative të GJNPJ-së nuk ka raste tjera që rrjedhin nga konflikti në Kosovë të cilat do të gjykohen në Gjykatë, për shkak se mbyllja e GJNPJ-së planifikohet që të ndodh në një të ardhme të afërt.

Me 26 shkurt 2009, ish-Presidenti i Serbisë, Milan Milutinović i akuzuar për krimet e luftës në Kosovë ishte shpallur i pafajshëm, ndërkaq Nikola Šainović, zëvendës kryeministri i Republikës Federale të ish-Jugosllavisë, ishte shpallur fajtor dhe dënuar me 22 vite burgim. Kurse, pas vendimit të Apelit, dënimi i është ulur në 18 vite burgim. Ai në vitin 2014 ishte transferuar nga Suedi për ta vuajtur dënimin. Ndërsa, lirimi i hershëm i ishte lejuar në vitin 2015.

Dragoljub Ojdanić, shefi i stafit të përgjithshëm të ushtrisë jugosllave, ishte dënuar me 15 vite burgim, kurse lirimi i hershëm i ishte lejuar në vitin 2013.

Nebojša Pavković, komandant ushtrie ishte dënuar me 22 vite burgim. Vendim të njëjtë kishte nxjerrë edhe Apeli për të, derisa Pavković në vitin 2014 ishte transferuar në Finlandë për të vuajtur dënimin.

²⁵ “GJYKIMET E KRIMEVE TË LUFTËS NË KOSOVË: NJË VLERËSIM PAS DHJETË VITEVE 1999 – 2009”. OSBE. Maj 2010. (Shih linkun <https://www.osce.org/files/f/documents/c/e/68570.pdf>). (Qasur së fundi me 6 gusht 2020).

Vladimir Lazarević, komandant i ushtarëve për Prishtinë, ishte dënuar me 15 vite burgim. Kurse, pas ankesës në Apel, ai është dënuar me 14 vite burgim. Lirimi i hershëm i ishte lejuar në vitin 2015.

Sreten Lukić, udhëheqës i Ministrisë së Punëve të Brendshme në Serbi, ishte dënuar me 22 vite burgim, e më pas Apeli ia kishte ulur dënimin në 20 vite. Ai në vitin 2015, është transferuar në Poloni për ta kryer dënimin.

Vendimi për dënim të personave të lartpërmendur ishte marrë me 26 shkurt 2009, ndërsa vendimi i shkallës së dytë pas apelimit të vendimit ishte marrë më 23 janar 2014²⁶.

Për krime luftë në Kosovë, nga kjo gjykatë ishte dënuar me 27 vite burgim edhe Vlastimir Đorđević me 23 shkurt 2011. Apeli, pas ankesës, më 27 janar 2014, dënimin ia kishte ulur në 17 vite. Më 16 tetor 2014, ai ishte transferuar në Gjermani për vuajtje të dënimit.²⁷

²⁶ “Informatat për rastin”. Gjykata Ndërkombëtare Penale e ish-Jugosllavisë. (Shih linkun https://www.icty.org/x/cases/milutinovic/cis/en/cis_sainovic_al_en.pdf). (Qasur së fundi me 6 gusht 2020).

²⁷ “Informatat për rastin”. Gjykata Ndërkombëtare Penale e ish-Jugosllavisë. (Shih linkun https://www.icty.org/x/cases/djordjevic/cis/en/cis_djordjevic_en.pdf). (Qasur së fundi me 6 gusht 2020).

6. Organizimi i sistemit gjyqësor në Kosovë pas vitit 1999

Pas përfundimit të luftës në Kosovë, më 10 qershor 1999, Këshilli i Sigurimit i Organizatës së Kombeve të Bashkuara miratoi rezolutën 1244/99, përmes së cilës autorizoj Sekretari i Përgjithshëm që të vendosë praninë ndërkombëtare në Kosovë në mënyrë që të instalohej një administratë e përkohshme për Kosovën (UNMIK), me synimin që të ndërtonte dhe mbikëqyrte zhvillimin e institucioneve të përkohshme demokratike vetëqeverisëse, me qëllim të krijimit të kushteve të nevojshme për të siguruar jetesë paqësore dhe kushte normale për të gjithë banorët e Kosovës.²⁸

Gjendja kaotike që mbretëronte në Kosovën e pasluftës, gjen mbështetje edhe në deklaratimet e bëra nga Sekretari i Përgjithshëm në raportin e tij para Këshillit të Sigurimit në korrik të vitit 1999 - *“Problemi i sigurisë në Kosovë në një masë të madhe është rezultat i mungesës së institucioneve dhe agjencive të rendit dhe ligjit. Shumë krime dhe padrejtësi nuk mund të ndiqen në mënyrë të duhur”*.²⁹

Në rrethana të tilla, një ndër sfidat më të rëndësishme me të cilat do të ballafaqohej UNMIK-u në Kosovën e dalë nga lufta, ishte krijimi i një sistemi gjyqësor funksional e të pavarur. Po ashtu, OSBE-ja në bazë të mandatit të saj kishte për detyrë të ndërtojë institucionet juridike dhe të monitorojë sistemin e drejtësisë.

Mangësitë kryesore me të cilat ballafaqohej sistemi i drejtësisë pas luftës ishin mungesa e institucioneve dhe agjencive të rendit dhe të ligjit, dhe në këto rrethana, PSSP-ja duke e vendosur si prioritet, ndërmori hapat fillestar për rindërtimin e një sistemi gjyqësor multietnik dhe të mbështetur në parimet demokratike.³⁰

Në bazë të rezolutës 1244, të gjitha kompetencat legjislativë dhe ekzekutive, duke përfshirë edhe administrimin e gjyqësorit, i'u mveshën PSSP-së, si zyrtari civil më i lartë ndërkombëtar i UNMIK-ut. PSSP-ja kishte autoritetin që të caktojë një person të caktuar për të kryer funksionet në administratën e përkohshme civile, duke përfshirë gjyqësorin dhe për të hequr persona të tillë në qoftë se shërbimi i tyre nuk ishte në pajtim me mandatin dhe qëllimet e administratës së përkohshme civile.³¹

²⁸ “Sundimi i ligjit në Kosovë dhe mandati i UNMIK-ut”. UNMIK. (Shih linkun <https://unmik.unmissions.org/sq/sundimi-i-ligjit-n%C3%AB-kosov%C3%AB-dhe-mandati-i-unmik-ut>. (Qasur së fundi më 22 maj 2020).

²⁹ Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm para Këshillit të Sigurimit “Mbi Misionin e Administratës së Përkohshme në Kosovë”. S/1999/779. 12 korrik 1999. Cituar nga raporti i Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të politikave, të titulluar “Drejtësia Tranzicionale në Kosovë”, Prishtinë, qershor 2009. F.20. (Shih linkun http://www.kipred.org/repository/docs/Drejt%C3%ABsia_tranzicionale_n%C3%AB_Kosov%C3%AB_90885_1.pdf). (Qasur së fundi më 22 maj 2020).

³⁰ “Ri-themelimi dhe reformimi i sistemit të drejtësisë në Kosovë 1999 – 2011”. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. Maj 2011. F.9. (Shih linkun http://www.qkss.org/repository/docs/RI-THEMELIMI_DHE_REFORMIMI_I_SISTEMIT_T%C3%8B_DREJT%C3%8BSIS%C3%8B_N%C3%8B_KOSOV%C3%8B_105208.pdf). (Qasur së fundi më 21 maj 2020).

³¹ “Rezoluta 1244 e Kombeve të Bashkuara”. UNMIK. 10 qershor 1999. (Shih linkun <https://unmik.unmissions.org/sq/rezoluta-1244-e-kombeve-t%C3%AB-bashkuara>). (Qasur së fundi më 21 maj 2020).

Për arritjen e objektivave të paracaktuara në sistemin e drejtësisë, PSSP-ja më datën 28 qershor 1999 e ka formuar Këshillin e Përbashkët Këshillëdhënës (KPK), me autorizime që të rekomandojë emërimin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve. Për tre muaj sa zgjati mandati i tij, ky Këshill i ka propozuar 55 gjyqtarë dhe prokurorë, në mesin e të cilëve ka pasur edhe pjesëtarë të komuniteteve pakicë. Këshilli Këshillëdhënës ka pushuar me punën e tij në datën 7 tetor të vitit 1999 dhe është zëvendësuar me Komisionin e Përkohshëm Këshillëdhënës, i cili, pas shqyrtimit të 700 kërkesave dhe 560 intervistave të zhvilluara, i ka rekomanduar UNMIK-ut emërimin e 300 gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe mbi 200 gjyqtarëve-porotë, të cilët janë emëruar deri në muajin qershor të vitit 2000.³²

Më pas, brenda strukturës së UNMIK-ut, PSSP-ja kishte themeluar Zyrën për Çështje Ligjore, e cila fillimisht ishte përgjegjëse për (i) administrimin e gjykatave, prokurorisë dhe burgjeve, (ii) zhvillimin e politikave ligjore, (iii) rishikimin dhe hartimin e legjislacionit, dhe (iv) vlerësimin e cilësisë së drejtësisë në Kosovë. Më tej, PSSP-ja e themeloi një gjykatë të instancës më të lartë, e cila do të kishte kompetencat e Gjykatës Supreme të Kosovës, për të vendosur sa i përket ankesave kundër vendimeve të Gjykatave të Qarkut dhe deri në atë kohë kur të ri-themelohej Gjykata Supreme.³³

Ndërsa, në Shtator të vitit 1999, PSSP-ja themeloi Komisionin Këshillues Gjyqësor, i cili zëvendësoi Këshillin Konsultativ të Përbashkët mbi Emërimet e Përkohshme Gjyqësore. Ky Komision ishte përgjegjës për të ftuar që të aplikojnë profesionistët ligjor për të shërbyer si gjyqtarë ose prokurorë, për shqyrtimin e kërkesave individuale dhe për të rekomanduar PSSP-në për emërimin e kandidatëve si gjyqtarë ose prokurorë. Komisioni Këshillues Gjyqësor ishte gjithashtu përgjegjës për këshillimin e PSSP-së mbi çështjet që lidhen me ankesat ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Sistemi emergjent gjyqësor (SEGJ) u iniciua më 30 qershor 1999 me hapjen e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, e ndjekur nga hapja e gjykatave në Prizren, Pejë, Gjiilan dhe Mitrovicë dhe e mbështetur nga gjykatat mobile.

Në fund të vitit 1999, sistemi emergjent i drejtësisë kishte 301 gjyqtarë dhe prokurorë dhe 238 gjyqtarë porotë³⁴.

³² “Pasqyrë e gjykimeve për krimet e luftës në Kosovë 1999-2018”, Fondi për të Drejtën Humanitare në Kosovë. F.8. (Shih linkun https://www.hlc-kosovo.org/sq/pasqyre-e-gjykimeve-per-krimet-e-luftes-ne-kosove-ne-periodhen-1999-2018-2/?fbclid=IwAR26zJygoxtF9hp1_FaCf_nJo90-5YzF8f6OhvcmNVIMtBZkufSbviYrVxg). (Qasur së fundi më 21 maj 2020).

³³ “Ri-themelimi dhe reformimi i sistemit të drejtësisë në Kosovë 1999 – 2011”. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. Maj 2011. f. 9. (Shih linkun http://www.qkss.org/repository/docs/RI-THEMELIMI_DHE_REFORMIMI_I_SISTEMIT_T%C3%8B_DREJT%C3%8BSIS%C3%8B_N%C3%8B_KOSOV%C3%8B_105208.pdf). (Qasur së fundi më 21 maj 2020).

³⁴ Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS). RI-THEMELIMINDHE REFORMIMIN ESISTEMIT TË DREJTËSISË NË KOSOVË 1999 -2011ANALIZË KONTEKSTI. Maj 2011. f.10. (Shih linkun www.qkss.org/repository/docs/RI-THEMELIMI_DHE_REFORMIMI_I_SISTEMIT_TË_DREJTËSISË_NË_KOSOVË_105208.pdf). (Qasur për herë të fundit më 6 shtator 2020).

7. Trajtimi i krimeve të luftës nga misioni i UNMIK-ut

Prania jo e madhe e komuniteteve pakicë në sistemin e gjyqësorit, si dhe fakti se në cilësinë e të akuzuarve për veprat penale të krimeve të luftës kanë qenë kryesisht serb, ngritën shqetësime për anshmëri të gjyqësorit dhe prokurorisë vendore gjatë fazës së SEGJ.

Si rrjedhojë, në shkurt të vitit 2000, PSSP-ja, shpalli Rregulloren e UNMIK-ut 2000/34 me të cilën zgjeroi autoritetin për të caktuar gjyqtarë dhe prokurorë ndërkombëtar në tërë territorin e Kosovës.³⁵ Prandaj, që nga ajo kohë, gjyqtarë dhe prokurorë ndërkombëtar kanë punuar në Kosovë në raste të ndryshme, përfshirë edhe në ato të krimeve të luftës.

Pas konfliktit, UNMIK-u ka themeluar një polici civile (CIVPOL), e cila përbëhej nga anëtarë të vendeve anëtare të OKB-së. Një veprim i tillë ishte ndërmarrë ngase kishte mungesë të autoriteteve zyrtare që operonin në Kosovë, me përjashtim të misionit paqeruajtës të KFOR-it. Ndërsa, Shërbimi Policor i Kosovës (ShPK), filloi të operonte në vitin 1999, mirëpo ShPK-ja nuk ishte e involvuar në hetimin e krimeve të luftës, deri në fillimin e bartjes së kompetencave nga ana e EULEX-it tek institucionet vendore. Në fillim, ShPK-ja në hetimin e këtyre krimeve ka qenë e përfshirë përmes ekipeve të përziera për hetimin e krimeve të luftës.³⁶

Sipas raportit të publikuar nga FDH në Kosovë, aktakuzat e para për krime lufte në kuadër të sistemit gjyqësor të themeluar pas konfliktit të armatosur, janë ngritur nga ana e prokurorëve vendorë nga fundi i vitit 1999. Ndërsa, panelet shqyrtuese, kanë qenë të përbëra kryesisht nga gjykatës shqiptarë, të cilët në fillim të viteve 90-ta kanë qenë të përjashtuar nga sistemi gjyqësor i asaj kohe, dhe të cilët kishin 10 vite që nuk kishin ushtruar funksione gjyqësore.

Sipas të dhënave të FDH-së, nga viti 1999 deri në vitin 2000, nga prokurorët vendorë janë ngritur aktakuza ndaj 29 serbëve, një (1) shqiptari, dhe tre (3) malazezëve.

Për shkak të dyshimeve mbi paanshmërinë e këtyre gjykatësve dhe prokurorëve, nga fillimi i muajit shkurt të vitit 2000, e deri në fund të misionit të UNMIK-ut, gjykimet për krime lufte janë zhvilluar kryesisht para paneleve ndërkombëtare.³⁷

7.1. Performanca e UNMIK-ut në trajtimin e krimeve të luftës në Kosovë

Gjykimi i krimeve të luftës nga ana e misionit të UNMIK-ut, është përcjellë me një sërë mangësish, të cilat kanë pamundësuar trajtimin efikas të këtyre rasteve. Në raportin e FDH-së në Kosovë, theksohet se “gjykimet e organizuara nga ana e Misionit të KB-ve kanë zgjatur

³⁵ “Rregullorja e UNMIK-ut 2000/34”, që ndryshon Rregulloren e UNMIK-ut 2000/6 mbi Emërimin dhe Shkarkimin nga Detyra të Gjyqtarëve Ndërkombëtar dhe Prokurorëve Ndërkombëtar. 29 maj 2000. (Shih linkun https://unmik.unmissions.org/sites/default/files/regulations/03albanian/A2000regs/RA2000_34.htm). (Qasur së fundi më 21 maj 2020).

³⁶ “Gjykimet e krimeve të luftës në Kosovë: një vlerësim pas dhjetë viteve 1999 – 2009”. Maj 2010. OSBE. F.11. (Shih linkun <https://www.osce.org/files/f/documents/c/e/68570.pdf>). (Qasur së fundi më 21 maj 2020).

³⁷ “PASQYRË E GJYKIMEVE PËR KRIMET E LUFTËS NË KOSOVË NË PERIUDHËN 1999-2018”. Fondi për të Drejtën Humanitare. f.10. (Shih linkun https://www.hlc-kosovo.org/sq/pasqyre-e-gjykimeve-per-krimet-e-luftes-ne-kosove-ne-periudhen-1999-2018-2/?fbclid=IwAR26zJygoxtF9hp1_FaCf_nJo90-5YzF8f6OhvcmNVIMtBZkufSbviYrVxg). (Qasur së fundi më 21 maj 2020).

shumë, se rastet disa herë janë kthyer në rigjykim, më së shpeshti për shkak të hetimeve të zhvilluara në mënyrë jocilësore, ndryshimit të deklaratave në shqyrtimet kryesore krahasuar me ato, të cilat i kanë dhënë në fazat e mëhershme të procedurës ose të hetimeve si dhe për shkak të pamundësisë së prokurorëve që nga dëshmitarët të sigurojnë informata, me të cilat do të vërtetonin pretendimet e aktakuzës. Gjatë shqyrtimit janë evidentuar lëshime në kryerjen e hetimeve, posaçërisht nga ana e policisë”.³⁸

Sipas këtij raporti, rezulton se deri në fund të vitit 2008, Gjyqtarët dhe Prokurorët Ndërkombëtarë të UNMIK-ut kishin zgjidhur afërsisht 40 çështje penale për krime lufte.³⁹

Sipas të dhënave të FHD-së, nga viti 2000 deri në vitin 2008 nga prokurorët e UNMIK-ut, janë ngritur aktakuza ndaj tre (3) serbëve, 19 shqiptarëve dhe një (1) malazezi.

Në këtë drejtim, sipas të dhënave të kësaj organizate, gjatë kësaj periudhe kohore nga gjyqtarët e UNMIK-ut është dënuar vetëm një (1) person.

Numri i madh i aktgjykimeve liruese, sipas FDH-së, i atribuohet ndryshimit të deklaratave të dëshmitarëve të dhëna në faza të ndryshme të procedurës penale.

Amnesty International (AI), në një raport të publikuar në qershor të vitit 2009, apo 10 vite pas konfliktit të armatosur, ka adresuar një sërë kritika në adresë të UNMIK-ut, me arsyetimin se i kanë kontribuar klimës së mos ndëshkimit të krimeve të luftës, ngase nuk kanë zhvilluar hetime të menjëhershme, e as hetime të pavarura, e të paanshme, dhe si rezultat i kësaj, vetëm një numër i vogël nga personat përgjegjës të krimeve të luftës dhe të krimeve ndër-etnike në Kosovë, gjatë dhe pas konfliktit të armatosur, janë sjellë para drejtësisë në gjykatat ndërkombëtare apo vendore.⁴⁰

Tutje, në këtë raport thuhet se “IOK-ja, Amnesty International dhe organizma të tjerë i’a kanë atribuuar këtë dështim shumë faktorëve, duke përfshirë: ndryshimin e vazhdueshëm dhe të shpeshtë të personelit hetues, me oficerët e policisë së UNMIK-ut që shpeshherë qëndronin në detyrë jo më shumë se gjashtë muaj, duke sjellë si pasojë një mungesë në vijimësinë e hetimit, një përsëritje të shpeshtë të intervistave nga oficerët pasardhës, apo një lënie pas dore në raste të tjera. Për më tepër, shumë oficerë pranë NJPP-së dhe NJHKL-së, kishin pak ose aspak eksperiencë në hetimin e krimeve të rënda, për të mos përmendur krimet e luftës dhe krimet ndër-etnike. Në pjesën më të madhe të rasteve, duke mos qenë në gjendje të flisnin gjuhën vendase e duke përjashtuar anëtarët e ShPK-së nga pjesëmarrja në hetime, policia e UNMIK-ut gjeti pak bashkëpunim tek komunitetet dhe dëshmitarët vendas”.⁴¹

³⁸ Po aty. f.10.

³⁹ Po aty. f.37.

⁴⁰ “Groposja e së kaluarës 10 vjet pandëshkueshmëri për zhdukjet dhe rrëmbimet me forcë në Kosovë”. Qershor 2009. Amnesty International. f. 43. (Shih linkun <https://www.amnesty.org/en/documents/EUR70/007/2009/sq/>). (Qasur së fundi më 21 maj 2020).

⁴¹ Po aty. f.43.

Amnesty International vlerëson se as Kosova dhe as Serbia nuk kanë marrë masat e duhura për mbrojtjen e dëshmitarëve në ndjekjet penale të krimeve të luftës, pjesa më e madhe e të cilëve vazhdojnë të kenë frikë për sigurinë e tyre.

Sipas këtij raporti, dështimet në procedimin e rasteve të krimeve të luftës, si në Kosovë dhe Serbi i atribuohen edhe faktit se ka pasur një mungesë të dukshme vullneti politik për të sjellë para drejtësisë autorët e krimeve të luftës, dhe se ndërhyrjet e shumta politike në sistemin e drejtësisë, si në Kosovë, ashtu edhe në Serbi, kanë pamundësuar zhvillimin e hetimeve efikase ndaj të dyshuarve për krime lufte.

Prandaj, në raportin e kësaj organizate theksohet ndër të tjera, se me kalimin e kohës bëhet gjithnjë e më vështirë mbledhja e informacionit dhe provave të nevojshme për të kryer ndjekje të suksesshme penale të krimeve të luftës:

“Pra, shumë prova fizike – si vendndodhjet e varreve dhe trupave, plumbat dhe provat e tjera kontekstuale – ende mbeten për t’u grumbulluar nga hetuesit ose i duhen vënë atyre në dispozicion. Disa prova të marra nga Tribunali janë asgjësuar, deklarata të mbledhura nga KFOR-i nuk janë bërë të disponueshme, dhe prova të tjera mund të jenë ndotur, shkatërruar me qëllim apo zhdukur. Po ashtu, kujtimet e dëshmitarëve mund të jenë ndikuar ose shtrembëruar me kalimin e kohës, ose mund të jenë ngulitur si rezultat i ri-tregimit shumë të shpeshtë të historive. Mundet që edhe përcaktimi i vendndodhjes së dëshmitarëve të jetë i pamundur. Ndërkohë që kultura e mosndëshkimit dhe frikësimi i dëshmitarëve mbizotëron si në Kosovë dhe Serbi, i shumë do jetë numri i atyre që do të vazhdojnë të mos pranojnë të ofrojnë dëshmi”, thuhet në raportin e AI.⁴²

Po ashtu, kritika me të drejtë janë adresuar në menaxhimin jo adekuat të lëndëve të krimeve të luftës nga ana e UNMIK-ut. Sipas Human Rights Watch, vonesat në procedimin me kohë të këtyre lëndëve, e për pasojë mos ushtrimi i ndjekjes penale me kohë ka bërë që shumë nga të dyshuarit për krime lufte të largohen nga Kosova.⁴³ Pra vonesat në adresimin e krimeve të luftës kanë qenë një ndër problemet më kronike, përfshirë këtu vonesat në fazën e hetimeve policore (parapenale), fazën e ndjekjes penale, fazën e shqyrtimit gjyqësor dhe fazën lidhur me procedurën ankimore.

Një problem tepër serioz ka qenë mungesa e vazhdimësisë në personelin gjyqësor, ngase ishte evidente largimi i gjykatësve dhe prokurorëve ndërkombëtarë nga Kosova, gjatë shqyrtimit të një rasti, për shkak të kontratave të shkurtra, dhe kjo ka shkaktuar ndryshim të përbërjes së trupave gjyqësore, e për pasojë rifillim të shqyrtimeve gjyqësore dhe vonesë në procedimin e rasteve.

⁴² “Groposja e së kaluarës 10 vjet pandëshkueshmëri për zhdukjet dhe rrëmbimet me forcë në Kosovë”, qershor 2009. Amnesty International. f.62. (Shih linkun <https://www.amnesty.org/en/documents/EUR70/007/2009/sq/>). (Qasur së fundi më 21 maj 2020).

⁴³ “Askund në agjendë Dështimi i vazhdueshëm për të kërkuar përgjegjësi në Kosovë pas marsit 2004”. Human Rights Watch. Maj 2006. f. 22. (Shih linkun <https://www.hrw.org/sq/report/2006/05/29/255430>). (Qasur së fundi më 21 maj 2020).

8. Trajtimi i krimeve të luftës nga Misioni i Bashkimit Evropian (EULEX)

Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX), zyrtarisht ka filluar punën në Republikën e Kosovës më 9 dhjetor 2008, ndërsa është bërë plotësisht funksional në prill të vitit 2009, duke marrë kompetencat që deri atë kohë i takonin UNMIK-ut.

Në fillim të mandatit, EULEX-i kishte në kompetencat e tij që të mbikëqyrë, këshillojë dhe të udhëzojë në fushën e doganave, policisë, gjyqësorit dhe sistemit korrektues, ndërsa kompetenca ekskluzive kishte në rastet e krimeve të luftës.⁴⁴

Në qershor të vitit 2010, misioni i EULEX-it ishte vazhduar edhe për dy vite të tjera, dhe ky vazhdim u shoqërua me një reduktim të konsiderueshëm të personelit të saj dhe ristrukturim të misionit të tij. Andaj, ky mision tashmë ishte rikonfiguruar në dy sektorë kryesorë: ‘Sektori Ekzekutiv,’ i cili punoi në mandatin ekzekutiv të misionit dhe “Sektori për Fuqizim”, i cili përqendrohet në monitorimin, mentorimin dhe këshillimin e homologëve vendas.

Nga muaji qershor i vitit 2014, u përcaktua se ky mision nuk do të merrte përsipër raste të reja, por se do të procedonte me rastet në proces.⁴⁵

Ndërsa, nga 15 qershori i vitit 2018 EULEX-i zbaton mandatin e tij përmes shtyllës për monitorim dhe shtyllës operacione, duke bërë monitorimin e rasteve dhe gjykimeve të caktuara në sistemin e drejtësisë të Kosovës. Po ashtu, EULEX-i vazhdon të ofrojë mbështetje teknike për zbatimin e marrëveshjeve përkatëse nga Dialogu i lehtësuar nga BE-ja për normalizimin e raporteve mes Beogradit dhe Prishtinës.

EULEX-i ka trashëguar gjithsej 1200 raste të krimeve të luftës nga UNMIK-u, pothuajse 2,000 dosje për personat e humbur; 47 çështje të krimeve të luftës i janë transferuar Zyrës së Prokurorit Special të Kosovës (ZPSK). Ndërsa, në korrik 2013, rreth 500 raste ishin mbyllur apo hedhur poshtë për shkak të mungesës së provave⁴⁶.

Lidhur me mbylljen e këtyre rasteve, IKD ka kërkuar zyrtarisht informata nga EULEX nëse qëndron ky konstatim se janë mbyllur këto 500 raste në korrik të vitit 2013, dhe nëse po, para mbylljes së këtyre rasteve, a janë zhvilluar hetime shtesë nga misioni i EULEX-it në këto raste, apo nëse ky mision është mjaftuar vetëm nga provat që kanë qenë pjesë e këtyre dosjeve.

Në përgjigjen e EULEX-it për IKD-në thuhet se çdo dosje e cila është hudhur poshtë apo është pushuar në mungesë të provave, është trajtuar si e tillë në përputhje me ligjin dhe pas një analize të provave të përfshira në atë dosje nga prokurori i lëndës.

“Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX) i ka trashëguar 1200 dosje policore për krime të luftës nga UNMIK-u. Prej muajit korrik 2013, 500 raste të policisë

⁴⁴ “Histori e shkurtër për EULEX-in”. EULEX. (Shih linkun <https://www.eulex-kosovo.eu/?page=1,44,197>.) (Qasur së fundi më 21 maj 2020).

⁴⁵ Po aty.

⁴⁶ Bernd Borchardt. “EULEX-i dhe krimet e luftës” EULEX Kosovo. (Shih linkun <https://www.eulex-kosovo.eu/en/news/000427.php>.) (Qasur së fundi më 21 maj 2020).

së UNMIK-ut janë hedhur poshtë ose janë pushuar për shkak të mungesës së provave. Çdo dosje që është hedhur poshtë ose pushuar për shkak të mungesës së provave është trajtuar si e tillë në përputhje me ligjin dhe pas një analize të provave të përfshira në atë dosje nga prokurori i lëndës. Prokurorët e EULEX-it, si të gjithë prokurorët e tjerë të Kosovës, i kanë ndjekur rastet bazuar në prova”⁴⁷.

Në po këtë përgjigje, EULEX thotë se nga monitorimi që i bënë sistemit të drejtësisë që nga viti 2018, ky mision ka gjetur se progresi në fushën e hetimit dhe gjyqimit të krimeve të luftës ka qenë i kufizuar.

“Në dhjetor 2018, EULEX-i e ka përfunduar dorëzimin e dosjeve të lëndëve policore, prokuroriale dhe gjyqësore tek autoritetet e Kosovës, kështu që për çdo pyetje shtesë ju lutemi kontaktoni ata drejtpërdrejt. Në kuadër të mandatit aktual të tij, EULEX-i kryen një monitorim të fuqishëm sistematik dhe tematik të rasteve të përzgjedhura, përfshirë rastet e krimeve të luftës, si dhe ka vërejtur se progresi në fushën e hetimit dhe gjyqimit të krimeve të luftës ka qenë i kufizuar”⁴⁸.

8.1. Performanca e EULEX-it në trajtimin e krimeve të luftës në Kosovë

Gjykimet, për të cilat kanë qenë kompetent gjyqtarët e EULEX-it janë zhvilluar para paneleve gjyqësore me përbërje të përzier, me të cilat kanë udhëhequr gjyqtarët ndërkombëtarë, pos gjykatës në Mitrovicë (ish Gjykata e Qarkut, tash ajo Themelore), ku për shkak të tensioneve politike, gjykimet janë zhvilluar para paneleve gjyqësore të përbërë ekskluzivisht nga gjyqtarët ndërkombëtarë.⁴⁹

Sipas raportit të FDH-së në Kosovë, misioni i EULEX-it në fillim të mandatit të tij kishte treguar një performancë relativisht efikase në gjykimin e krimeve të luftës, duke dëshmuar një rritje të efikasitetit dhe transparencës në organizimin e gjykimeve. Si rrjedhojë, ky mision kishte filluar hetimet, të cilat më pas kishin rezultuar me aktakuza edhe ndaj ish-pjesëtarëve të caktuar të rangut të lartë të UÇK-së, dhe shqyrtimet gjyqësore kanë zgjatur më pak, kurse nuk ka pasur as rigjykime të shpeshta.⁵⁰

Ndërsa, si probleme që janë evidentuar me rastin e trajtimit të krimeve të luftës nga misioni i EULEX-it përmenden ndërrimi i shpeshtë i deklaratave të dëshmitarëve, nga ato të dhëna në fazat e mëhershme të hetimeve, dhe refuzimi i dëshmitarëve për të thënë të vërtetën e njëmendët para paneleve gjyqësore.

⁴⁷ Përgjigje për IKD-në nga Zyra për Shtyp e misionit të EULEX-it. 07 shtator 2020.

⁴⁸ Po aty.

⁴⁹ “PASQYRË E GJYKIMEVE PËR KRIMET E LUFTËS NË KOSOVË NË PERIUDHËN 1999-2018”. Fondi për të Drejtën Humanitare. F.11. (Shih linkun https://www.hlc-kosovo.org/sq/pasqyre-e-gjykimeve-per-krimet-e-luftes-ne-kosove-ne-periudhen-1999-2018-2/?fbclid=IwAR26zJygoxtF9hp1_FaCf_nJo90-5YzF8f6OhvcmNVIMtBZkufSbviYrVxg). (Qasur së fundi më 21 maj 2020).

⁵⁰ Po aty. F 12.

Sipas të dhënave të FHD-së, nga prokurorët e misionit të EULEX-it, nga viti 2009 deri në vitin 2018, janë ngritur aktakuza ndaj 11 serbëve, 39 shqiptarëve, një (1) malazezi, dhe një (1) personi nga komuniteti RAE.

Lidhur me punën e misionit të EULEX-it, të dhënat e FHD-së nënvizojnë se gjatë kësaj periudhe kohore, me aktgjykime dënuese të formës së prerë të shqiptuara nga gjyqtarët e EULEX-it kanë përfunduar 38 persona.

Përkundër pritshmërive të mëdha se misioni i EULEX-it, do të realizonte objektivat e proklamuar që të luftonte problemet ekzistuese në fushën e sundimit të ligjit në Kosovë, duke përfshirë këtu mungesën e kapaciteteve, ndikimin politik, korrupsionin, krimin e organizuar, krimet e luftës dhe mungesën e sundimit të ligjit në veriun e shtetit të ri, shumica nga këto synime kanë mbetur në suazën e premtimeve.

Mirëpo, kritika ndaj misionit të EULEX-it, ishin adresuar edhe për dështimin që të siguroi një program efikas për mbrojtjen e dëshmitarëve, përderisa në një rast një dëshmitar i rëndësishëm kishte bërë vetëvrasje (Agim Zogaj) përkundër faktit se ishte nën mbrojtjen e këtij misioni, e në një rast tjetër Prokurorët e EULEX-i kishin realizuar një bashkëpunim joformal me autoritetet serbe, duke komunikuar informacione të dhëna nga disa dëshmitarë tek ta, dhe si rrjedhojë, duke marrë parasysh seriozitetin e akuzave në lidhje me atë që ai dëshmitar kishte ofruar atë informatë, i njëjti kishte konsideruar se zbulimi i atij informacioni mund të krijonte rrezik për sigurinë e tij apo të familjes së tij. Lidhur me këto pretendime ishte zhvilluar një procedurë pranë Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut, më 10 prill 2013, e identifikuar me nr. të lëndës 2011-07 dhe ky panel pas shqyrtimit të ankesës, kishte vlerësuar se në veprimet e ndërmarra nga prokurorët e EULEX-it, ka pasur shkelje të nenit 8 të Konventës, si dhe ky panel ka rekomanduar ndërmarrjen e disa veprimeve nga Shefi i Misionit të EULEX-it (SHM), ku përfshihej: *“Një deklaratë duhet të bëhet duke pranuar se rrethanat e rastit përbëjnë shkelje të të drejtave të parashtruesit të ankesës që i ngarkohen veprimeve të EULEX-it në kryerjen e mandatit të tij ekzekutiv, si dhe i është rekomanduar Shefit të Misionit që të urdhëroj zbatimin e disa masave pa vonesë, ku ndër to përmendet edhe që ShM duhet të udhëzoj prokurorët e EULEX-it për të mos komunikuar ndonjë informacion të dhënë nga dëshmitarët tek autoritetet - serbe apo ndonjë tjetër - pa marrë ndonjë siguri nga organet kompetente hetuese dhe prokuroriale të EULEX-it se ka bazë të nevojshme ligjore për këtë qëllim dhe që prokurorët e EULEX-it do të veprojnë në pajtim me këto kërkesa ligjore në të gjitha rrethanat.”*⁵¹

Po ashtu, ngjashëm si edhe misioni i UNMIK-ut, vlerësohet se edhe misioni i EULEX-it ka dështuar t'i mbajë dëshmitarët e sigurt dhe për të ndjekur penalisht krimet e luftës pa ndërhyrje politike, ngase edhe misioni i BE-së kishte ngritur shqetësime për çështjen e kanosjes së dëshmitarëve, dhe këto çështje u bënë simbol i paaftësisë së misionit për të ndërtuar besimin e njerëzve për të bashkëpunuar me drejtësinë.

⁵¹ “Raporti vjetor 2013”. Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut - Bashkimi Evropian, në lëndën nr. 2011-07. W kundër EULEX-it. (Shih linkun <https://www.hrrp.eu/alb/docs/Decisions/Decision%20merits%202011-07-a%20pdf.pdf>. (Qasur së fundi më 4 gusht 2020).

Prandaj, misioni i EULEX-it ka dështuar që të vendos si prioritet zgjidhjen e rasteve të mbetura të krimeve të luftës që kishin mbetur të pazgjidhura, si dhe të vendos një bashkëpunim të qëndrueshëm rajonal, veçmas me Serbinë, që do të kontribuonte në sigurimin e prezencës së dëshmitarëve dhe të akuzuarve për gjykim, si dhe materialit tjetër provues, i cili ka qenë i shpërndarë, qasje kjo e cila është vlerësuar si tejet problematike.

Rënia e kredibilitetit të EULEX-it në hetimin dhe gjykimin e krimeve të luftës ndërlidhet edhe me disa skandale të publikuara në publik edhe nga vetë pjesëtarë të këtij misioni, ku aludohej se gjykatës dhe prokurorë të EULEX-it kishin marrë mito nga avokatët vendorë në lidhje me rastet e krimeve të luftës.⁵²

⁵² “*Maria Bamieh: The British lawyer claiming to expose corruption at heart of EU mission to Kosovo*”. Independent. 6 november 2014 (Shih linkun <https://www.independent.co.uk/news/world/europe/maria-bamieh-the-british-lawyer-claiming-to-expose-corruption-at-heart-of-eu-mission-to-kosovo-9844893.html>). (Qasur së fundi më 22 maj 2020).

9. Trajtimi i krimeve të luftës nga autoritetet e Republikës së Kosovës

Më 30 maj të vitit 2014 ka hyrë në fuqi Ligji nr.04/L-273 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që Ndërlidhen me Mandatin e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Republikën e Kosovës.

Hyrja në fuqi e këtij ligji shënon edhe fillimin e transferimit të kompetencave nga misioni i EULEX-it tek prokurorët vendorë të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës.

Nga hyrja në fuqi e këtij ligji, misioni i EULEX-it kufizohet në të ashtuquajturat sipas këtij ligji, “*Rastet në proces*”.

Neni 1.A. i këtij ligji përcaktonte se “*1.Për qëllime të këtij ligji rast në proces nënkupton:1.1. Rastet për të cilat vendimi për fillimin e hetimeve është dhënë para datës 15 prill 2014 nga prokurorët e EULEX-it në pajtim me ligjin; 1.2.Rastet të cilat u janë caktuar gjyqtarëve të EULEX-it para datës 15 prill 2014*”.

Sa i përket autoritetit të prokurorëve të EULEX-it, ky ligj kufizonte rolin e të njëjtëve vetëm në “*rastet në proces*”, me ç’ rast në nenin 7 përcaktohej se “*Prokurorët e EULEX-it do të kenë autoritet dhe përgjegjësi t’i kryejnë funksionet e tyre, përfshirë autoritetin për kryerjen e hetimeve penale ashtu si përcaktohet në nenin 1.A nënparagrafi 1.1 të këtij ligji, përveç nëse parashihet ndryshe me këtë ligj*”, derisa në nenin 7.A. përcaktohej se “*Në rrethana të jashtëzakonshme një rast do t’i caktohet një prokurori të EULEX-it me vendim të përbashkët të Kryeprokurorit të Shtetit dhe autoritetit kompetent të EULEX KOSOVA*”.

Në anën tjetër, parimisht ishte caktuar që rastet në kompetencë të misionit të EULEX-it, të gjykohen nga kolegje me shumicë të gjyqtarëve vendorë, madje të njëjtat kolegje të kryesohen nga një gjyqtar vendorë. Përkatësisht, lidhur me juridiksionin dhe kompetencat e gjyqtarëve të EULEX-it në procedurat penale, neni 3 i ligjit në fjalë përcaktonte se: “*3.1 Gjyqtarët e EULEX-it të caktuar në procedurat penale do të kenë juridiksion dhe kompetenca për rastet që janë në proces siç përcaktohet në nenin 1.A nënparagrafi 1.2 të këtij ligji;3.2 Një gjyqtar i EULEX-it mund të caktohet në fazën përkatëse të procedurës penale, për rastet në proces të definuara në nenin 1.A nënparagrafi 1.1 të këtij ligji në pajtueshmëri me rregulloren e brendshme të KGJK-së; 3.3 Kolegjet në të cilat gjyqtarët e EULEX-it ushtrojnë juridiksionin e tyre në procedurat penale do të përbëhen me shumicë të gjyqtarëve të vendorë dhe do të kryesohen nga një gjyqtar vendorë. Me kërkesën e bazuar të autoritetit kompetent të EULEX-it, Këshilli Gjyqësor i Kosovës do të vendosë që kolegji të përbëhet me shumicë të gjyqtarëve të EULEX-it; 3.4 EULEX-i në Kosovë do të emërojë gjyqtarë që të ndihmojnë lidhur me zbatimin, sipas marrëveshjes së dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë të ndërmjetësuar nga BE*”.

Tutje, më 14 korrik 2016 kishte hyrë në fuqi Ligji nr.05/L-103 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që Ndërlidhen me Mandatin e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Republikën e Kosovës.

Edhe më këtë ligj, mandati i prokurorëve dhe gjyqtarëve të EULEX-it kufizohet vetëm në “rastet në proces”, por se sipas këtij ligji, kishte ndryshuar edhe përkufizimi i “rasteve në proces”.

Përkatësisht, neni 1.A.1. i këtij ligji përcaktonte se “Për qëllime të këtij ligji rast në proces nënkupton: 1.1. çështjen penale për të cilën vendimi për fillimin e hetimeve është marrë nga prokurorët e EULEX-it para datës 15 prill 2014, në pajtim me ligjin; 1.2. çështjen penale e cila mbështetur në nenin 7/A të Ligjit 04/L -273 i është transferuar prokurorit të EULEX-it, pas datës 15 Prill 2014 deri më 15 qershor 2016; 1.3. rastin i cili i është caktuar gjyqtarit të EULEX-it para datës 15 prill 2014; 1.4. çështjen penale e përcaktuar në paragrafin 1.1. dhe 1.2. të këtij neni, e cila i është caktuar gjyqtarit të EULEX- pas datës 15 prill 2014 deri më 15 qershor 2016”.

Tanimë, ky ligj në nenin 3.A.2. përcaktonte se “Të gjitha rastet nga EULEX-i do të transferohen tek institucionet vendore, me përfundimin e mandatit të Misionit EULEX Kosova të përcaktuar me ligj”.

Përfundimisht, mandati i EULEX-it ka përfunduar më 14 qershor 2018, dhe që nga 15 qershori i vitit 2018, misioni i EULEX-it ka vetëm rol monitorues në punën e sistemit kosovar të drejtësisë.

Në këtë mënyrë, nga ky narrativ, shihet se misioni i EULEX-it ka qenë me kompetenca ekskluzive vetëm deri në vitin 2014. Nga viti 2014 dhe deri në vitin 2018, misioni i EULEX-it ka qenë i kufizuar vetëm në rastet në proces, të filluara para datës 15 prill 2014, dhe jo edhe për rastet e tjera.

Për këto arsye, mandati i EULEX-it nuk mund të përdoret si arsyetim i prokurorëve vendorë për mungesë të rezultateve gjatë kësaj periudhe kohore.

Në anën tjetër, sa i përket trajtimit të rasteve të krimeve të luftës nga prokurorët vendorë, PSRK gjatë vitit 2016 kishte themeluar një departament të posaçëm për hetimin e krimeve të luftës dhe krimeve të tjera ndërkombëtare.

Po ashtu, edhe në kuadër të Policisë së Kosovës funksionon Njësia për Hetimin e Krimeve të Luftës dhe Sektori për Personat e Zhdukur si pjesë e Drejtorisë për Krime të Rënda në Departamentin e Hetimeve të Policisë së Kosovës dhe është njësi policore e specializuar dhe e autorizuar për hetimin e këtyre veprave penale.

Ndërsa, Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK), në shkurt të vitit 2019 ka miratuar Strategjinë për krime të luftës, me synimin që të sigurojë hetime dhe ndjekje penale efektive të pretendimeve serioze për krime të luftës dhe krimeve të tjera sipas të drejtës ndërkombëtare, vendosjen e drejtësisë për viktimat, palët e dëmtuara si dhe forcimin e sundimit të ligjit.⁵³

⁵³ “Strategjia e Krimeve të Luftës”. Këshilli Prokurorial i Kosovës, shkurt 2019, f.5


9.1. Performanca e sistemit kosovar të drejtësisë në trajtimin e rasteve të krimeve të luftës

Në këtë kapitull, IKD ka paraqitur performancën e sistemit kosovar të drejtësisë në trajtimin e Krimeve të Luftës, ku përkthet me trajtimin e këtyre krimeve, IKD ka analizuar në mënyrë të detajuar punën e sistemit prokurorial dhe gjyqësor.

9.1.1. Ngarkesa e PSRK-së me lëndë të krimeve të luftës gjatë viteve 2016, 2017, 2018 dhe 2019

Sipas raporteve vjetore të Prokurorit të Shtetit, gjatë periudhës 2016-2019, Departamenti për Krime Luftë i PSRK-së ka pasur në punë gjithsej 3,166 lëndë, prej të cilave ka zgjidhur 196 lëndë apo vetëm 6% të lëndëve, ndërsa kanë mbetur të pazgjidhura 2,940 apo 94% të lëndëve.

Mirëpo nga gjithsej 196 lëndë të zgjidhura gjatë këtyre viteve, PSRK ka ngritur 11 aktakuza, dy (2) aktakuza në vitin 2016, katër (4) në vitin 2017, dy (2) aktakuza në vitin 2018 dhe në vitin 2019 tri (3) aktakuza.



Grafika 1: Ngarkesa me lëndë të krimeve të luftës në PSRK gjatë viteve 2016-2019.

Gjatë vitit **2016**, PSRK-ja ka pasur në punë 359 raste me 1,531 persona, prej të cilave, 33 raste me 73 persona janë zgjidhur, ndërsa 326 lëndë me 1,458 persona kanë mbetur të pazgjidhura.

Nga gjithsej 73 persona për të cilët janë zgjidhur lëndët, PSRK-ja kishte pushuar hetimet për 47 prej tyre, për 17 persona kishte hedhur kallëzimin penal, për katër (4) persona kishte cedim në kompetencë, ndërsa vetëm ndaj pesë (5) personave ishte ngritur aktakuzë.

Gjatë vitit **2017**, PSRK-ja ka pasur në punë 799 lëndë, ku 25 lëndë janë zgjidhur, ndërsa 774 lëndë kanë mbetur të pazgjidhura, ndërsa lidhur me mënyrën e zgjidhjes së tyre, gjatë këtij viti prokurorët kanë pushuar hetimet ndaj 29 personave, ndërsa ndaj 9 personave kanë hedhur

kallëzimin penal. Gjatë këtij viti sipas të dhënave të siguruara përmes kërkesës për informata, rezulton se ndaj 15 personave janë ngritur aktakuza.

Gjatë vitit **2018**, në këtë prokurori kanë qenë në punë 720 lëndë, prej të cilave, 16 lëndë me 62 persona janë zgjidhur, ndërsa 704 kanë ngelur të pazgjidhura. Nga gjithsej 62 persona, PSRK kishte ngritur aktakuzë për dy (2) prej tyre, ndaj një (1) personi kishte bërë bashkimin e procedurës, për 41 persona kishte deleguar kompetencën, ndërsa ndaj 18 personave kishte pushuar procedurën.

Kurse, gjatë vitit **2019**, PSRK-ja ka pasur në punë 1,288 lëndë dhe në këtë vit, krahas zgjidhjes më të madhe të lëndëve për të gjitha kallëzimet penale, ka pasur ngritje të lëndëve të zgjidhura edhe për rastet e krimeve të luftës. Në këtë vit janë zgjidhur 122 raste, ndërsa 1,166 lëndë kanë mbetur të pazgjidhura. Nga 122 rastet e zgjidhura gjatë këtij viti, sipas raportit të PSh-së, PSRK-ja në tri raste ndaj katër (4) personave ka ngritur aktakuzë, në dy raste ndaj dy (2) personave ka bërë bashkimin e procedurës, në shtatë raste apo për 18 persona ka deleguar kompetencën, ndërsa në dy raste apo ndaj tre (3) personave ka pushuar hetimet.

Edhe pse në raportin e PSh-së thuhet se gjatë vitit 2019 janë zgjidhur 122 raste për krime lufte, tek pjesa që flet për mënyrën e zgjidhjes së lëndëve paraqiten vetëm 14 raste me 27 persona, duke krijuar paqartësi në pasqyrimin e punës së Prokurorit të Shtetit sa i përket trajtimit të rasteve të krimeve të luftës.

	Pushuar hetimet	Hedhje e kallëzimit penal	Aktakuza të ngritura	Bashkim i procedurës	Delegim në kompetencë
2016	47	17	5	-	4
2017	29	9	15	-	-
2018	18	1	2	1	41
2019	3	2	4	2	18
Total	97	29	26		

Tabela 1: Mënyra e zgjidhjes së rasteve të krimeve të luftës (për persona) gjatë periudhës 2016-2019⁵⁴

Sipas këtyre të dhënave të Prokurorit të Shtetit, vërehet se Prokurorët e PSRK-së kanë mbyllur në Prokurori shumë më shumë raste se sa kanë ngritur aktakuza, duke mos iu nënshtruar asnjë lloj kontrolli gjyqësor dhe në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, si dhe me dokumentet ndërkombëtare që garantojnë dhe promovojnë të drejtat dhe liritë e njeriut, më konkretisht të drejtën e mjetit juridik ndaj secilit vendim administrativ dhe gjyqësor. Për katër vite, Prokuroritë kanë pushuar hetimet ndaj 97 personave, ndërsa për katër vite kanë ngritur

⁵⁴ *Shënim:* Në kolonat e zbrazëta nuk janë paraqitur të dhëna për shkak se mungojnë në raportet vjetore të PSh-së. IKD vazhdimisht përballtet me probleme të tilla sa i përket statistikave të sistemit gjyqësor dhe sistemit prokurorial. Në këtë drejtim, IKD vlerëson se të dy këshillat duhet ta vlerësojnë rëndësinë që kanë statistikave për të ndërtuar analiza specifike, qoftë nga vetë këshillat apo edhe nga shoqëria civile. Për këtë arsye, është e domosdoshme që çështjes së statistikave ti kushtohet një kujdes më i madh. Për më tepër, kjo ishte evidentuar edhe në raportet e kaluara të IKD-së. Shih Shala. Gzim. “Pavarësia, Efikasiteti, Llogaridhënia dhe Integriteti i Sistemit Gjyqësor dhe Prokurorial”. IKD. 29 janar 2019. f.15-16 dhe 32-33. (<https://kli-ks.org/wpcontent/uploads/2019/01/Raporti-KGJK-KPK-2018-Final-29.01.2019-1-1.pdf>). (Qasur së fundi me 6 gusht 2020).

aktakuza ndaj 26 personave. Kjo do të thotë se numri i aktakuzave të ngritura përballë fakteve mbi krimet që kanë ndodhur në Kosovë gjatë luftës së fundit si dhe numri i përgjithshëm i rasteve të zgjidhura nga kjo prokurori manifestojnë dështim të së njëjtës për trajtimin e rasteve të krimeve të luftës.

Në raportet vjetore të Prokurorit të Shtetit nuk figurojnë të dhëna për mënyrën e zgjidhjes së rasteve, por paraqitet vetëm mënyra e zgjidhjes sipas personave. Për këtë arsye, IKD me anë të kërkesës për informata ka kërkuar nga PSRK të na ofrojë qasje në statistikën se mbi këtyrën e zgjidhjes së lëndëve (sipas rasteve):

	Aktakuza	Hudhje	Pushime
2016	2	2	20
2017	4	/	3
2018	2	/	4
2019	4	/	2
2020	2	/	2
Total	14	2	31

Tabela 2: Mënyra e zgjidhjes së rasteve të krimeve të luftës nga PSRK gjatë periudhës 2016-2020

Sipas këtyre të dhënave, rezulton se për katër vite, PSRK-ja ka ngritur vetëm 12 aktakuza për krime lufte (si dhe 2 në vitin 2020), ndërsa kanë pushuar hetimet në 29 raste (si dhe 2 në vitin 2020).

Në këtë drejtim, themelimi i një departamenti të veçantë në PSRK për trajtimin e rasteve të krimeve të luftës, në kohën kur në këtë prokurori nuk ekzistonte asnjë departament i specializuar, kishte për qëllim ngritjen e efikasitetit dhe profesionalizmit në zbardhjen e rasteve të krimeve të luftës. Në këtë drejtim, nga ky departament i profilizuar në kuadër të një prokurorie të specializuar ishin legjitime pritjet për rezultate në zbardhjen e rasteve të krimeve të luftës. Por, përballë këtyre pritjeve legjitime, rezultatet e pritura nuk janë arritur. Për më tepër, siç do të shohim në vijim, në të gjitha rastet e zgjidhura nga sistemi gjyqësor, vetëm një (1) aktakuzë e PSRK-së ka arritur të ketë sukses në Gjykatë, me aktgjykim dënues të formës së prerë.

Krahas rrethanave subjektive që kanë ndikuar në mos efikasitetin dhe efektivitetin e këtij departamenti, mos përkrahja e këtij departamenti nga institucionet e tjera, madje edhe nga vet sistemi prokurorial, ndërton argumentimin se krijimi i këtij departamenti ishte bërë sa për të paraqitur vet themelimin e këtij departamenti si sukses, i cili sukses do të përfundonte me thjesht themelimin e këtij departamenti. Kjo pasi Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe sistemi prokurorial nuk janë angazhuar që ti ngritin kapacitetet e këtij departamenti, në atë mënyrë që të ngritët numri i prokurorëve dhe resurset e tjera të nevojshme për adresimin e hetimit efikas dhe efektiv të krimeve të luftës. Në këtë drejtim, numri i vogël i prokurorëve në këtë departament dhe mos përkrahja e vazhdueshme e këtij departamenti paraqet paracaktimin e mos suksesit të këtij departamenti. Në këtë mënyrë, mos përkrahja e këtij departamenti nuk ka ndërtuar as pritjet për ngritje të efikasitetit dhe efektivitetit në hetimin e rasteve të krimeve të luftës

Në këtë drejtim, IKD vlerëson se këto të dhëna paraqesin dy (2) dimensionet kuptimore në raport me hetimin dhe gjykimin e rasteve të krimeve të luftës.

Fillimisht, mungesa kaq evidente e rezultateve në trajtimin e rasteve të krimeve të luftës nga një departament i profilizuar në kuadër të një prokurorie të specializuar e humb edhe kuptimin e ekzistimit të këtij departamenti.

Në anën tjetër, një mungesë kaq evidente e rezultateve nga një departament i profilizuar në kuadër të një prokurorie të specializuar, tregon nevojën për reforma rrënjësore në kuadër të sistemit prokurorial, në mënyrë që të kemi hetim dhe gjykim efikas dhe efektiv të rasteve të krimeve të luftës. Para së gjithash, kjo reformë duhet të pasqyrohet në përkrahjen e Departamentit për Krime Luftë në PSRK me resurse të nevojshme për ngritjen e efikasitetit dhe efektivitetit.

9.1.2. Ngarkesa e DKR-ve të GjTh më lëndë të krimeve të luftës gjatë viteve 2017, 2018 dhe 2019


IKD përpos ngarkesës së PSRK-së më lëndë të krimeve të luftës, ka analizuar edhe ngarkesën e DKR-ve të Gjykatave Themelore me këtë kategori të lëndëve.

Sipas raporteve të KGJK-së, në vitin 2017⁵⁵, DKR-të e gjykatave themelore kanë pasur në punë nëntë (9) lëndë, prej të cilave pesë (5) lëndë i kanë trashëguar nga viti 2016, ndërsa katër (4) lëndë të reja i kanë pranuar në punë. Nga nëntë (9) lëndë, gjatë këtij viti DKR-të nuk kishin zgjidhur asnjë lëndë të krimeve të luftës.

⁵⁵ Të dhënat nga Raporti i DKR-ve për vitin 2017, dërguar nga Drejtori i Departamentit të Statistikave në KGJK, Besnik Ramosaj me 21 prill 2020.

Në vitin 2018, DKR-të kanë pasur në punë 13 lëndë, prej të cilave nëntë (9) i kanë bartur nga viti 2017, derisa kanë pranuar edhe katër (4) lëndë të reja. Nga 13 lëndë në punë, gjatë këtij viti DKR-të kanë zgjidhur vetëm dy (2), ndërsa kanë mbetur të pazgjidhura 11 lëndë.⁵⁶

Në vitin 2019, DKR-të kanë pasur në punë 13 lëndë të krimeve të luftës, prej të cilave 11 i kanë bartur nga viti 2018, ndërsa dy (2) lëndë të reja i kanë pranuar në punë. Nga 13 lëndë në punë, sipas raportit vjetor të DKR-vë të gjykatave themelore, rezulton se janë zgjidhur vetëm tre (3) lëndë, ndërsa kanë mbetur të pazgjidhura 10 lëndë.⁵⁷



Grafika 2: Ngarkesa me lëndë të krimeve të luftës në DKR-të e GjTh-ve gjatë periudhës 2017-2019.

IKD ka analizuar edhe ngarkesën dhe efikasitetin e secilës gjykatë me lëndë të krimeve të luftës për tri vitet e fundit, 2017, 2018 dhe 2019.

Gjatë vitit 2017, sipas raportit të DKR-së, GjTh në Mitrovicë ka pasur më së shumti lëndë me gjithsej shtatë (7) lëndë të krimeve të luftës, prej të cilave nuk e ka zgjidhur asnjërën nga to. DKR-ja e GjTh në Prishtinë dhe Gjilan kanë pasur në punë nga një (1) lëndë të krimeve të luftës, të cilat gjatë këtij viti i'u kanë mbetur të pazgjidhura, ndërsa DKR-të e GjTh në Prizren, Ferizaj, Gjakovë dhe Pejë nuk kanë qenë të ngarkuara me asnjë lëndë të krimeve të luftës gjatë vitit 2017.

Gjatë vitit 2018, GjTh në Mitrovicë ka pasur në punë tetë (8) lëndë të krimeve të luftës, prej të cilave vetëm një (1) e ka zgjidhur, ndërsa kanë mbetur të pazgjidhura edhe shtatë (7) sosh. GjTh në Pejë ka pasur në punë dy (2) lëndë, prej të cilave nuk e ka zgjidhur asnjërën, ndërsa

⁵⁶ Të dhënat nga Raporti i DKR-ve për vitin 2018, dërguar nga Drejtori i Departamentit të Statistikave në KGJK, Besnik Ramosaj me 21 prill 2020.

⁵⁷ Të dhënat nga Raporti i DKR-ve për vitin 2019, dërguar nga Drejtori i Departamentit të Statistikave në KGJK, Besnik Ramosaj me 21 prill 2020.

GjTh në Prishtinë dhe Gjilan kanë qenë të ngarkuara me nga një (1) lëndë të cilën asnjëra gjykatë nuk e ka zgjidhur.

Në vitin 2019, GjTh në Mitrovicë ka pasur në punë nëntë (9) lëndë të krimeve të luftës, prej të cilave i ka zgjidhur vetëm dy (2) ndërsa i kanë mbetur të pazgjidhura edhe shtatë (7) prej tyre, DKR-ja e GjTh në Pejë ka pasur në punë dy (2) lëndë, prej të cilave një (1) e ka zgjidhur dhe një (1) lëndë tjetër ka mbetur e pazgjidhur. GjTh në Prishtinë dhe Prizren, gjatë kësaj periudhe kanë pasur në punë nga një (1) lëndë të krimeve të luftës, duke mos arritur t'i zgjidhin këto lëndë gjatë këtij viti. Ndërsa DKR-të e GjTh në Gjilan, Gjakovë dhe Ferizaj nuk kanë pasur asnjë lëndë të kësaj natyre gjatë vitit 2019.

	2017			2018			2019		
Prishtinë	1	0	1	1	0	1	1	0	1
Mitrovicë	7	0	7	8	1	7	9	2	7
Gjilan	1	0	1	1	1	0	0	0	0
Ferizaj	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Prizren	0	0	0	1	0	1	1	0	1
Pejë	0	0	0	2	0	2	2	1	1
Gjakovë	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Total	9	0	9	13	2	11	13	3	10

Tabela 3: Ngarkesa e DKR-ve të GjTH-ve me krime të luftës për periudhën 2017, 2018 dhe 2019⁵⁸.

Sipas raporteve vjetore të DKR-ve të gjykatave themelore vërehet se më së shumti lëndë të krimeve të luftës ka pasur GjTh në Mitrovicë, ndërsa GjTh në Gjakovë dhe Ferizaj për tri vite nuk kanë pasur asnjë lëndë për krime lufte.

Mbështetur në këto statistika, IKD vlerëson se është i pamohueshëm konkludimi se sistemi i drejtësisë në Republikën e Kosovës ka dështuar në trajtimin e rasteve të krimeve të luftës. Zgjidhja e pesë (5) lëndëve të krimeve të luftës për tri (3) vite dëshmon faktin se në rastet e krimeve të luftës, sistemi gjyqësor, përkatësisht DKR-të e PTh-ve nuk kanë treguar as efikasitet e as prioritizim të rasteve të krimeve të luftës, përkundër rëndësisë së trajtimit të këtyre rasteve.

⁵⁸Këto statistika përfshihen për secilën gjykatë veç e veç nga kapitulli XV i KPPRK-së, “Veprat penale kundër njerëzimit dhe vlerave të mbrojtura me të drejtën ndërkombëtare”, ku përfshihen këto vepra penale: krimet kundër njerëzimit, krimet e luftës në shkelje të rëndë të Konventave të Gjenevës, Krimet e luftës në shkelje të rëndë të ligjeve dhe zakoneve që zbatohen në konfliktin e armatosur ndërkombëtar, krimet e luftës të rëndë të nenit 3 të përbashkët të Gjenevës, Krimet e Luftës në shkelje të ligjeve dhe zakoneve që zbatohen në konfliktet e armatosura që nuk janë të karakterit ndërkombëtar, organizimi i grupeve për kryerjen e gjenocidit, krimeve kundër njerëzimit dhe krimeve të luftës.

Për më tepër, në këto raste nuk është manifestuar as niveli minimal i efikasitetit dhe prioritizimit, që konsiston në respektimin e afateve ligjore në trajtimin e këtyre rasteve. Duke vepruar në këtë mënyrë, veprimtaria e DKR-vë të GjTh-ve nuk ka reflektuar rëndësinë e trajtimit të këtyre rasteve për publikun dhe për interesin e drejtësisë në rastet e krimeve të luftës në Republikën e Kosovës.

	Burgim efektiv	Dënim me Gjobë	Dënim me Kusht	Aktgjykim Lirues	Aktgjykim Refuzues	Është zgjidhur në mënyrë tjetër
2017	0	0	0	0	0	0
2018	0	0	0	1	0	1
2019	0	0	0	1	0	2

Tabela 4: Llojet e dënimeve të shqiptuara nga DKR-të e GjTh gjatë viteve 2017, 2018 dhe 2019.

Sa i përket mënyrës së zgjidhjes së këtyre rasteve, në asnjërin nga këto pesë (5) raste, sipas statistikave zyrtare të KGJK-së, nuk evidentohet asnjë aktgjykim dënues. Përkatësisht, sipas statistikave të KGJK-së, në dy (2) raste janë nxjerrë aktgjykime liruese, derisa tri (3) raste të tjera janë zgjidhur në mënyrë tjetër.

Por, krahas këtyre statistikave, IKD gjen se të njëjtat nuk paraqesin plotësisht tablon reale në trajtimin e rasteve të krimeve të luftës. Kjo pasi gjatë monitorimit sistematik që IKD i bënë sistemit prokurorial dhe atij gjyqësor, është evidentuar një rast (1) i krimeve të luftës i cili ka përfunduar me aktgjykim dënues të formës së prerë, sipas të cilit aktgjykim, Skender Bislimi është dënuar me burgim efektiv në kohëzgjatje prej 10 viteve.

Lidhur me këtë, IKD ka kërkuar nga KGJK informata në lidhje me mospërputhshmërinë e të dhënave, ku të njëjtat në një përgjigje të dhënë me 19 qershor 2020, kanë deklaruar se në raportet e tyre janë të përfshirë vetëm disa nene të veprave penale të krimeve të luftës.

“Për rastet ne fjale ju konfirmojmë se janë raste që kanë të bëjnë me veprën penale krime lufte. Gjithashtu janë të përfshira edhe në raportet vjetore të cilat i posedoni ju, në fund të formularit tek ”TË TJERA (LIGJET QË NUK JANË TË PËRFSHIRA NË KETË FORMULARË)”, thuhet në përgjigjen e dhënë nga KGJK.⁵⁹

Në këtë mënyrë, rasti i vetëm i trajtuar nga prokurorët vendorë i cili ka rezultuar me aktgjykim të formës së prerë është i një të dënuari, sipas etnisë, shqiptar.

Sidoqoftë, këto statistika dëshmojnë dështimin e PSRK-së, përkatësisht Departamentit për Krime Lufte në kuadër të kësaj prokurorie, në hetimin dhe përfaqësimin e rasteve të krimeve të luftës, pasi nga të gjitha rastet e zgjidhura, vetëm njëri prej tyre ka përfunduar me aktgjykim dënues.

⁵⁹ Përgjigjja e Drejtorit të Departamentit të Statistikave në KGJK, z.Besnik Ramosaj e datës 19 qershor 2020.

Në këtë drejtim, IKD vlerëson se kjo statistikë duhet të shërbejë si alarm për sistemin prokurorial, posaçërisht për KPK-në dhe PSRK-në. Kjo pasi një mungesë e tillë e rezultateve, humb edhe kuptimin e ekzistimit të një departamenti të veçantë në PSRK për trajtimin e rasteve të krimeve të luftës.

Në anën tjetër, Departamentet Speciale të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Gjykatës së Apelit që nga funksionalizimi i tyre më 1 korrik 2019 e deri më tani nuk kanë zgjidhur asnjë lëndë të krimeve të luftës. Gjatë vitit 2019, ky departament ka pasur në punë pesë (5) lëndë për krime lufte, prej të cilave katër (4) kanë mbetur të pazgjidhura, ndërsa njëra (1) është bartur në kompetencë.

9.2.Strategjia e KPK-së për Krime të Luftës

KPK më 21 shkurt 2019 ka miratuar Strategjinë për Krime Lufte. Në hyrje të kësaj strategjie thuhet se PSRK që nga qershori i vitit 2018, ka marrë kompetencat ekskluzive për t'i hetuar dhe ndjekur penalisht krimet e luftës dhe shkeljet e tjera të së drejtës humanitare ndërkombëtare dhe të së drejtës penale. Në sqarimin e këtij paragrafi, thuhet se UNMIK-u dhe më vonë EULEX-i kanë pasur kompetenca për këto kategori të lëndëve prej përfundimit të konfliktit deri më 2016-2018, dhe se këto institucione kanë pasur mandat që t'i kryejnë të gjitha funksionet gjyqësore, të cilat zakonisht kryhen nga organet vendore dhe në emër të organeve vendore.

Por, ky narrativ i përcaktuar në këtë strategji është jo i plotë, përkatësisht i mangët, dhe nuk tregon realitetin e kompetencave të misionit të EULEX-it, dhe rrjedhimisht, edhe të kompetencave të PSRK-së.

Kjo pasi që nga viti 2014, mandati i EULEX-it ishte për rastet në proces, dhe rrjedhimisht, shtrirja e mandatit të PSRK-së kufizohej vetëm në këto raste, derisa për rastet e tjera, kishte mandat ekskluziv.

Në këtë mënyrë, IKD konsideron se një sqarim i tillë i dhënë në këtë strategji është tendencë e sistemit prokurorial për të shmangur përgjegjësinë që ky sistem ka pasur që nga viti 2014 e deri më sot.

Në anën tjetër, sipas kësaj strategjie, me zbatimin e së njëjtës synohen: sigurimi i hetimit dhe ndjekjes penale dhe pretendimeve serioze për krime të luftës dhe krime të tjera, sipas të drejtës ndërkombëtare dhe në përputhje me standardet e të drejtës ndërkombëtare penale, duke përfshirë zhdukjen e detyruar dhe vrasjen e personave të zhdukur gjatë dhe pas luftës, që lëndët që grumbullohen të caktohen prioritetet e tyre me përqendrim në përgjegjësinë komanduese dhe kontrolluese në vend të shënjestrimit vetëm të të dyshuarve të nivelit të ulët, sigurimi i konfidencialitetit të hetimeve dhe dëshmimeve, sigurimi i dëshmitarëve dhe informatorëve.

Po ashtu, kjo strategji parasheh që të sigurohet nivel i shtuar i ruajtjes së provave në rastet kur ka rrezik të konsiderueshëm që provat e tilla mos të jenë në dispozicion më pas në shqyrtim

gjyqësor, duke pasur parasysh kohën e gjatë që ka kaluar që nga kryerja e pretenduar e krimeve, rritjen e bashkëpunimit të organeve hetuese me Zyrën për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave, të sigurohet trajtim i barabartë i të dyshuarve dhe të pandehurve, pavarësisht përkatësisë së tyre kombëtare, etike dhe religjioze, të rritet bashkëpunimi dhe bashkërendimi me të gjitha agjencitë kombëtare të angazhuara në hulumtimin dhe hetimin e krimeve të luftës dhe shkeljeve të tjera të së drejtës ndërkombëtare humanitare.

Tutje, kjo strategji parasheh edhe rritjen e promovimit të bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar në fushën e hetimit dhe ndjekjes penale të krimeve të luftës dhe shkeljeve të tjera të së drejtës ndërkombëtare humanitare, rritjen e bashkëpunimit me organizatat joqeveritare dhe shoqatat e familjeve të viktimave, rritjen e shkallës së vetëdijesimit publik për nevojën e hetimit dhe ndjekjes penale të krimeve të luftës dhe shkeljeve të tjera të së drejtës ndërkombëtare humanitare, gjetjen e mënyrës për t'i kapërcyer pengesat juridike, politike dhe të sigurisë gjatë përpjekjeve për të marrë informata të MTPN-së/TNPJ-së, përkitazi me lëndët për Republikën e Kosovës dhe të sigurohet një përqendrim i veçantë në lëndët që përfshijnë krime të dhunës seksuale, por edhe të zhvillohen dhe zbatohen strategji për fuqizimin e të mbijetuarve përmes procesit të drejtësisë.

Kjo strategji në mesin e objektivave kishte përcaktuar që Kryeprokurori i Shtetit do t'i emëroj pesë (5) prokurorë të mbështetur nga gjashtë (6) zyrtarë ligjor, të cilët do të merren ekskluzivisht me lëndët e krimeve të luftës.

Lidhur me kompetencën që kjo prokurori i jep Kryeprokurorit të Shtetit për të emëruar pesë (5) prokurorë, duke abstrahuar faktin e mos zbatimit në praktikë të kësaj kompetence nga ana e Kryeprokurorit të Shtetit, vet miratimi i një përcaktimi të tillë në këtë strategji paraqet shkelje të Kushtetutës dhe Ligjit nga ana e KPK-së. Madje, një përcaktim i tillë paraqet shkelje të rregullave që vet KPK ka përcaktuar.

Kjo pasi emërimi, transferimi dhe avancimi i prokurorëve sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës janë kompetenca ekskluzive që i takojnë vetëm KPK-së, dhe jo edhe Kryeprokurorit të Shtetit.

Në këtë drejtim, neni 110.2. i Kushtetutës së Republikës së Kosovës përcakton se “Këshilli Prokurorial i Kosovës do të rekrutojë, propozojë, avancojë, transferojë, disiplinojë prokurorët në mënyrën e rregulluar me ligj”.

Kompetenca e këshillit për të transferuar prokurorë, është e materializuar edhe në nenin 28 të Ligjit nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës.

Rasti i vetëm kur Kryeprokurori i Shtetit ka kompetencë për transferimin e një prokurori sipas paragrafit 6 të nenit 28 të këtij ligji janë rastet e jashtëzakonshme. Neni 7.2. i Rregullores për

Transferin dhe Avancimin e Prokurorëve të Shtetit⁶⁰ përcakton se periudha e këtij lloj transferimi nuk mund të jetë më e gjatë se 30 ditë.

Në rastin e strategjisë, nuk përcaktohet fare afati kohor, por se edhe sikur kjo të bëhej në një afat 30 ditor, një transferim i tillë nuk paraqet asnjë relevancë në ngritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të trajtimit të rasteve të krimeve të luftës.

Tutje, në këtë strategji është paraparë edhe bashkëpunimi rajonal, për shkak të mungesës së marrëveshjes së Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë përkitazi me krimet e luftës dhe shkeljet e të drejtës ndërkombëtare humanitare, duke përfshirë fatin e personave të zhdukur, pasi nuk ekziston bashkëpunim ndërmjet organeve të ndjekjes penale të Kosovës dhe Zyrës së Prokurorëve për Krime të Luftës të Serbisë. I vetmi protokoll ekzistues i bashkëpunimit është ai ndërmjet Policisë së EULEX-it dhe MUP-it serb.

Në këtë strategji thuhet se për zbatim të suksesshëm të këtij dokumenti kërkohet bashkëpunim formal me mekanizmin e mbetur për tribunalet penale ndërkombëtare, me qëllim qasjen në dokumente, informata dhe prova të përdorura në procedurat para Tribunalit Ndërkombëtar Penal për ish-Jugosllavinë.

Pikë tjetër e kësaj strategjie është edhe bashkëpunimi me Organizatat e Shoqërisë Civile dhe Organizatave Joqeveritare, në mënyrë që këto organizata të japin kontribut në hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve të luftës dhe krimeve të tjera të rënda sipas të drejtës ndërkombëtare.

⁶⁰ *Shënim:* Kjo rregullore është nxjerrë para ligjit aktual në fuqi, por e njëjta është e zbatueshme sipas nenit 37.3. të Ligjit nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës.


10. Trajtimi i krimeve të luftës sipas etnisë

Përkundër faktit se sipas të gjitha raporteve kredibile vendore dhe ndërkombëtare Republika e Serbisë paraqitet si agresor përballë viktimës kosovare, ndjekjet dhe gjykimet penale ndaj kosovarëve, përkatësisht shqiptarëve, kanë qenë shumë më evidente se sa ato të ndërmarra ndaj shtetasve të Republikës së Serbisë.

Në këtë drejtim, përballë disbalancit të madh etnik në numrin e viktimave nga lufta e fundit në Kosovë, paradoksalisht, në hetimin dhe gjykimin e krimeve të luftës, ky disbalanc ndryshon kahje.

Nga tetori i vitit 1999 e deri në qershor të vitit 2020 kanë qenë gjithsej 117 të akuzuar. Nga ky total i numrit të të akuzuarve, 62 prej tyre ishin të kombësisë shqiptare, 49 serbë, pesë (5) malazezë dhe një (1) nga komuniteti RAE⁶¹.

Shprehur në përqindje, nga totali i të akuzuarve, 54.95% kanë qenë shqiptarë, 39.6% serbë, 4.5% malazezë dhe 0.9% nga komuniteti RAE:



Grafika 3: Numri i të akuzuarve për krime lufte nga UNMIK, EULEX dhe prokurorët vendor sipas etnisë (Tetor 1999 – Qershor 2020).

Kjo disbalancë është jashtëzakonisht më e theksuar në rastin e numrit të personave të dënuar për krime lufte gjatë luftës së fundit në Kosovë.


Sipas të dhënave të FHD-së, gjatë periudhës kohore tetor 1999 – tetor 2018, nga gjyqtarë të UNMIK-ut, EULEX-it dhe vendorë, me aktgjykime të formës së prerë janë dënuar gjithsej 39

⁶¹ "PASQYRË E GJYKIMEVE PËR KRIMET E LUFTËS NË KOSOVË NË PERIUDHËN 1999-2018". Fondi për të Drejtën Humanitare. f.144 (Shih linkun <https://www.hlc-kosovo.org/wp-content/uploads/2018/10/HLC-Kosovo-An-overview-of-war-crime-trials-in-Kosovo-1999-2018.pdf>). (Qasur së fundi me 6 gusht 2020).

persona, prej tyre plot 34 shqiptarë dhe vetëm katër (4) serbë, derisa për krime lufte me aktgjykim të formës së prerë është dënuar edhe një (1) person i nacionalitetit malazezë.

Krahas kësaj, pas kësaj periudhe, është edhe një rast i krimeve të luftës i cili ka përfunduar me aktgjykim dënues të formës së prerë, i dënuari në të cilin rast është i etnisë shqiptare, që e krijon totalin prej 35 shqiptarëve të dënuar për krime lufte të kryera gjatë luftës së fundit në Kosovë.

Shprehur në përqindje, i bie se nga të gjithë të dënuarit për krime lufte nga UNMIK, EULEX dhe gjyqtarët vendorë, 87.5% e tyre janë të etnisë shqiptare dhe vetëm 10% të tyre janë të etnisë serbe, derisa 2.5% janë të etnisë malazeze.



Grafika 4: Numri i të dënuarve për krime lufte nga UNMIK, EULEX dhe gjyqtarët vendor sipas etnisë (Tetor 1999 – Qershor 2020).

Në këtë drejtim, këto të dhëna dëshmojnë dështim të dyfishtë si të institucioneve ndërkombëtare ashtu edhe të sistemit të drejtësisë kosovare.

Fillimisht, numri i përgjithshëm i të akuzuarve, e veçanërisht të dënuarve për krime të kryera gjatë luftës së fundit në Kosovë në asnjë rrethanë nuk paraqet ndjekje dhe gjykim efektiv të këtyre rasteve, duke lënë nën mjegull shumë krime makabre të kryera gjatë luftës së fundit në Kosovë.

Por, ky dështim është jashtëzakonisht më i avancuar në raport me viktimat shqiptare, për krimet ndaj të cilëve, nga UNMIK-u, EULEX-i dhe sistemi i drejtësisë kosovare janë dënuar vetëm katër (4) persona.

11. Krimet makabre pa përgjigje nga drejtësia

Përballë dështimeve të paraqitura më lartë, janë një numër i konsiderueshëm i krimeve makabre të kryera ndaj qytetarëve kosovarë gjatë luftës së fundit në Kosovë, për të cilat krime, drejtësia ende nuk ka dhënë përgjigje.

- **Masakra e familjes Jashari** - Më 30 dhjetor të vitit 1991, ishte kryer sulmi i parë ndaj familjes Jashari. Ndërsa sulmin e dytë forcat paramilitare serbe e kanë kryer në muajin janar, 1998. Më 22 janar forcat serbe sulmuan familjen Jashari, por edhe kësaj beteje, fëmijët dhe gratë e familjes Jashari kishin rezistuar, ndërkaq, në këto luftime të plagosura kishin mbetur Iliriana, vajza e Rifat Jasharit dhe Selvetja, vajza e Hamzë Jasharit. Sulmi i tretë, që kishte ndodhur më 5, 6 dhe 7 mars të vitit 1998 ndaj familjes Jashari, mori jetën e 55 njerëzve në fshatin Prekaz, 22 prej të cilëve ishin familjarë të ngushtë të Adem Jasharit. Këtij sulmi i kishte mbijetuar vetëm Bashkimi, djali i Rifatit, i cili i'a del që mes datës 5-6 mars të largohet nga rrethina dhe arrin t'i shpëtojë sulmit, si dhe Besarta, vajza e Hamzës, e cila pa dhe përjetoi tmerrin derisa vriteshin anëtarët e familjes së saj.⁶²
- **Masakra e Reçakut** - Më 15 Janar 1999, në Reçak janë vrarë e masakruar 45 shqiptarë të paarmatosur. Policia dhe ushtria serbe në Kosovë kanë kryer masakra të shumta gjatë viteve 1998 dhe 1999, por Masakra e Reçakut u dëshmuar nga misioni i OSBE-së në Kosovë, që ndikoi në ndërhyrjen e NATO-s ndaj caqeve serbe. Pasi e pa me sytë e tij këtë skenë, shefi i misionit të OSBE-së, Wiliam Walker, kishte alarmuar se në Kosovë po ndodhte krim kundër njerëzimit, gjë që shtyu bashkësinë ndërkombëtare të ndërmarrë misionin ushtarak, pas të cilit forcat serbe u tërhoqën nga Kosova.⁶³
- **Masakra e Izbicës** - Kurse, më 28 mars 1999, ka ndodhur masakra e Izbicës, ku nga forcat policore e ushtarake të armikut janë vrarë 147 shqiptarë. Pas masakrës, kufomat e të vrarëve, i varrosen fshatarët e kësaj ane në fshatin Izbicë, por forcat serbe i zhvarrosën duke i dërguar në lokacione të ndryshme në Kosovë e Serbi.⁶⁴
- **Masakra e Rezallës** - Më 5 prill 1999, ka ndodhur masakra në Rezallë të Skenderajt, ku nga ushtria dhe policia serbe u ekzekutuan 98 shqiptarë, banorë të Rezallës dhe fshatrave përreth, nga të cilët 44 ishin munduar t'i zhdukjin. Një pjesë e trupave u gjenden në Rudnicë të Rashkës dhe i'u dorëzuan familjarëve. Më 5 prill të vitit 1999

⁶² “21 vjet nga rënia heroike e familjes Jashari”. Koha.net. 5 mars 2019. (Shih linkun <https://www.koha.net/arberi/148547/21-vjet-nga-renia-heroike-e-familjes-jashari/>). (Qasur së fundi me 6 gusht 2020).

⁶³ “21 vjet nga Masakra e Reçakut”. Koha.net. 15 janar 2020. (Shih linkun <https://www.koha.net/arberi/203778/21-vjet-nga-masakra-e-recakut/>). (Qasur së fundi me 6 gusht 2020).

⁶⁴ “Nëna Fatë kërkon drejtësi për të bijën e saj 6 muajshe të masakruar nga paramilitarët serbë në Izbicë”. Koha.net. 28 mars 2019. (Shih linkun <https://www.koha.net/arberi/153333/nena-fate-kerkon-drejttesi-per-te-bijen-e-saj-6-muajshe-te-masakruar-nga-paramilitaret-serbe-ne-izbice/>). (Qasur së fundi me 6 gusht 2020).

serbët rrethuan shtëpitë e këtyre familjeve dhe pushkatuan pothuajse të gjithë burrat dhe djemtë e rinj. Nga kjo masakër kanë shpëtuar të gjallë tre persona.⁶⁵

- **Masakra e burgut të Dubravë** – Kjo masakër është një ndër masakrat më të mëdha të kryera nga regjimi serb ndaj shqiptarëve. Kjo masakër është kryer nga 19 deri me 24 maj të vitit 1999, ku brenda këtij burgu janë vrarë 160 të burgosur shqiptarë dhe janë plagosur më shumë se 300 të tjerë.⁶⁶
- **Masakra e Krushës së Madhe** - Një ndër masakrat tjera të pamëshirshme është edhe ajo që ka ndodhur më 25, 26 e 27 mars të vitit 1999, në fshatin Krushë të Rahovecit, ku janë masakruar 243 persona, ndërsa 893 shtëpi private dhe shoqërore janë djegur.⁶⁷
- **Masakra e Rogovës së Hasit** - Edhe në Rogovë të Hasit ka ndodhur masakër nga forcat serbe, ku nuk janë kursyer as shumë civilë të fshatit. Në datat 27, 28 dhe 29 janar të vitit 1999 në këtë fshat ranë dëshmorë 21 persona. Aty heroikisht dhanë jetën: Agim Zeneli, Luan Smajli, Agron e Sejdi Rama, Pren e Meme Lleshi, Agush Gjoci, Valon Gashi, Bahtjar Morina, Daut Kelmendi, Emrush Çeta, Kasim Shala, Hamdi Berisha, Gezim Ademi, Haxhi Lypjani, Gasper Karaçi, Ilir Merturi, Naim Gashi, Naim Dreshaj, Sahit Krasniqi dhe Vesel Avdyli.⁶⁸
- **Masakra në Studime të Vushtrrisë** - Me 2 maj 2020, janë bërë 21 vjet kur në Studime të Vushtrrisë nga forcat serbe u vranë 116 shqiptarë të pafajshëm, të cilët u nxorën nga kolona e qindra njerëzve që kishin marrë rrugën për në Shqipëri. Nga dëshmitarët mësohet se 116 civilët u pushkatuan brenda dy orëve.⁶⁹
- **Masakra e Mejës** - Ndërkaq, më 27 prill 1999, forcat serbe kishin rrethuar Rekën e Keqe dhe Lugun e Carragojës në rrethinën e Gjakovës. Në orët e hershme të mëngjesit kishte filluar grumbullimi i meshkujve në grupe, nga mosha 15-60 vjeçare. Në 15 fshatra të rrethit të Gjakovës janë ekzekutuar të gjithë meshkujt shtëpi për shtëpi. Sipas Koha.net, njësitet e ushtrisë serbe, policia, beretat e kuqe, paramilitarët, fqinjët e maskuar krijuan kordonin me imazhet e Srebrenicës duke ekzekutuar 376 meshkuj shqiptarë në atë që njihet si dita e festës së Jugosllavisë së fundit e cila nën vallen e gjakut ishte krijuar me lojërat e juristëve të Millosheviqit më 27 prill 1992. Atë ditë asnjëri nga të ndalurit nuk arriti të dilte i gjallë nga Meja. Pas luftës, gjatë viteve 1999-

⁶⁵ “Jashari: Rezalla, ndër masakrat që bindi botën se Serbia po kryente gjenocid në Kosovë”. Koha.net. 5 prill 2020. (Shih linkun <https://www.koha.net/arberi/216214/21-vjet-nga-masakra-e-rezalles/>). (Qasur së fundi me 6 gusht 2020).

⁶⁶ “20 vjet nga masakra në Burgun e Dubravës”. Koha.net. 19 maj 2020. (Shih linkun <https://www.koha.net/arberi/163684/20-vjet-nga-masakra-ne-burgun-e-dubraves/>). (Qasur së fundi me 6 gusht 2020).

⁶⁷ “21 vjet nga masakra në Krushë të Madhe”. Klan Kosova. 26 mars 2020 (Shih linkun <https://klankosova.tv/21-vjet-nga-masakra-ne-krushe-te-madhe/>). (Qasur së fundi me 6 gusht 2020).

⁶⁸ “21 vjet nga masakra në Rogovë të Hasit”. Koha.net. 29 janar 2020. (Shih linkun <https://www.koha.net/arberi/206009/21-vjet-nga-masakra-ne-rogoe-te-hasit/>). (Qasur së fundi me 6 gusht 2020).

⁶⁹ “21 vjet nga Masakra e Studimes në Vushtri, rrëfime të familjarëve të viktimave (VIDEO)”. Klan Kosova. 2 maj 2020. (Shih linkun <https://klankosova.tv/21-vjet-nga-masakra-e-studimes-ne-vushtri-rrfime-te-familjareve-te-viktimave-video1/>). (Qasur së fundi me 6 gusht 2020).

2001 një pjesë e tyre është gjetur në varreza të ndryshme masive në Kosovë dhe për të tjerët janë marrë informata se gjenden në Serbi.⁷⁰

Për të gjitha këto masakra, në asnjërin rast drejtësia nuk e ka dhënë fjalës e saj përmes aktgjykimeve dënuese të formës së prerë.

Madje, në vetëm dy (2) prej këtyre masakrave ka të akuzuar. Lidhur me masakrën në Krushë të Madhe, kishte qenë i akuzuar një (1) person i cili ishte liruar, derisa për masakrën e Studimes është një (1) i akuzuar, rasti i të cilit është ende në proces.

⁷⁰ “20 vjet nga Masakra e Mejës”. Koha.net. 27 prill 2019. (Shih linkun <https://www.koha.net/arberi/159476/20-vjet-nga-masakra-e-mejes/>). (Qasur së fundi me 6 gusht 2020).

12. Trajtimi i krimeve të luftës nga perspektiva e familjarëve të viktimave

Me qëllim të krijimit të një pasqyre më të afërt lidhur me trajtimin e krimeve të luftës në Republikën e Kosovës, IKD ka marrë edhe të dhëna direkte nga terreni.

Me këtë rast, IKD ka intervistuar 16 familjarë të viktimave të krimeve të luftës së fundit në Kosovë, ku të njëjtat janë pyetur nëse janë intervistuar ndonjëherë për rastin e tyre, si dhe nëse kanë njohuri lidhur me statusin aktual të rastin të tyre në sistemin e drejtësisë.

Familjarët e intervistuar për qëllime të këtij hulumtimi bëjnë pjesë nga zona të ndryshme të territorit të Republikës së Kosovës, në të cilat janë kryer krime gjatë luftës së fundit në Kosovë. Numri i familjarëve të humbur nga të njëjtit është nga një (1) deri në 13.

Nga totali i të intervistuarve, IKD ka identifikuar gjithsej pesë (5) raste, ku familjarët e viktimave të krimeve të luftës nuk janë intervistuar asnjëherë, as nga UNMIK, as nga EULEX si dhe as nga prokurorët vendorë. Shprehur në përqindje, i bie se nga totali i të intervistuarve, 31.25% e tyre nuk janë intervistuar as edhe një herë të vetme.

Nga të gjithë të intervistuarit, gjashtë (6) prej tyre kanë deklaruar se janë intervistuar nga misioni i UNMIK-ut, ndërsa pesë (5) të tjerë kanë deklaruar se nuk janë intervistuar nga ky mision. Pesë (5) të tjerë kanë deklaruar se nuk kanë informacion nëse janë intervistuar nga misioni i UNMIK-ut. Shprehur në përqindje, i bie se nga totali i të intervistuarve, 45.45% e tyre janë intervistuar nga misioni i UNMIK-ut, 54.54% nuk janë intervistuar nga ky mision, derisa 45.45% e të intervistuarve nuk kanë informacion.

Sa i përket EULEX-it, gjashtë (6) prej të intervistuarve kanë deklaruar se janë intervistuar nga ky mision, ndërsa gjashtë (6) të tjerë kanë deklaruar se nuk janë intervistuar nga EULEX, derisa katër (4) të intervistuar të tjerë nuk kanë njohuri nëse janë intervistuar apo jo nga misioni i EULEX-it. Shprehur në përqindje, i bie se 37.5% e personave të intervistuar janë intervistuar nga misioni i EULEX, përqindje kjo ekuivalente me numrin e personave të pa intervistuar nga ky mision, derisa 25% e të intervistuarve kanë deklaruar se nuk kanë informacion nëse janë intervistuar nga EULEX.

Ndërsa, nga totali i të intervistuarve, numrin më të vogël të intervistimeve del ta ketë PSRK. Nga të gjithë personat e intervistuar, vetëm dy (2) prej tyre kanë deklaruar se janë intervistuar nga PSRK, derisa 9 të tjerë kanë deklaruar se nuk janë intervistuar nga kjo prokurori. Ndërsa, pesë (5) të tjerë kanë deklaruar se nuk kanë informacion lidhur me këtë çështje. Shprehur në përqindje, i bie se nga totali i të intervistuarve, vetëm 12.5% e tyre janë intervistuar nga PSRK, derisa nuk janë intervistuar gjithsej 56.25% e të intervistuarve. Ndërsa, 31.25% e të intervistuarve kanë deklaruar se nuk kanë informacion mbi intervistimin nga PSRK.

Sa i përket statusit aktual të lëndëve, nga intervistimi i familjarëve të viktimave të krimeve të kryera gjatë luftës së fundit në Kosovë, IKD gjenë se në shumicën e rasteve, këta familjarë nuk kanë informacion mbi statusin aktual të lëndës.

Të dhënat e gjeneruara nga intervistimi i familjarëve të viktimave të krimeve të kryera gjatë luftës së fundit në Kosovë, janë paraqitur në mënyrë statistikore në tabelën në vijim, pas së cilës, IKD ka paraqitur rrëfimin e secilit familjar të viktimave të krimeve të kryera gjatë luftës së fundit në Kosovë, të intervistuar për qëllime të këtij hulumtimi nga IKD:

I intervistuari	Vendi ku ka ndodhur ngjarja	Numri i familjarëve vrarë/zhdukur	Intervistuar nga:			Kallëzim penal	Aktakuzë	Vendimi
			UNMI	EULE	PSRK			
Fakir Berati	Smirë/Viti	1	Po	Jo	Jo		Po	15 vite
Nexhmedin Gerxhaliu	Studime e Poshtme/Vusht rri	13	Po	Po	Jo	-	-	-
Njomza Muqa	Bukosh/Suhare kë	1	Nuk ka njohuri					
Laureta Luzha	Vraniq/Suhare kë	1	Nuk ka njohuri					
Shaqir Ukshini	Zhegër/Gjilan	2	Po	Po	Jo	Po	Nuk ka njohuri	Nuk ka njohuri
Ymer Ibishi	Llashticë/Gjilani	1		Po		Po	Jo	Pushuar hetimet
Nexhat Shabani	Gjilan	5	Po	Po	Jo	Nuk ka njohuri		
Muhedin Haziri	Zhegër/Gjilan	3			Po	Po	Po	14 vite
Kushtrim Ajupi	Zym/Dragash	1	Jo	Jo	Jo	Jo		
Agron Limani	Krushë e Vogël/Rahovec	4		Po	Po	Po	Po	22 vite
Besnik Tarjani	Piran/Prizren	2 të zhdukur	Po	Nuk ka njohuri				

Adelina Gjnovci	Makërrmal/Skenderaj	1 i vrarë, 2 të zhdukur	Jo	Jo	Jo	Jo		
Nel Thaqi	Mirushë/Malishevë	2	Jo	Jo	Jo	Jo		
Nura Rashkaj	Krushë e Vogël/Rahovec	5	Po	Po		Po	Nuk ka njohuri	
Rrahim Ymeri	Bellobrad/Opojë	1	Jo	Jo	Jo	Jo		
Anonim	Gjakovë	3	Jo	Jo	Jo	Jo		

Tabela 5: Statistikat nga intervistat me familjar të viktimave të luftës.

Rrëfimet e familjarëve të viktimave të luftës në Kosovë

Në vijim, IKD ka paraqitur intervistat që ka zhvilluar me familjarët e viktimave të krimeve të kryera gjatë luftës së fundit në Kosovë.

- **Rrëfimi i djalit të të ndjerit, Ramadan Berati**

Më 15 prill të vitit 1999, paramilitarët serb, kishin hyrë në fshatin Smirë, konkretisht në lagjen e quajtur “Lagjja e Dëshmorëve” në Smirë, ku të gjithë banorët e kësaj lagje kishin dalë në rrugë për të ikur nga fshati. Në atë ditë, nga paramilitarët serb, ishin zënë dhe torturuar, burra, djem e gra të këtij fshati, por që si person i shënjestruar nga ana e tyre ishte, Ramadan Berati, i moshës 45 vjeçare, ku ndaj të njëjtit ishte ushtruar dhunë duke e rrahur me shkopinj, ku si pasojë e plagëve të marra, ai kishte ndërruar jetë në mëngjesin e 16 prillit të vitit 1999. Pos të ndjerit, Ramadan Beratit, dhunë ishte ushtruar edhe ndaj dy djemve të tij, Fejzi Beqiri dhe Fakir Beqiri, por që terror dhe dhunë kanë përjetuar edhe shumë persona të asaj lagje, po që fatmirësisht nuk kishin përfunduar me fatalitet.

Pas luftës, diku në vitin 2000- 2001 nga ana e UNMIK-ut, në bashkëpunim me KFOR-in, është gjetur njëri nga pjesëmarrësit në bastisjen e fshatit dhe vrasjen e Ramadan Beratit, i ashtu quajtur, Gjida Nallbani, ku i njëjti edhe është identifikuar nga familjarët dhe shumë bashkëfshatarë, si kryes i terrorit dhe dhunës ndaj popullatës civile në Smirë. Në vitin 2000-2001, ndaj Gjida Nallbanit, është ngritur aktakuzë dhe i njëjti është dënuar nga ish - Gjykata e Qarkut në Gjiilan, ku dhe i është shqiptuar një dënim prej 15 viteve burgim.

Tutje sipas rrëfimit të familjes Berati, pas një kohe kishin dëgjuar zëra se i akuzuari-krimineli Gjida Nallbani, ishte transferuar në Serbi për të vuajtur dënimin, dhe për këtë familja nuk kishin pranuar asnjë vendim apo informacion nga askush, dhe me rastin e interesimit për arsyen e

lirimit të vrasësit, familjarët theksojnë se në arsyetimin e dhënë nga disa persona, është thënë se ky transfer i të dënuarit ka ndodhur me arsyetimin e lirimit të dy të burgosurve – shqiptarë, në luginën e Preshevës. *Nga ajo ditë e deri me sot, nuk kanë asnjë informacion lidhur me kryerësin e veprës, se a është liruar apo ka vuajtur dënimin e shqiptuar nga Gjykata në Kosovë.* Po ashtu Fakir Berati, ka theksuar se nga ai gjykim nuk posedojnë asnjë lloj të vendimit, procesverbal apo ndonjë dokument tjetër.

Lidhur me punën e prokurorisë dhe në përgjithësi shtetit, familja thekson se janë të zhgënjyer totalisht, duke u nisur nga puna e UNMIK-ut, EULEX-it e deri tek Gjykatat e Kosovës lidhur me këtë çështje. Po ashtu nga Institucionet dhe organet e shtetit askush deri me tani nuk është interesuar për të marrë ndonjë informatë si për rastin, njashtu edhe për gjendjen ekonomike sociale të kësaj familje.

- **Rrëfimi i mashkullit të vetëm të mbetur gjallë nga familja e shuar në Studime të Poshtme, në Vushtrri**

Nexhmedin Gërxfhaliu, mashkulli i vetëm i familjes së tij që mbeti gjallë, ka rrëfyer se 13 anëtarë të familjes së tij, në Studime të Poshtme, në Vushtrri janë vrarë gjatë luftës në Kosovë.

Ai ka rrëfyer se në luftë ka humbur nënën e tij, Salihe Gërxfhaliu, gruan e tij, Sofije Gërxfhaliu, djalin e tij Safer Gërxfhaliu, vëllaun e tij Selatin Gërxfhaliu, gruan e vëllait të tij, Fexhrije Gërxfhaliu, Shaban Gërxfhaliu, Shahin Gërxfhaliu, Muharrem Gërxfhaliu, Mexhid Gërxfhaliu, Abdurrahim Gërxfhaliu, Hubera Gërxfhaliu, Sabahudin Gërxfhaliu dhe djalin e xhaxhait të tij, Xhemajl Gërxfhaliu.

Ai ka rrëfyer se kjo ngjarje ka ndodhur më 31 maj të vitit 1999, në Vushtrri, natën e festës së Bajramit, te Reka e Vushtrrisë dhe se nuk ka informata se kush ka kryer vrasjen. Ndërkaq, familjari Shahin Gërxfhaliu, sipas tij, është vrarë me 27 mars 1999.

Sipas Gërxfhaliut, rasti ka ndodhur në Studime të Poshtme, në shtëpinë e tyre, nga ushtarët serb, përveç Selatin, Shaban dhe Xhemajl Gërxfhaliut, që janë marrë dhe vrarë në mes të fshatit të lartcekur, pasi paraprakisht në sy të tyre i kanë vrarë të gjithë familjarët e tij. Mirëpo, deklaroi se ai ka qenë jashtë vendin dhe se nuk e di me emra se kush ka kryer këtë akt.

Ai ka deklaruar nga prokuroria e UNMIK-ut dhe EULEX-it është marrë në pyetje disa herë në cilësinë e familjarit (dëmtuarit), kurse nga prokuroria apo policia vendore nuk është marrë në pyetje asnjëherë.

Në pyetjen se pasi është intervistuar a është informuar nga ana e organit të ndjekjes për veprimet procedurale që janë ndërmarrë, ai është përgjigjur se “Nuk jam në dijeni, nuk e besoj”. Kurse, deklaroi se me shkresa zyrtare asnjëherë nuk është informuar për fazën e mëtutjeshme të procedurës.

Kurse, në fund, Nexhmendin Gërxhaliu, ka thënë *“Ne jemi shtet pa shtet, në këtë vend ligj e drejtësi nuk ka, ligji punon veç për të mëdhenj”*.

- **Rrëfimi i vajzës së njërit nga viktimat së Masakrës së Bukoshit**

Njomza Muqa, vajza e të ndjerit Ragip Muqa, është rrëfyer për masakrën e Bukoshit, njëra ndër krimet më barbare të serbëve, që ka ndodhur me 3 maj 1999, në shkollën e fshatit Bukosh të Komunës së Suharekës, ku janë masakruar 24 meshkuj të fshatrave Bukosh, Savrov dhe Vraniq.

“Ngjarja ka ndodhur në mëngjesin e 3 majit 1999. Pas dy javësh që kemi qëndruar në malet e Buzhalës, babai im, këtu i ndjeri erdhi na mori që të na strehonte në një vend tjetër më të sigurt. Rrugës duke ecur në kolonën e refugjatëve, policia serbe e ndalonte çdo familje dhe ia merrte burrat që ishin me ta. E ndalën edhe familjen time, gjegjësisht babin. E kanë marrë policia dhe e kanë futur në shkollë. Pas tyre e kemi pa një ekip të ushtarëve serb që po vinin në drejtim të shkollës ku do të kryhej masakra, në një tenkë, këndonin e qeshnin, me thika të mëdhaja në duar. Mendoj se aj ekip edhe e ka kryer masakrën.” ka rrëfyer Njomza.

Ajo ka rrëfyer se nuk është në dijeni që dikush nga familja e saj është intervistuar nga ana e organeve të drejtësisë lidhur me këtë ngjarje.

Në fund të intervistës, ajo ka thënë se shteti është treguar tejet indiferent ndaj familjeve si ajo e saj, e sidomos ka thënë se për masakrën e Bukoshit flitet fare pak, pavarësisht se janë 24 viktima.

- **Rrëfimi i vajzës së martirit Ramadan Luzha, nga fshati Vraniq, Komuna e Suharekës**

Laura Luzha, ka rrëfyer se vrasja e babait të saj ka ndodhur me 2 maj 1999, në vendin e quajtur, *“Stani i Azem Mehmetit”* në bjeshkët e Vraniqit. Ndërkaq, ka rrëfyer se nuk ka dijeni se kush e ka privuar të ndjerin nga jeta.

Lidhur me rastin, ajo deklaroi se njëri nga familjarët, Beqir Luzha, është intervistuar për rastin, por se nuk ka njohuri se a është intervistuar nga prokuroria në kohën e UNMIK-ut, EULEX-it, apo PSRK.

“Shumë të pakënaqur me mos zbardhjen e vrasjes së babait tim”, ka thënë ajo në fund të intervistës.

- **Rrëfimi i familjarit që humbi nënën dhe babanë në Zhegër të Gjilanit**

Shaqir Ukshini, ka rrëfyer se gjatë luftës në Kosovë, ka humbur dy prindërit e tij, babanë në moshë 70 vjeç dhe nënën e moshës 68 vjeçare. Sipas tij, rasti ka ndodhur me 30 mars 1999 kur është ekzekutuar babai i tij në Zhegër të Gjilanit, ndërsa trupi i nënës së tij ishte gjetur më 1 prill 1999.

“Babai është vrarë nga paramilitarët serb në dhomën e ndejës. Nëna dyshohet nga fqiu i parë Rada, mbiemrin nuk ia di, vetëm se dyshoj në këtë”, ka thënë ai.

Ai ka deklaruar se vëllai i tij është intervistuar me dhjetëra herë nga viti 1999, nga EULEX e UNMIK dhe se nuk kanë marrë ndonjë përgjigje apo vendim relevant.

Sipas tij, në vitin 2005 fshati ka dorëzuar kallëzim penal në prokurori, por që për të s’kanë marrë ndonjë përgjigje.

Ai ka deklaruar se nuk kanë marrë ndonjë informacion, vetëm se kanë njohuri se për komshiun e tyre të quajtur “Rada”, që nuk ia di mbiemrin, është ngritur aktakuza, por që nuk kanë informata më shumë për rastin.

“Kohën e fundit ka pasur lëvizje, por kërkesat tona janë më të mëdha. Ligji ka fillu me u zbatu por janë të vogla krejt këto çfarë bëjnë. Kanë rehatu njerëz, dhe kanë bërë përfitime të ndryshme, unë si shtetas s’kam parë që po punohet për vendin si duhet”, ka thënë në fund të intervistës ai.

- **Rrëfimi i djalit për babanë që iu vra në Llashticë**

Ymer Ibishi, ka rrëfyer se babai i tij i është vrarë në vitin 1999 në Llashticë të Gjilanit, në moshën 67 vjeçare. Kurse, ka thënë se ata që e shkaktuan vrasjen e babait të tij janë Forcat Serbe.

Për këtë ngjarje, ai ka thënë se është intervistuar nga Prokuroria e EULEX-it, në cilësi të dëshmitarit dhe se lidhur me rastin në fjalë, është marrë aktvendim për pushimin e hetimeve.

Ai ka thënë se është njoftuar përmes një shkresë zyrtare nga ana e prokurorisë në të cilën shkresë thuhej se hetimet kanë pushuar.

“Kjo shkresë të cilën unë e kam marrë në duar, më është dorëzuar tri ditë para kalimit të afatit ligjor për bërjen e ankesës. Në atë shkresë thuhej se Forcat Serbe nuk janë fajtor për krimin e bërë ngase me asnjë provë të vetme nuk del në pah fajësia e tyre”, ka thënë ai.

Ai ka deklaruar se ai personalisht nuk ka paraqitur kallëzimin penal pasi që kanë qenë organe të tjera që kanë inicuar procedurën dhe një komision i quajtur "Komisioni i Avokatëve" ka qenë ai që më ka intervistuar. Sipas tij, ky Komision ka qenë sipas detyrës zyrtare shtëpi më shtëpi.

“Puna e Prokurorisë dhe e organeve të drejtësisë në përgjithësi vlerësohet me notën "nën zero", sepse këta të fundit kanë bërë shumë pak në zbardhjen e krimeve të luftës për të mos thënë fare. Unë si familjar jam shumë i zhgënjyer nga sistemi i drejtësisë që sot është prezent në vendin tonë”, ka thënë ai.

- **Rrëfimi i familjarit që humbi 5 anëtarë të familjes, mes tyre një fëmijë të porsalindur dhe një fëmijë 2 vjeçar**

Nehat Shabani, ka rrëfyer se në vitin 1999, ka humbur pesë pjesëtarë të familjes, ndër të cilët dy fëmijë, njëri i sapo lindur (tre javë jetë), kurse tjetri i moshës dy vjeçare. Gjithashtu, ka thënë se ka humbur babanë në moshën 80 vjeç, një pjesëtar tjetër të familjes të moshës afër 50 si dhe një femër të moshës në të 40-tat e vona. Sipas tij, këtë masakër ndaj familjes së tij, e kanë bërë forcat serbe.

Lidhur me rastin, ai ka deklaruar se janë intervistuar në cilësi të dëshmitarit, nga ana e UNMIK-ut dhe EULEX-it në fund të mandatit të tyre.

Ai ka thënë se nuk është në dijeni se çfarë është ndërmarrë sepse askush nuk e ka njoftuar për procedurat e mëtutjeshme të asaj se si janë duke u zhvilluar hetimet.

“Prokurorët e EULEX-it kanë qenë ata që kanë përpiluar dosjen dhe më kanë dorëzuar një shkresë një ditë para se të kalonte afati ligjor për bërjen e ankesës. Mezi kam arritur ta dorëzoj ankesën, dhe atë me postë, nuk e di se si e kam dorëzuar tamam në kohë për shkak të afatit shumë të shkurtër kohor”, ka deklaruar ai.

Ai ka deklaruar se nuk i kujtohet nëse ka paraqitur vetë kallëzim penal, por se i kujtohet se është pyetur nga prokurorët.

“Prokuroria është duke bërë shumë pak, ajo që mua më shqetëson më shumë është fakti se Serbia do që ne të na bëjë fajtor për krimet e kryera dhe vetë të dalë e pastër nga tërë këto masakra që janë kryer në Kosovë. Theksoj se Prokuroria duhet të punojë më tepër në këtë drejtim”, ka thënë ai.

- **Rrëfimi i familjarit për tre familjarët e humbur në fshatin Zhegër**

Muhadin Haziri, ka thënë se në vitin 1999, në fshatin Zhegër, i janë vrarë të dy prindërit, babai i moshës 56 vjeçare dhe nëna në moshën 54 vjeçare. Gjithashtu, ka thënë se ka humbur edhe xhaxhain në moshën 65 vjeç.

“Unë posedoj aktgjykim të formës së prerë, në të cilin aktgjykim thuhet se Vllada Zmajeviq është personi që ka kryer këto krime”, ka thënë ai.

Ai ka thënë se nuk janë intervistuar asnjëherë, përpos në vitin 1999 në fund të muajit të tetë, kanë bërë zhvarrimin e trupave të anëtarëve të familjes sime për të konstatuar nëse vrasja e tyre është rrjedhojë e ndonjë plumbi ose diçka tjetër.

“Dikur më vonë, janë mbajtur seancat gjyqësore dhe jam dëgjuar në cilësinë e dëshmitarit”, ka thënë Haziri.

Sipas Hazirit, ai nuk është njoftuar për veprimet hetimore që janë ndërmarrë, por vetëm për konfirmimin e aktakuzës dhe atë më ka njoftuar prokurorja Drita Hajdari dhe se me sa i kujtohet janë mbajtur gjithsej njëmbëdhjetë seanca gjyqësore deri në shpalljen e aktgjykimit.

Ai ka thënë se është marrë në pyetje nga prokuroria dhe se personalisht nuk ka paraqitur kallëzim penal, sepse, në vitin 2002/2003 Këshilli i Fshatit në harmoni me të gjithë familjarët e viktimave të krimeve të luftës kanë inicuar procedurat e nevojshme, prandaj, edhe familja e tij ka qenë e përfshirë tek kjo iniciativë e ndërmarrë nga ana e tyre.

“Puna që bënë prokuroria është shumë e paktë, duhet punuar akoma dhe më shumë”, ka thënë ai në fund.

- **Rrëfimi i familjarit për vrasjen e xhaxhait nga ana e forcave paramilitare serbe**

Kushtrim Ajupi, ka rrëfyer se xhaxhai i saj, Hashim Ajupi është vrarë në moshën 17 vjeçare. Vrasja ka thënë se ka ndodhur në shtëpinë e tyre, në vitin 1998, nga forcat paramilitare serbe.

“Shtëpia jonë ka qenë target i tyre, ngase i kemi pasur përball. Baza e tyre, vendi ku kanë qenë të vendosur, ka qenë përball me shtëpinë tonë dhe atë e kanë vrarë në shtëpi, në fakt në ballkonin e shtëpisë. Ne e kemi pasur të vizatuar shqipen, në shtëpi, më saktë mbi ballkon, mbase kjo ka ndikuar për t’ua tërhequr vëmendjen më shumë dhe për ta vrarë”, ka thënë ai.

Ai ka thënë se në kohën e luftës ka qenë 9 vjeçar, mirëpo nga ajo që është njoftuar dhe ka dëgjuar nga babai i tij, as prokuroria në kohën e UNMIK-ut, EULEX-it, e as PSRK nuk janë marrë me rastin e xhaxhait të tij.

“Asnjëherë nuk kanë ardhur të na marrin deklaratën, e as nuk na kanë marrë në pyetje lidhur me vdekjen e tij”, ka thënë ai, duke bërë të ditur se personalisht nuk kanë parashtruar kallëzim penal.

Në fund, ai ka deklaruar se do të ishte mirë që shteti dhe prokuroria të interesohen lidhur me këto vrasje pasi të njëjtat nuk bënë të kalohen pa u ndëshkuar.

“Është e vërtetë se ne nuk e dimë kush e ka vrarë në mënyrë të veçantë, pra kush e ka shkrepuar armën. Mirëpo, ata kanë pasur komandantin e tyre, dikush duhet të jap përgjegjësi, për jetët e pafajshme të civilëve në kohën e luftës”, ka thënë ai.

- **Rrëfimi i familjarit për humbjen e katër anëtarëve të familjes në Krushë të Vogël**

Agron Limani, ka deklaruar se babai 71 vjeçar, xhaxhai 58 vjeçar, vëllai 44 vjeçar dhe djali i xhaxhait, 23 vjeçar i janë vrarë me 26 mars 1999, në fshatin Krushë të Vogël- Komuna e Rahovecit, nga forcat ushtarake- policore serbe të ndihmuara nga banorët lokal serb, duke përfshirë tashmë të dënuarin Darko Tasiq, Memilo Nikolic, Ranko Nikolic, Ranko Petkovic, Sava Nikolic etjerë.

Agron Limani ka thënë se më herët ka dhënë deklarata në EULEX, ndërsa më vonë edhe në PSRK, saktësisht tek prokurorja speciale, Drita Hajdari, ku deklaratat i kishte dhënë në cilësi të dëshmitarit okular.

“Ndërsa, në vitin 2012 në fshatin Krushë e Vogël, nga EULEX-i ishte mbajtur seancë dëgjimore, në lidhje me krimet e luftës në këtë fshat”, ka thënë ai.

Ai ka thënë se është informuar nga EULEX-i se është ngritur aktakuzë ndaj disa serbëve, mirëpo që nuk i kujtohet se për cilët me emra, ndërsa tha se e din që njëri nga të akuzuarit është dënuar me 22 vite burgim, e ai është Darko Tasiq,

Limani ka thënë se më herët kanë qenë shumë të zhgënjyer me autoritet shtetërore, ndërsa tani po shihen disa lëvizje në këtë aspekt, e sidomos pas dënimit të Darko Tasiq, edhe pse nuk janë të kënaqur me lartësinë e dënimit.

- **Besnik Tarjani, nga fshati Piran, Komuna e Prizrenit, rrëfen se ka të zhdukur dy prindërit e tij, nënën 58 vjeçare dhe babanë 63 vjeçar**

Besnik Tarjani, ka rrëfyer se për vendndodhjen e prindërve të tij nuk din asgjë që nga 24 marsi i viti 1999 dhe se nuk ka ndonjë person që e di me emër që mund t’i ketë vrarë apo larguar nga vendi në të cilin ndodheshin prindërit e tij, mirëpo sipas tij kjo ka ndodhur nga forcat policore ushtarake serbe.

Tutje , ai ka thënë se rastin e ka paraqitur në UNMIK, në vitin 1999 ose 2000, ku edhe i ka paraqitur prindërit e tij si të zhdukur dhe ka kërkuar edhe ndihmë që t’i gjejnë ata.

Në UNMIK, ai është paraqitur në cilësinë e dëshmitarit, duke u treguar se që nga data 24 mars prindërit e tij nuk janë parë më, mirëpo asnjëherë nuk kanë marrë asnjë informatë nga UNMIK-u.

Limani ka deklaruar se është i pakënaqur nga autoritetet shtetërore, sepse as nuk është ndihmuar asgjë, e as nuk është ndërmarr ndonjë hap në lidhje me gjetjen e prindërve të tij.

- **Familjarja nga Skenderaj, rrëfen për dy pjesëtarë të familjes të zhdukur e për djalin e axhës që trupin ia gjetën pas 10 vitesh**

Adelina Gjinovci, ka rrëfyer se babai i saj, Fadil Gjinovci dhe xhaxhai i saj, Enver Gjinovci janë ende të zhdukur që nga koha e luftës, përderisa djali të xhaxhait të saj, Arton Gjinovci, i është gjetur trupi, 10 vite pas luftës, saktësisht në vitin 2009.

Rasti ka thënë ajo se ka ndodhur më 2 prill 1999, në fshatin Makërrmal, Komuna e Skenderaj, përderisa ka thënë se me emra nuk e di kush e ka kryer ngjarjen, por se e dinë se kanë qenë paramilitarë serb.

Ajo ka thënë se asnjëherë nuk janë intervistuar nga prokuroria në kohën e UNMIK-ut, EULEX-it, apo PSRK.

Sipas saj, si familje nuk kanë paraqitur asnjë kallëzim penal lidhur me këto krime, pasi kanë pritur që dikush tjetër do i ndërmerret këto veprime. Ajo ka thënë se personat që kanë kryer krimin nuk i kanë njohur dhe se të njëjtit kanë vepruar në grup në kohën kur janë kryer veprat penale.

“Sa i përket këtij rasti asnjëherë nuk kemi pranuar asnjë shkrese nga ana e askujt, përveç një aktvendimi lidhur me çështjen civile, sa i përket padisë se ushtruar për kompensim dëmi, nga ana e Gjykatës Themelore në Mitrovicë, dega në Skenderaj, e cila e ka shpallur veten jo kompetente në aspektin lëndor”, ka thënë ajo.

- **Rrëfimi i familjarit për dy vëllezërit e rënë në fshatin Mirushë të Malishevës**

Nel Thaqi, ka deklaruar se i janë vrarë dy vëllezërit e tij, Vesel Thaqi i moshës 25 vjeçare dhe Dukagjin Thaqi, i moshës 18 vjeçare, në përfundim të luftës në vitin 1999.

“Kanë rënë në fushë të minuar nga okupatori serb, ndërmjet fshatit Mirushë dhe Malishevës, në vendin e quajtur “Ara Mulla Ademit”, në istikame të UÇK-së, të cilat bashkë me shokë i kanë punuar për mbrojtje”, ka thënë ai.

Sipas tij, janë vizituar varrezat, mirëpo nga UNMIK-u, EULEX-i dhe PSRK-ja, si familje nuk janë intervistuar kurrë.

Ai ka thënë se punën e prokurorisë dhe në përgjithësi shtetit e vlerëson me notën zero.

- **Rrëfimi i familjares që humbi 5 anëtarë të familjes në fshatin Krushë e Vogël**

Nura Rashkaj, ka rrëfyer se në vitin 1999, në fshatin Krushë e Vogël, i janë vrarë 5 anëtarë të familjes, bashkëshorti i saj Hisni Rashkaj 56 vjeçar, kunati Nazmi Rashkaj 48 vjeçar dhe tre

djem te kunetërve, Demir Rashkaj 17 vjeçar Kadri Rashkaj 16 vjeçar dhe Refki Rashkaj 17 vjeçar nga ana e serbëve lokal të fshatit dhe forcat tjera paramilitare dhe policore serbe.

Ajo ka deklaruar se familja e saj kanë dhënë intervistë për prokurori në kohë të UNMIK-ut, në cilësi të dëmtuarve.

Sipas saj, asnjëherë nuk janë informuar nga prokuroria për veprimet hetimore të ndërmarra.

Ajo ka thënë se si familje në vitin 2005, kanë ngritur një kallëzim penal në Prokurorinë e Qarkut në Prizren, por se asnjëherë nuk janë informuar për rrjedhën e rastit.

“Më shumë dyshime dhe skeptik se të njëjtit do të zbardhin rastin e familjarëve”, ka thënë ajo kur është pyetur se si e vlerëson punën e prokurorisë dhe shtetit në përgjithësi për zbardhjen e vrasjeve të ndodhura gjatë luftës.

- **Rrëfimi i familjarit që humbi djalin e tij 17 vjeçar në fshatin Bellobrad të Opojës**

Rrahim Ymeri, ka rrëfyer se me 31 mars 1999, djali i tij Shkëlqim Ymeri, ende pa i mbushur 18 vjet është vrarë në fshatin Bellobrad të Opojës, rrugës duke shkuar për në Shqipëri nga ushtria paramilitare serbe.

Ai ka rrëfyer se me 31 mars të vitit 1999, forcat ushtarake serbe i kanë dëbuar të gjithë banorët e fshatit Blaç, po edhe fshatrat tjera nga Opoja e Dragashit, dhe janë nisur për në Shqipëri.

Sipas tij, ushtria e Serbisë ka shtënë në djalin e tij, me tre plumba duke e lënë të vrarë në vend.

“Djalin nuk kemi guxuar me e varrosur, e as prekur, sepse nuk kemi guxuar”, ka treguar Rrahim Ymeri duke thënë se të nesërmen me disa vendas tjerë, me kërkesë dhe leje nga forcat ushtarake paramilitare serbe e kanë varrosur shpejt e shpejt dhe janë nisur për në Shqipëri.

Ai ka thënë se për këtë rast nuk kanë paraqitur rast në prokurori, por se as nuk janë intervistuar ex- officio asnjëherë nga organi i ndjekjes.

- **Rrëfimi i familjarit që humbi tre anëtarë të familjes në vendin e njohur si “Kodra e Çabratit”**

Më 10 maj të vitit 1999, në rrugën “Shefki Shasivari”, vend i njohur ndryshe si “Kodra e Çabratit”, janë marrë nga shtëpia e tyre, tre persona të gjinisë mashkullore, një 37 vjeçar, një 31 vjeçar dhe një 28 vjeçar.

Përderisa, familjarët e të vrarëve, kanë deklaruar se nuk janë në dijeni se kush kanë qenë personat të cilët e kanë kryer vrasjen e më të dashurve të tyre.

Gruaja e njërit nga të vrarët ka shpjeguar ngjarjen në pika të shkurta. Sipas saj, ditën kritike ishin duke ngrënë drekë në momentin kur kanë hyrë ushtarët serb.

Ajo ka thënë se së bashku me bashkëshortin e saj nga frika kishin kapur në krahë fëmijët e tyre. Më pas, ushtarët serb kishin klasifikuar gjininë mashkullore, dhe bashkëshortit të saj i kishin kapur djalin nga dora dhe e kishin hedhur në tokë. Tutje, ajo vazhdoi duke treguar se pasi që ushtarët kanë zbritur tek dera e oborrit kanë mbyllur derën e më pas janë dëgjuar krisma të njëpasnjëshme. Kështu, e njëjta pasi kishte dëgjuar se makina ishte nisur, me vrap ka shkuar tek dera oborrit, ka hapur derën dhe aty ka parë disa pika gjaku. Nga ai moment, ajo nuk kishte pritur asnjëherë që bashkëshorti i saj do t'i kthehej gjallë.

Lidhur me ngjarjen, ajo ka thënë se familja nuk ka parashtruar kallëzim penal dhe se as nuk janë intervistuar sipas detyrës zyrtare nga prokuroria në kohën e UNMIK-ut, EULEX-it, apo PSRK.

13. Themelimi dhe aktiviteti i Gjykatës Speciale

Në fund të vitit 2010, gazetari Paul Lewis kishte publikuar pjesë nga raporti i përpiluar nga senatori zviceran i Këshillit të Evropës Dick Marty, me titullin “*Kryeministri i Kosovës është udhëheqës i trafikimit me organe njerëzore dhe me armë, thotë një raport i Këshillit të Evropës*”.

Ky raport, presidentin Hashim Thaçi e përshkruante si udhëheqës të një grupi mafioz shqiptar që trafikonte heroinë, armë dhe organe njerëzore. Tutje, raporti fliste për të ashtuquajturën “Shtëpia e Verdhë” në Shqipëri, ku Marty pretendonte se ishin nxjerrë organet e të burgosurve serbë⁷¹.

Ky raport, i njohur si raporti i Dick Martit, mban emërtimin “Hetimi rreth dyshimeve për trajtim çnjerëzor dhe trafikim të organeve në Kosovë”, dhe është miratuar me 25 janar 2011, nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës miratoi me vetëm tetë vota kundër.⁷²

Më 3 gusht 2015, pas shumë polemikash e tentimesh, me 82 vota pro, pesë kundër e një abstenim, Kuvendi i Republikës së Kosovës me anë të ndryshimeve kushtetuese i kishte hapur rrugë krijimit të Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar, të njohura ndryshe si Gjykata Speciale. Pas amandamentimit të Kushtetutës, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar edhe dy projektligje, përkatësisht Ligjin për Dhomat e specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar dhe Ligjin për Mbrojtjen Juridike dhe financiare të personave të akuzuar potencialë në proceset gjyqësore pranë Dhomave të Specializuara.

Me anë të votimit të ndryshimeve kushtetuese, pas nenit 161, është shtuar neni 162, ku thuhet se “Për t’i përmbushur obligimet ndërkombëtare në lidhje me Raportin e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, Dokumenti 12462, datë 7 janar 2011, Republika e Kosovës mund të themelojë Dhoma të specializuara dhe një Zyre të Prokurorit të Specializuar në kuadër të sistemit të drejtësisë të Kosovës. Organizimi, funksionimi dhe juridiksioni i Dhomave të specializuara dhe i Zyrës së Prokurorit të specializuar rregullohen me këtë nen dhe me ligj të veçantë”.

Ligji për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, i miratuar më 3 gusht 2015, si juridiksion lëndor në bazë të nenit 6, përcakton juridiksionin mbi krimet e parapara në nenet 12 – 16 që kanë të bëjnë me Raportin e Asamblesë së Këshillit të Evropës. Dhomat e Specializuara po ashtu kanë juridiksion mbi veprat e parapara në kapitullin XXXII, nenet 384-386, 388, 390-407, dhe kapitullin XXXIII nenet 409-411, 415, 417, 419, 421, dhe Kapitullin XXXIV, nenet 423-424 të Kodit Nr.04/L-082 Penal të Republikës së Kosovës, kur ato kanë të bëjnë me procedurat zyrtare dhe zyrtarët e tyre.

⁷¹ “*Historia e Speciales – nga raporti i Martyt deri tek përpjekja për zhbërje*”. Koha.net. 14 janar 2019 (Shih linkun <https://www.koha.net/arberi/139656/historia-e-speciales-ndash-nga-raporti-i-martyt-deri-tek-perpjekja-per-zhberje/>). (Qasur së fundi me 6 gusht 2020).

⁷² “*Asambleja Parlamentare e KE-së miraton raportin e Dik Martit për Kosovën*”. Zëri i Amerikës. 25 janar 2011. (Shih linkun <https://www.zeriamerikes.com/a/asambleja-parlamentare-e-ke-se-miraton-raportin-e-dik-martit-per-kosoven-114585134/457215.html>). (Qasur së fundi me 6 gusht 2020).

Kurse, në nenin 7 të këtij ligji si juridiksion kohor përcaktohen veprat penale në kuadër të juridiksionit lëndor të tyre të cilat janë kryer mes periudhës 1 janar 1998 dhe 31 dhjetor 2000. Ndërkaq, në nenin 8 të këtij ligji përcaktohet juridiksioni territorial, në të cilin nen nënvizohet se “Në përputhje me juridiksionin territorial të gjykatave të Kosovës sipas ligjeve penale të zbatueshme që kanë qenë në fuqi mes periudhës 1 janar 1998 dhe 31 dhjetor 2000, Dhomat e specializuara kanë juridiksion mbi veprat penale që bien nën juridiksionin lëndor të tyre të cilat janë filluar ose janë kryer në Kosovë”.

Ndërkaq, Kuvendi i Republikës së Kosovës, ka miratuar edhe Ligjin për Mbrojtjen Juridike dhe Mbështetjen Financiare të Personave të Akuzuar Potencial në Proceset Gjyqësore pranë Dhomave të Specializuara, i cili ligj ka për qëllim mbrojtjen juridike dhe mbështetjen financiare të personave të akuzuar potencial në proceset gjyqësore dhe procedurat e ndërlidhura, për krimet e pretenduara pranë Dhomave të Specializuara.

Por, pas miratimit ndryshimit kushtetues dhe miratimit të këtyre ligjeve, më 22 dhjetor 2017, në Kuvendin e Republikës së Kosovës, ishte bërë një tentativë për të zhbërë Gjykatën Speciale, çka kishte nxitur reagimin e komunitetit diplomatik ndërkombëtar në Kosovë.

Sa i përket aktivitetit të Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar, në fund të vitit 2018 ishte pranuar ftesa e parë, e cila si destinacion kishte pasur ish-komandantin e Zonës Operative të Llapit, Rustem Mustafa, i njohur si Komandant “Remi”. Ky i fundit ishte ftuar për t’u intervistuar më 14 janar 2019, pranë Zyrës së Prokurorit të Specializuar të Kosovës (ZPS) në Hagë.

Pas kësaj, ftesa kishin pranuar edhe ish-kryetari i Gjykatës Ushtarake të UÇK-së, Sokol Dobruna, ish-komandanti i UÇK-së nga Zona e Drenicës, Sami Lushtaku, ish-Komandanti i përgjithshëm i UÇK-së, Sylejman Selimi, ish-komandanti i UÇK-së nga Dukagjini, Ramush Haradinaj, ish -komandanti i UÇK-së nga Zona e Nerodimes, Shukri Buja, ish-shefi i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, Azem Sylja, Kadri Veseli, Rexhep Selimi e shumë persona të tjerë. Ndryshe, për intervistim, nga ZPS, ishte ftuar edhe ish-Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri.

Ndryshe, deri më tani, nga ZPS janë intervistuar mbi 200 persona⁷³.

Më 24 qershor 2020, afërsisht pesë vite pas themelimit të kësaj gjykate, nga ZPS, ishte bërë njoftimi se është ngritur aktakuzë ndaj Presidentit të Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, kryetarit të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli dhe disa të tjerëve, për krime kundër njerëzimit dhe krime lufte. I gjithë ky njoftim kishte ndodhur tre ditë para takimit në Washington, mes palës kosovare dhe asaj serbe, ku më pas Thaçi kishte anuluar këtë takim, e pas tij, pjesëmarrjen në takim e kishte anuluar edhe kryeministri i Republikës së Kosovës, Avdullah Hoti.

⁷³ "Mbi 200 persona të intervistuar nga Gjykata Speciale, a do të ndodhin arrestimet e para këtë muaj". Gazeta Express. 6 nëntor 2019. (Shih linkun <https://www.gazetaexpress.com/mbi-200-persona-te-intervistuar-nga-gjykata-speciale-a-do-te-ndodhin-arrestimet-e-para-kete-muaj>). (Qasur së fundi me 6 gusht 2020).

Sipas njoftimit, më 24 prill 2020, Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) u paraqiti Dhomave të Specializuara të Kosovës (DHSK) një aktakuzë me dhjetë pika për shqyrtim prej Gjykatës, ku Hashim Thaçi, Kadri Veseli dhe të tjerë akuzohen për një sërë krime kundër njerëzimit dhe krime lufte, ndër të cilat vrasje të paligjshme, zhdukje e detyruar e personave, përndjekje dhe tortura.

“Në Aktakuzë pretendohet se Hashim Thaçi, Kadri Veseli dhe të dyshuar të tjerë janë penalisht përgjegjës për afërsisht 100 vrasje të paligjshme. Krimet e paraqitura në Aktakuzë përhijjnë qindra viktimat të identifikuar shqiptarë, serbë dhe romë të Kosovës dhe kundërshtarë politikë. Aktakuza është vetëm një padi penale e cila është rezultat i një hetimi të gjatë dhe dëshmon vendosmërinë e ZPS-së se mund t’i provojë të gjitha akuzat jashtë dyshimit të arsyeshëm. Një gjykatës i procedurës paraprake i DHSK-së është duke e shqyrtuar Aktakuzën për të vendosur nëse do t’i konfirmojë akuzat”, thuhet në njoftim.

Sipas Prokurorit të Specializuar, publikimi i këtij njoftimi është i domosdoshëm, për shkak të siç thuhet në njoftim, përpjekjeve të përsëritura të Hashim Thaçit dhe Kadri Veselit për pengimin dhe sabotimin e punës së DHSK-së.

“Besohet se z. Thaçi dhe z. Veseli kanë ndërmarrë në fshehtësi një fushatë për shfuqizimin e ligjit që krijoi Gjykatën dhe ndryshe kanë penguar punën e Gjykatës në orvatje për t’i bishtnuar drejtësisë. Nëpërmjet këtyre veprimeve, z. Thaçi dhe z. Veseli kanë vënë interesat e tyre vetjake mbi viktimat e krimeve të tyre, sundimin e ligjit dhe popullin e Kosovës”, thuhej në njoftim.⁷⁴

Sa i përket këtij njoftimi për media, IKD fillimisht vlerëson se e njëjta komunikatë paraqet qasje selektive të këtij institucioni, pasi në të njëjtën është përmendur vetëm emri i z. Thaçi dhe z. Veseli, dhe jo edhe emri i të akuzuarve të tjerë të përfshirë në po këtë aktakuzë.

Por, në anën tjetër, publikimi i këtij njoftimi paraqet shkelje të rregullave të punës, të miratuara pikërisht nga Dhomat e Specializuara.

Rregulli 88 i Rregullores së Procedurës dhe Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës, rregullore kjo e miratuar pikërisht nga Dhomat e Specializuara të Kosovës, përcakton se aktakuza bëhet publike pas konfirmimit të së njëjtës nga gjykata.

Në këtë drejtim, ky rregull përcakton se “(1) Varësisht prej paragrafit (2), pas konfirmimit prej gjykatësit të procedurës paraprake, aktakuza bëhet publike. (2) Në rrethana të posaçme, në rast se para konfirmimit të aktakuzës Prokurori i Specializuar paraqet arsye të vlefshme, për arsye të sigurisë, për parandalimin e arratisjes së të akuzuarit, apo të çrregullimit të procedurave, ose trazirave shoqërore, gjykatësi i procedurës paraprake, ndër të tjera, mund të urdhërojë përkohësisht mosnxjerrjen publike të aktakuzës, dokumenteve ose informacionit

⁷⁴ “Specialja ngritë aktakuzë kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit e personave tjerë, akuzohen për rreth 100 vrasje të paligjshme”. Betimi për Drejtësi. 24 qershor 2020. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/specialja-ngrite-aktakuze-kunder-hashim-thacit-kadri-veselit-e-personave-tjere-akuzohen-per-rreth-100-vrasje-te-paligjshme/>). (Qasur së fundi me 6 gusht 2020).

që ka lidhje me aktakuzën deri në një urdhër të dytë. Sidoqoftë, aktakuza bëhet publike, nëse është e nevojshme me redaktime, jo më vonë se paraqitja e parë e të akuzuarit. (3) Pavarësisht nga paragrafi (2), Prokurori i Specializuar mund t’u bëjë të njohur aktakuzën ose një pjesë të saj autoriteteve të një shteti të tretë apo subjekti tjetër, në qoftë se e gjykon të nevojshme për hetimin ose ndjekjen penale”.

Sipas Presidentit të Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, i njëjti para ngritjes së akuzës nuk është ftuar për tu intervistuar nga ZPS. Ky i fundit pas lajmit për ngritjen e akuzës kishte njoftuar se është ftuar që me 13 korrik 2020 të paraqitet në Hagë për t’u intervistuar nga ZPS, përderisa nuk është bërë e ditur se në çfarë cilësie apo për çfarë i njëjti do të intervistohet. Me këtë rast, Thaçi ishte intervistuar plot katër (4) ditë nga prokurori i ZPS-së.

14. Adresimi i hetimit dhe gjykimit të krimeve të luftës në adresë të gabuar

Republika e Kosovës ka një prokurori të specializuar për hetimin e rasteve të krimeve të luftës. Nga korriku i vitit 2019, Republika e Kosovës ka edhe një Departament Special që i gjykon rastet e krimeve të luftës.

Që nga pas lufta, si faktori ndërkombëtar ashtu edhe faktori vendor, kanë dështuar në trajtimin efikas të rasteve të krimeve të luftës.

Veçanërisht, që nga bartja e kompetencave nga misioni i EULEX-it tek vendorët, përgjegjësia kryesore për hetimin dhe gjykimin e rasteve të krimeve të luftës bie mbi sistemin e drejtësisë kosovare, përkatësisht mbi prokurorët dhe gjyqtarët vendorë.

Por, siç u trajtua paraprakisht në këtë raport, PSRK-ja ka dështuar të bëjë ndjekje penale kualitative në rastet e krimeve të luftës, në atë mënyrë që në asnjë formë nuk i ka dhënë përgjigje krimeve të kryera në luftën e fundit në Kosovë. Gjatë kësaj kohe, mbi aktakuzat e PSRK-së për krime lufte është dënuar vetëm një (1) person i entitetit shqiptar, dhe asnjë Serb.

Në këtë drejtim, institucionet e Republikës së Kosovës, si ekzekutivi dhe legjislativi, por edhe vetë sistemi gjyqësor, nuk i kanë dhënë përkrahje PSRK-së, si adresë e vetme për të adresuar qartë përgjegjësinë penale për krimet e luftës të kryera gjatë luftës së fundit në Kosovë. Përkundër efikasitetit dhe efektivitetit të ulët të Prokurorëve në Departamentin e Krimeve të Luftës në PSRK, ky departament vazhdimisht është sfiduar me numër të vogël të prokurorë.

Por, duke mos njohur, me apo pa qëllim, adresën e vetme për ndjekjen dhe gjykimin e krimeve të kryera gjatë luftës së fundit në Kosovë, me qëllim të adresimit të këtyre krimeve, janë dhënë ide paraprakisht të paarrtshme.

Gjatë vitit 2019, ish-Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Kadri Veseli, tani deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Kryetar i Partisë Demokratike të Kosovës, kishte dalë me propozimin për themelimin Gjykatës Ndërkombëtare për krimet e Serbisë në Kosovë. Për mënyrën se si e kishte konceptuar krijimin e një Gjykate të tillë, Veseli nuk kishte dhënë detaje asnjëherë.

Por, krijimi i një gjykate të tillë ndërkombëtare është një projekt paraprakisht i dështuar. Kjo për arsye se në krijimin e një gjykate me karakter ndërkombëtar, Republika e Kosovës nuk mund të ketë asnjë rol. Kjo bëhet kryesisht nga ana e organizatave të fuqishme ndërkombëtare. Nëse ideja ka qenë angazhimi i Republikës së Kosovës për të lobuar për këtë ide, në këtë rast nuk bëhet fjalë për “themelim” të një institucioni të tillë ndërkombëtar.

Për më tepër, ky rast nuk mund të trajtohet në mënyrë paralele me Dhomat e Specializuara, pasi themelimi i Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar është bërë nga vet Republika e Kosovës, për qytetarët e Republikës së Kosovës, por se vendosja e kësaj Gjykate është bërë në Hagë, sipas një marrëveshje ndërkombëtare në mes të Republikës së Kosovës dhe Holandës. Pra, juridikisht, Gjykata Speciale konsiderohet si gjykatë e brendshme e Republikës së Kosovës, derisa faktikisht e njëjta është e vendosur në Holandë.

Për këtë arsye, themelimi i një gjykatë të tillë ndërkombëtare fillimisht është një projekt paraprakisht i paarritshëm, derisa një projekt i tillë paraqet shmangie nga adresa kryesore për adresimin e krimeve të kryera gjatë luftës së fundit në Kosovë, e që është Prokuroria Speciale dhe Departamentet e Specializuara në Gjykatën Themelore në Prishtinë dhe Gjykatën e Apelit.

Në anën tjetër, Organizata e Veteranëve të Luftës (OVL) së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ka kërkuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës që të ndryshojë Ligjin për Gjykatën Speciale, në mënyrë që kjo gjykatë mos të ndjekë vetëm ish-pjesëtarët e UÇK-së, por edhe të komuniteteve të tjera që dyshohen për krime lufte në Kosovë.

Edhe kjo kërkesë e OVL-UÇK është paraprakisht e paarritshme, dhe nuk është adresa e duhur se ku duhet kërkuar përgjegjësia për adresimin e krimeve të kryera gjatë luftës së fundit në Kosovë.

Fillimisht, asnjë ligj që i referohet punës së Gjykatës Speciale nuk mund të devijojë nga baza kushtetuese mbi të cilën është nxjerrë. Amandamenti nr.24, pika 1 përcakton se *“Për t’i përmbushur obligimet ndërkombëtare në lidhje me Raportin e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, Dokumenti 12462, datë 7 janar 2011, Republika e Kosovës mund të themelojë Dhomat të specializuara dhe një Zyrë të Prokurorit të specializuar në kuadër të sistemit të drejtësisë të Kosovës. Organizimi, funksionimi dhe juridiksioni i Dhomave të specializuara dhe i Zyrës së Prokurorit të specializuar rregullohen me këtë nen dhe me ligj të veçantë”*.

Pra, sipas këtij neni kushtetues, puna e Dhomave të Specializuara dhe ZPS-së kufizohet vetëm në raport me Raportin e Dick Marty-t, dhe jo edhe me krime të tjera. Për këtë arsye, ndryshimi i ligjit në këtë rast sipas propozimit të OVL-UÇK është plotësisht jo relevant, madje i pamundur, përderisa kemi një kufizim të tillë kushtetues.

Në anën tjetër, edhe sikur kjo të bëhej përmes ndryshimeve kushtetuese, IKD rikujton se Gjykata Speciale është një gjykatë e brendshme, e cila i referohet vetëm qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe se vendosja faktike e saj në një shtet tjetër, është bërë me anë të një marrëveshje ndërkombëtare, përkatësisht përmes Marrëveshjes Ndërkombëtare në mes të Republikës së Kosovës dhe Holandës.

Në rastin e tillë, nëse veprohet sipas kërkesës së OVL-UÇK, atëherë bëhet fjalë për futjen në juridiksion edhe të qytetarëve të një vendi të tretë, në rasti konkret të Republikës së Serbisë, për të cilin fakt, në mungesë të vullnetit të Republikës së Serbisë, Holanda nuk mund të marrë përgjegjësi.

Ndërsa, nëse bëhet fjalë që kjo Gjykatë mos të funksionojë në Hagë por të funksionojë në Republikën e Kosovës, atëherë kjo përsëri është e panevojshme, pasi Republika e Kosovës ka një prokurori dhe departament të specializuar që kanë mandat hetimin dhe gjykimin e rasteve të krimeve të luftës.

Për këtë arsye, prapë duhet të kthehemi tek adresa e vetme për hetimin dhe gjykimin e krimeve të kryera gjatë luftës në Kosovë, e që është fuqizimi i PSRK-së dhe departamenteve speciale të

Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Gjykatës së Apelit. Çdo ide tjetër paraqet mos njohje të adresës kryesore për trajtimin e këtyre krimeve dhe zhvendosje nga obligimi bazë për adresimin e hetimit dhe gjykimit të krimeve të kryera gjatë luftës së fundit në Kosovë.

15. Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rasteve të krimeve të luftës

Përpos monitorimit sistematik të punës së prokurorisë e gjykatës në trajtimin e lëndëve të korrupsionit të profilin të lartë, rasteve të vrasjeve, narkotikëve, krimin të organizuar, terrorizmit, kontrabandimit me migrantë e shumë veprave të tjera penale, IKD në fushën e saj të monitorimit rëndësi i ka kushtuar edhe rasteve të krimeve të luftës.

Sa i përket hetimit dhe gjyqimit të rasteve të krimeve të luftës, fillimisht IKD konsideron se në këtë pjesë nuk ka mangësi ligjore, pasi infrastruktura ligjore në këtë fushë është e plotësuar. Për më tepër, për këtë pjesë, në asnjë rast nuk janë ngritur shqetësime nga asnjë aktër i sistemit të drejtësisë, përjashtimisht dispozitave që i referohen gjyqimit në mungesë.

Sa i përket krimeve të kryera gjatë luftës së fundit në Kosovë, raportet kredibile vendore dhe ndërkombëtare dëshmojnë për një disbalancë jashtëzakonisht të theksuar të numrit të viktimave, i cili paraqet faktin se Kosova gjatë kësaj lufte ka qenë viktimë, dhe Serbia ka qenë agresore. Përpos numrit të viktimave, gjatë luftës së fundit në Kosovë janë evidentuar dhe dokumentuar edhe dhunime dhe dëme të konsiderueshme materiale.

Aktakuzat e para për krime lufte ishin ngritur nga prokurorët vendorë në vitin 1999, menjëherë pas përfundimit të luftës.

Nga viti 1999 deri në vitin 2000, nga prokurorët vendorë janë ngritur aktakuza ndaj 29 serbëve, një (1) shqiptari, dhe tre (3) malazezëve.

Por, prania jo e madhe e komuniteteve pakicë në sistemin e gjyqësorit, si dhe fakti se në cilësinë e të akuzuarve për veprat penale të krimeve të luftës kanë qenë kryesisht serb, ndikoi që të ngritën shqetësime për anshmëri të gjyqësorit dhe prokurorisë vendore gjatë fazës së SEGJ.

Si rrjedhojë, në shkurt të vitit 2000, PSSP-ja, shpalli Rregulloren e UNMIK-ut 2000/34 me të cilën zgjeroi autoritetin për të caktuar gjyqtarë dhe prokurorë ndërkombëtar në tërë territorin e Kosovës.⁷⁵ Prandaj, që nga ajo kohë, gjyqtarë dhe prokurorë ndërkombëtar kanë punuar në Kosovë në raste të ndryshme, përfshirë edhe në ato të krimeve të luftës.

Rezultati i prokurorëve dhe gjyqtarëve të UNMIK-ut në trajtimin e rasteve të krimeve të luftës ka qenë minimal, për të mos thënë pa asnjë rezultat.

Nga viti 2000 deri në vitin 2008, nga prokurorët e UNMIK-ut, janë ngritur aktakuza ndaj tre (3) serbëve, 19 shqiptarëve dhe një (1) malazezi, derisa gjatë kësaj periudhe kohore nga gjyqtarët e UNMIK-ut është dënuar vetëm një (1) person.

Numri i madh i aktgjykimeve liruese, sipas FDH-së, i atribuohet ndryshimit të deklaratave të dëshmitarëve të dhëna në faza të ndryshme të procedurës penale. Amnesty International, në një

⁷⁵ “Rregullorja e UNMIK-ut 2000/34 që ndryshon Rregulloren e UNMIK-ut 2000/6 mbi Emërimin dhe Shkarkimin nga Detyra të Gjyqtarëve Ndërkombëtar dhe Prokurorëve Ndërkombëtar”. 29 maj 2000. (Shih linkun https://unmik.unmissions.org/sites/default/files/regulations/03albanian/A2000regs/RA2000_34.htm). (Qasur së fundi më 21 maj 2020).

raport të publikuar në qershor të vitit 2009, apo 10 vite pas konfliktit të armatosur, ka adresuar një sërë kritikash në adresë të UNMIK-ut, me arsyetimin se i kanë kontribuar klimës së mos ndëshkimit të krimeve të luftës, ngase nuk kanë zhvilluar hetime të menjëhershme, e as hetime të pavarura, e të paanshme, dhe si rezultat i kësaj, vetëm një numër i vogël nga personat përgjegjës të krimeve të luftës dhe të krimeve ndër-etnike në Kosovë, gjatë dhe pas konfliktit të armatosur, janë sjellë para drejtësisë në gjykatat ndërkombëtare apo vendore.

Pas përfundimit të mandatit të UNMIK-ut, kompetencat në rastet e krimeve të luftës kanë kaluar tek EULEX-i.

Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX), zyrtarisht ka filluar punën në Republikën e Kosovës më 9 dhjetor 2008, ndërsa është bërë plotësisht funksional në prill të vitit 2009, duke marrë kompetencat që deri atë kohë i takonin UNMIK-ut.

EULEX-i ka trashëguar gjithsej 1200 raste të krimeve të luftës nga UNMIK-u, pothuajse 2,000 dosje për personat e humbur; 47 çështje të krimeve të luftës i janë transferuar Zyrës së Prokurorit Special të Kosovës (ZPSK). Ndërsa, në korrik 2013, rreth 500 raste ishin mbyllur apo hedhur poshtë për shkak të mungesës së provave.

Në trajtimin e rasteve të krimeve të luftës, përkundër dëshmimeve se në luftën e fundit në Kosovë shumica e viktimave kishin qenë me etni shqiptare, EULEX-i numrin më të madh të aktakuzave e kishte ngritur pikërisht ndaj shqiptarëve.

Nga prokurorët e misionit të EULEX-it, nga viti 2009 deri në vitin 2018, janë ngritur aktakuza ndaj 11 serbëve, 39 shqiptarëve, një (1) malazezi, dhe një (1) personi nga komuniteti RAE.

Ndërsa, me aktgjykime dënuese të formës së prerë të shqiptuara nga gjyqtarët e EULEX-it kanë përfunduar 38 persona.

Edhe misioni i EULEX-it është shoqëruar me kritika të shumta lidhur me aktivitetin e saj në Republikën e Kosovës.

Deri në vitin 2014, misioni i EULEX-it kishte kompetenca ekskluzive në rastet e krimeve të luftës. Nga viti 2014 e deri në vitin 2018, kompetencat e EULEX-it shtriheshin në raport me rastet në proces, derisa për të gjitha rastet e tjera kompetent ishin prokurorët dhe gjyqtarët vendorë. Nga qershori i vitit 2018, EULEX ka vetëm mandat monitorues.

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK) gjatë vitit 2016 kishte themeluar një departament të posaçëm për hetimin e krimeve të luftës dhe krimeve të tjera ndërkombëtare.

Po ashtu, edhe në kuadër të Policisë së Kosovës funksionon Njësia për Hetimin e Krimeve të Luftës dhe Sektori për Personat e Zhdukur si pjesë e Drejtorisë për Krime të Rënda në Departamentin e Hetimeve të Policisë së Kosovës dhe është njësi policore e specializuar dhe e autorizuar për hetimin e këtyre veprave penale.

Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK), në shkurt të vitit 2019 kishte miratuar Strategjinë për krime të luftës, me synimin për të siguruar hetime dhe ndjekje penale efektive të pretendimeve serioze për krimeve të luftës dhe krimeve të tjera sipas të drejtës ndërkombëtare, vendosjen e drejtësisë për viktimat, palët e dëmtuara si dhe forcimin e sundimit të ligjit.

Sipas këtyre të dhënave të Prokurorit të Shtetit, vërehet se Prokurorët e PSRK-së kanë mbyllur në Prokurori shumë më shumë raste se sa kanë ngritur aktakuza, duke mos iu nënshtruar asnjë lloj kontrolli gjyqësor dhe në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, si dhe me dokumentet ndërkombëtare, që garantojnë dhe promovojnë të drejtat dhe liritë e njeriut, më konkretisht të drejtën e mjetit juridik ndaj secilit vendim administrativ dhe gjyqësor. Për katër vite Prokuroritë kanë pushuar hetimet në 29 raste (si dhe 2 raste në vitin 2020), ndërsa për periudhën 2016-2019 kanë ngritur 12 aktakuza për krime lufte për katër vite (si dhe 2 në vitin 2020). Kjo do të thotë se numri i aktakuzave të ngritura përballë fakteve mbi krimet që kanë ndodhur në Kosovë gjatë luftës së fundit si dhe numri i përgjithshëm i rasteve të zgjidhura nga kjo prokurori manifestojnë dështim të së njëjtës për trajtimin e rasteve të krimeve të luftës.

Lidhur me këtë fakt, udhëheqësja e Departamentit për Krime Lufte në PSRK, prokurorja Drita Hajdari, nuk ka dhënë përgjigje, por se ka treguar mënyrat se si përfundohet në hetim:

“Bashkangjitur ju dërgoj statistikën e PSRK-së lidhur me numrin e aktakuzave të ngritura për periudhën 2016-2020, si dhe numrin e rasteve për pushimin e hetimit dhe hedhjen e kallëzimit penal. Njëherit ju bëjë me dije se çdo hetim nuk përfundon me ngritjen e aktakuzës. Në bazë të ligjit hetimi mund të pushoj si dhe mund të hedhet kallëzimi penal. Andaj përgjigjen në pyetjen e juaj: “Cila është arsyeja që në trajtimin e këtyre rasteve më shumë po pushohen hetimet se sa po ngritën akte akuzuese? Ju do ta gjeni në dispozitën e nenit 158 të Kodit të procedurës penale të Kosovës (pushimi i hetimit) dhe nenin 82 të njëjtit Kod (hudhja e kallëzimit penal). Për t’i kompletuar statistikën ju njoftoj se sipas kërkesës së kësaj prokurorie gjykata ka lëshuar letërreshtime ndërkombëtare për 78 persona të dyshuar për krimet e luftës”, thuhet në përgjigjen e prokurores Hajdari.⁷⁶

Numri i aktakuzave të ngritura përballë fakteve mbi krimet që kanë ndodhur në Kosovë gjatë luftës së fundit si dhe numri i përgjithshëm i rasteve të zgjidhura nga kjo prokurori manifestojnë dështim të së njëjtës për trajtimin e rasteve të krimeve të luftës.

Në këtë drejtim, për nga mënyra e zgjidhjes së rasteve, numrin më të madh e përbëjnë rastet në të cilat PSRK ka pushuar hetimet, pasuar nga rastet në të cilat është hudhur kallëzimi penal. Ndërsa, përkundër fakteve notore numrin e madh të krimeve dhe masakrave që janë kryer në gjatë luftës së fundit në Kosovë, PSRK sipas të dhënave të saj zyrtare ka ngritur në total vetëm 26 aktakuza për rastet e krimeve të luftës.

Por, nëse i referohemi faktit se suksesi i një aktakuze paraqitet në momentin kur e njëjta kalon në gjykatë, dhe personat e përfshirë në aktakuza dënohen me aktgjykim të formës së prerë, atëherë i bie se ky sukses është minimal. Kjo pasi që nga të gjitha aktakuzat e ngritura nga

⁷⁶ Përgjigja e Prokurores Drita Hajdari për IKD. 24 qershor 2020.

PSRK për rastet e krimeve të luftës, deri më tani vetëm një (1) aktakuzë ka rezultuar me aktgjykim dënues të formës së prerë. Përpos mjeteve juridike të aplikuara në këto raste, nga sistemi prokurorial nuk ka pasur akuza për mungesë të pavarësisë, paanshmërisë apo profesionalizmit të sistemit gjyqësor, siç kishte ndodhur në rastet e korrupsionit.

Themelimi i një departamenti të veçantë në PSRK për trajtimin e rasteve të krimeve të luftës, në kohën kur në këtë prokurori nuk ekzistonte asnjë departament i specializuar, kishte për qëllim ngritjen e efikasitetit dhe profesionalizmit në zbardhjen e rasteve të krimeve të luftës. Në këtë drejtim, nga ky departament i profilizuar në kuadër të një prokurorie të specializuar do duhej të ishin legjitime pritjet për rezultate në zbardhjen e rasteve të krimeve të luftës. Por, rezultatet e pritura nuk janë arritur.

Krahas rrethanave subjektive që kanë ndikuar në mos efikasitetin dhe efektivitetin e këtij departamenti, mos përkrahja e këtij departamenti nga institucionet e tjera, madje edhe nga vet sistemi prokurorial, ndërton argumentimin se krijimi i këtij departamenti ishte bërë sa për të paraqitur vet themelimin e këtij departamenti si sukses, i cili sukses do të përfundonte me thjesht themelimin e këtij departamenti. Kjo pasi Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe sistemi prokurorial nuk janë angazhuar që ti ngrisin kapacitetet e këtij departamenti, në atë mënyrë që të ngritet numri i prokurorëve dhe resurset e tjera të nevojshme për adresimin e hetimit efikas dhe efektiv të krimeve të luftës. Në këtë drejtim, numri i vogël i prokurorëve në këtë departament dhe mos përkrahja e vazhdueshme e këtij departamenti paraqet paracaktimin e mos suksesit të këtij departamenti. Në këtë mënyrë, mos përkrahja e këtij departamenti nuk ka ndërtuar as pritjet për ngritje të efikasitetit dhe efektivitetit në hetimin e rasteve të krimeve të luftës.

Në këtë drejtim, IKD vlerëson se këto të dhëna paraqesin dy (2) dimensione kuptimore në raport me hetimin dhe gjykimin e rasteve të krimeve të luftës. Fillimisht, mungesa kaq evidente e rezultateve në trajtimin e rasteve të krimeve të luftës nga një departament i profilizuar në kuadër të një prokurorie të specializuar e humb edhe kuptimin e ekzistimit të këtij departamenti. Në anën tjetër, një mungesë kaq evidente e rezultateve nga një departament i profilizuar në kuadër të një prokurorie të specializuar, tregon nevojën për reforma rrënjësore në kuadër të sistemit prokurorial, në mënyrë që të kemi hetim dhe gjykim efikas dhe efektiv të rasteve të krimeve të luftës. Kjo reformë, para së gjithash, duhet të reflektoj në ngritje të resurseve dhe kapaciteteve të Departamentit për Krime Luftë në PSRK.

Një ndër ndryshimet më të rëndësishme dhe më rrënjësore në Kodin e Procedurës Penale ka qenë mundësia e hetimit, akuzimit dhe gjykit të të pandehurve në mungesë, të cilët pretendohet se kanë kryer vepra penale kundër të Drejtës Ndërkombëtare Humanitare. Por, me anë të një komunikate për media, PSRK kishte deklaruar se ka vështirësi në zbatimin e këtij ligji.

Përkundër faktit se sipas të gjitha raporteve kredibile vendore dhe ndërkombëtare Republika e Serbisë paraqitet si agresor përballë viktimës Kosovare, ndjekja dhe gjykimi penal ndaj Kosovarëve, përkatësisht shqiptarëve, kanë qenë shumë më evidente se sa ndaj shtetasve të Republikës së Serbisë. Në këtë drejtim, përballë disbalancit të madh etnik në numrin e

viktimave nga lufta e fundit në Kosovë, paradoksalisht, në hetimin dhe gjykimin e krimeve të luftës, kjo disbalancë ndryshon kahje. Nga tetori i vitit 1999 e deri në qershor të vitit 2020 kishin qenë gjithsej 117 të akuzuar. Nga ky total i numrit të të akuzuarve, 62 prej tyre kishin qenë shqiptarë, 49 serbë, pesë (5) malazezë dhe një (1) nga komuniteti RAE.

Kjo disbalancë është jashtëzakonisht më e thekuar në rastin e numrit të personave të dënuar për krime gjatë luftës së fundit në Kosovë. Gjatë periudhës kohore tetor 1999 – tetor 2018, nga gjyqtarë të UNMIK-ut, EULEX-it dhe vendorë me aktgjykime të formës së prerë janë dënuar gjithsej 40 persona, prej tyre plot 35 shqiptarë dhe vetëm katër (4) serbë, derisa për krime lufte me aktgjykim të formës së prerë është dënuar edhe një (1) person i nacionalitetit malazezë. Shprehur në përqindje, i bie se nga të gjithë të dënuarit për krime lufte nga UNMIK, EULEX dhe gjyqtarët vendorë, 87.5% e tyre janë të etnisë shqiptare dhe vetëm 10% e tyre janë të etnisë serbe, derisa 2.5% janë të etnisë malazeze.

Këto të dhëna dëshmojnë dështim të dyfishtë si të institucioneve ndërkombëtare ashtu edhe të sistemit kosovar të drejtësisë. Fillimisht, numri i përgjithshëm i të akuzuarve, e veçanërisht të dënuarve për krime të kryera gjatë luftës së fundit në Kosovë në asnjë rrethanë nuk paraqet ndjekje dhe gjykim efektiv të këtyre rasteve, duke lënë nën mjegull shumë krime makabre të kryera gjatë luftës së fundit në Kosovë. Por, ky dështim është jashtëzakonisht më i avancuar në raport me viktimat shqiptare, për krimet ndaj të cilëve, nga UNMIK-u, EULEX-i dhe sistemi kosovar i drejtësisë janë dënuar vetëm katër (4) persona.

Tutje, sipas statistikave të siguruara nga KGJK-ja, vërehet se edhe sistemi gjyqësor në Kosovë ka dështuar të vë në prioritet gjykimin e rasteve të krimeve të luftës, e krejt kjo pasi vërehet se kanë zgjidhur një numër të vogël të lëndëve të krimeve të luftës.

Përballë këtyre dështimeve, janë një numër i konsiderueshëm i krimeve makabre ndaj qytetarëve kosovar gjatë luftës së fundit në Kosovë, për të cilat krime, drejtësia akoma nuk ka dhënë përgjigje. Për të gjitha këto masakra, në asnjërin rast drejtësia nuk e ka dhënë fjalës e saj përmes aktgjykimeve dënuese të formës së prerë. Madje, në vetëm dy (2) prej këtyre masakrave ka të akuzuar. Lidhur me masakrën në Krushë të Madhe, kishte qenë i akuzuar një (1) person i cili ishte liruar, derisa për masakrën e Studimes është një i akuzuar, rasti i të cilit është ende në proces.

Në fund të vitit 2010, gazetari Paul Lewis kishte publikuar pjesë të raportit të senatorit zviceran Dick Marty të Këshillit të Evropës, me titullin *“Kryeministri i Kosovës është udhëheqës i trafikimit me organe njerëzore dhe me armë, thotë një raport i Këshillit të Evropës”*. Për të trajtuar këto pretendime, Kuvendi i Republikës së Kosovës me anë të ndryshimeve kushtetuese dhe miratimit të dy projektligjeve ka themeluar Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuara, të njohura ndryshe si Gjykata Speciale. Deri më tani, nga ZPS janë intervistuar mbi 200 persona, derisa kjo prokurori në kundërshtim me rregullat e veta dhe duke vepruar në mënyrë selektive, ka publikuar njoftimin për ngritje të aktakuzës për krime lufte ndaj Presidentit të Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, Kryetarit të Partisë Demokratike të Kosovës, Kadri Veseli dhe nëntë (9) personave të tjerë, përkundër faktit se kjo aktakuzë ende nuk ishte konfirmuar nga gjykata.

PSRK-ja ka dështuar të bëjë ndjekje penale kualitative në rastet e krimeve të luftës, në atë mënyrë që në asnjë formë nuk i ka dhënë përgjigje krimeve të kryera në luftën e fundit në Kosovë. Gjatë kësaj kohe, mbi aktakuzat e PSRK-së për krime lufte është dënuar vetëm një (1) person i entitetit shqiptar, dhe asnjë serb. Në këtë drejtim, institucionet e Republikës së Kosovës, si ekzekutivi dhe legjislativi, por edhe vetë sistemi gjyqësor, nuk i kanë dhënë përkrahje PSRK-së si adresë e vetme për të adresuar qartë përgjegjësinë penale për krimet e kryera gjatë luftës së fundit në Kosovë. Përkundër efikasitetit dhe efektivitetit të ulët të Prokurorëve në Departamentin e Krimeve të Luftës në PSRK, ky departament vazhdimisht është sfiduar me numër të vogël të prokurorëve. Por, duke mos njohur, me apo pa qëllim, adresën e vetme për ndjekjen dhe gjykimin e krimeve të kryera gjatë luftës së fundit në Kosovë, me qëllim të adresimit të këtyre krimeve, janë dhënë ide paraprakisht të paarrtshme, si themelimi i një Gjykate Ndërkombëtare për të hetuar dhe gjykuar kryerësit e krimeve të luftës ndaj kosovarëve gjatë luftës së fundit në Kosovë dhe zgjerimi i juridiksionit të Gjykatës Speciale edhe në raport me krimet ndaj kosovarëve, të cilat ide janë teorikisht dhe praktikisht të paarrtshme.

Në këtë drejtim, IKD i rikujton të gjitha institucioneve kushtetuese, se adresa kryesore për luftimin e krimeve të luftës është PSRK, e cila duhet të përkrahet dhe fuqizohet në luftimin e krimeve të kryera gjatë luftës së fundit në Kosovë, si dhe për punën dhe mos punën e tyre, prokurorët e kësaj prokurorie duhet të mbahen përgjegjës nga mekanizmat e brendshëm të kontrollit në sistemin prokurorial.

Në anën tjetër, në trajtimin e rasteve të krimeve të luftës, IKD ka gjetur se shkelen afatet ligjore për trajtimin e rasteve, afate këto të përcaktuara me Kodin e Procedurës Penale.

Sikurse, edhe në raste të tjera penale, edhe në trajtimin e rasteve të krimeve të luftës, IKD ka vërejtur se të pandehurve nuk po u garantohet e drejta e tyre për gjykim në kohë të arsyeshme, e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Për të vërejtur këtë fenomen, mjafton të shikohet rasti Kleçka, ku i akuzuar ishte Fatmir Limaj dhe nëntë ish-pjesëtar të UÇK-së. Që nga ngritja e aktit akuzues e deri në vendim të fundit, që në këtë rast pas rigjyimit të rastit kishte qenë vendimi i Gjykatës Supreme, të pandehurit në këtë rast ishin përballur pesë (5) vite, 9 muaj e 17 ditë me proces gjyqësor.

Edhe rasti i Remzi Shalës që në opinionin publik njihet si “Molla e Kuqe”, është një rast specifik që të pandehurit deri në një vendim përfundimtar ballafaqohen disa vite në procese gjyqësore. Në këtë rast, deri në vendimin e Supremes që kishte kthyer rastin në rivendosje, Shala duke u përballur me drejtësinë deri me 31 korrik 2020, i ka kaluar tre (3) vite, 9 muaj e 11 ditë.

Në vendimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), në rastin “Kaçi dhe Kotorri kundër Shqipërisë” i vitit 2013, kjo gjykatë kishte konstatuar shkelje të së drejtave për shkak të kohëzgjatjes së procedurës gjyqësore.

Në këtë vendim thuhet se problemi kryesor në çështjen në fjalë, të cilin Gjykata e ka shqyrtuar edhe në një çështje të mëparshme kundër shtetit të paditur, është kthimi i shpeshtë i çështjeve për rigjykim nga gjykatat më të larta te gjykatat më të ulëta. Gjykata është e mendimit se kjo vonesë i atribuohet tërësisht gjykatave të vendit. Në këtë rast procesi penal zgjati 6 vjet dhe 11 muaj, zgjatje e cila çoi në një shkelje që i atribuohet gjykatave të brendshme⁷⁷

Trajtimi i krimeve të luftës në praktikë është ballafaquar me një sërë sfidash, që kanë pamundësuar zgjidhjen e këtyre rasteve edhe pasi kanë kaluar më shumë se 20 vite nga konflikti i armatosur. Dështimi në zgjidhjen me kohë të krimeve të luftës arsyetohet edhe me faktin se zgjidhja e këtyre rasteve nuk ka qenë asnjëherë prioritet i subjekteve ndërkombëtare dhe atyre vendore që janë angazhuar që nga pas lufta me raste të tilla dhe duke mos ofruar asnjëherë resurse adekuate për hetimin, ndjekjen penale dhe gjykimin e rasteve të krimeve të luftës në Kosovë.

Mosefikasiteti në trajtimin e krimeve të luftës duhet t'u mvishet institucioneve që kanë qenë të angazhuara në trajtimin dhe zgjidhjen e këtyre rasteve që nga paslufta e deri më sot.

Vonesa në trajtimin e këtyre rasteve ka ndikuar që shumë të dyshuar për krime lufte të largohen nga Kosova, duke i'u shmangur drejtësisë, duke shtuar se zgjidhja e këtyre rasteve vështirësohet gjithnjë e më shumë, aq sa më të vjetra bëhen prej kohës kur pretendohen të jenë kryer krimet në fjalë. Pastaj, disa viktimat dhe dëshmitarë kanë vdekur, disa janë shpërngulur dhe kujtesa e disa të tjerëve është zbehur me kalimin e kohës, pastaj dëshmitë janë zhvendosur ose shkatërruar, pjesërisht nga dorëzimet e shumta nga gjeneratat e ndryshme të akterëve të përfshirë në këto raste. Po ashtu, në Kosovë, ka pasur një numër të rasteve ku dëshmitarët janë vrarë, larguar, kanë tërhequr dëshmitë e tyre të mëparshme, ose thjesht nuk kanë pranuar të japin dëshmi, duke pamundësuar procedimin efikas të këtyre rasteve.

Me anë të Strategjisë për Krime të luftës të miratuar me 21 shkurt 2019 nga ana e KPK-së, theksohet se përmes zbatimit të saj do të bëhej caktimi i përparësisë së lëndëve dhe përzgjedhja e lëndëve në bazë të kriterëve të përcaktuara, se do të bëhej rritja e kapaciteteve të prokurorisë dhe policisë, në atë mënyrë që për ta përballuar mbingarkesën e dosjeve që po dorëzohen nga EULEX-i te NHKL e PK-së, si dhe vëllimin aktual të lëndëve që ndërlidhen me krime të luftës, Kryeprokurori i Shtetit do t'i emëroj pesë (5) prokurorë të mbështetur nga gjashtë (6) zyrtarë ligjor, të cilët do të merren ekskluzivisht me lëndët e krimeve të luftës. Por, kjo strategji e miratuar nga ky këshill, nuk është zbatuar pasi që në PSRK veprojnë vetëm tre (3) prokuror, tre (3) bashkëpunëtor profesional dhe katër (4) zyrtarë ligjor.

Sipas Kryesuesit të KPK-së, Bahri Hyseni, KPK-ja po bënë përpjekje të vazhdueshme për rritjen e numrit të stafit mbështetës, derisa ka shpallur edhe konkursin për prokurorë në PSRK:

“Këshilli Prokurorial i Kosovës e sheh të nevojshme rritjen e numrit të prokurorëve në Departamentin e Krimeve të Luftës, duke pasur parasysh numrin e lëndëve sidomos ato që janë transferuar nga EULEX tek autoritetet kosovare, dhe gjithashtu kompleksitetin dhe

⁷⁷ Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Aktgjykim. Rasti Kaçiu dhe Kotorri k. Albania. Nr. 33192/07 dhe 33194/07. Strasburg, 9 dhjetor 2013.

ndjeshmërinë që bartin këto lëndë. Në zbatim të Strategjisë për Krime të luftës, Këshilli Prokurorial i Kosovës ka bërë shpalljen për avancim të 4 prokurorëve në Prokurorinë Speciale, e të cilët do të sistemohen nëpër departamente përfshirë këtu dhe në Departamentin e Krimeve të Luftës. Sa i përket stafit, në Departamentin për Krime Luftë janë të angazhuar 3 bashkëpunëtorë profesional, 4 zyrtarë ligjor dhe gjithashtu 1 ekspert. Këshilli në bazë të mundësive buxhetore apo financiare po bënë përpjekje të vazhdueshme për rritjen e numrit të stafit mbështetës (bashkëpunëtor profesional dhe zyrtarë ligjor). Këshilli është duke u munduar të siguroj stafin e mjaftueshëm për Departamentin e Krimeve të Luftës duke bërë kërkesa dhe në Ministrinë e Financave për mbështetje financiare, mirëpo siç dihet nuk kemi pasur përkrahjen e tyre për plotësim të pozitive në sistem prokurorial duke përfshirë këtu dhe Departamentin e Krimeve të Luftës në Prokurorinë Speciale”⁷⁸.

Sipas IKD-së, në mënyrë që rastet e krimeve të luftës të trajtohen në mënyrë sa më efikase dhe profesionale, duhet që KPK-ja vazhdimisht të ngrit kuadrot dhe kapacitet brenda saj, duke rritur numrin e prokurorëve, të cilët trajtojnë këto raste e njëkohësisht duke ngritur edhe kapacitetet e tyre profesionale përmes trajnimeve të vazhdueshme në ndjekjen penale të këtyre rasteve. Në këtë qëllim, sistemi prokurorial duhet të përkrahet edhe nga pushtetet e tjera, veçanërisht në kuptimin financiar.

Krahas mungesës së resurseve të nevojshme njerëzore për hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve të luftës, një aspekt tjetër negativ është vlerësuar të jetë mungesa e ekspertizës së nevojshme profesionale në trajtimin e krimeve të luftës, qoftë të personelit gjyqësor, atij prokurorial, stafit të tyre mbështetës dhe zyrtarëve policor të përfshirë.

Lidhur me profesionalizmin e prokurorëve në trajtimin e rasteve të krimeve të luftës, Kryesuesi i KPK-së, Bahri Hyseni, ka thënë se KPK vazhdimisht angazhohet në ngritjen e kapaciteteve dhe aftësive të prokurorëve.

“Këshilli Prokurorial i Kosovës në vazhdimësi angazhohet në ngritjen e kapaciteteve dhe aftësive të prokurorëve. Në mënyrë të vazhdueshme organizohen trajnime të ndryshme për prokuror me temë: Krimet e luftës; Shkathësitë teknike për intervistimin e dëshmitarëve, viktimave të luftës me fokus në rastet e dhunës seksuale dhe gjinore në konfliktet e armatosura, e trajnime të tjera në bashkëpunim me ambasadën amerikane dhe me partnerët tjerë ndërkombëtarë”⁷⁹.

IKD ka vërejtur se një ndër problematikat më të mëdha me të cilat po ballafaqohen organet e drejtësisë, për të vënë të dyshuarit për krime lufte përballë drejtësisë është pamundësia për të pasur qasje te këta të dyshuar.

Në rastet e analizuara nga IKD për krime lufte, të cilat kanë ndodhur në qytete e fshatra të ndryshme të Kosovës, vihet re se hetimet kanë filluar ndaj shumë personave e se hetimet pezullohen vazhdimisht në pamundësi të qasjes në këta individë. Pavarësisht se lëshohen fletë arreste ndërkombëtare, jo të gjithë të dyshuarit vihen në pranga dhe pastaj përballen me proces

⁷⁸ Përgjigja e Kryesuesit të KPK-së, Bahri Hyseni, për IKD. 17 qershor 2020.

⁷⁹ Përgjigja e Kryesuesit të KPK-së, Bahri Hyseni, për IKD. 17 qershor 2020.

gjyqësor për veprat penale që u vihen në barrë. Duke pasur parasysh se një numër i madh i të dyshuarve janë shtetas serb e se shteti i Serbisë nuk njeh pavarësinë e Republikës së Kosovës, dihet qartë se nuk ekziston as edhe marrëveshja për ekstradim mes këtyre dy shteteve.

Institucionet e Republikës së Kosovës kanë dështuar që të vendosin një linjë të bashkëpunimit me autoritetet serbe, për të realizuar bashkëpunim juridik ndërkombëtar tek rastet e krimeve të luftës, prandaj është e domosdoshme evitimi i pengesave juridike, politike ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, në mënyrë që të realizohet një bashkëpunim sa më i gjerë mes këtyre shteteve, për të mundësuar zgjidhjen efektive të rasteve të krimeve të luftës.

16. Anex 1: Analizë e detajuar e rasteve karakteristike që kanë përfunduar me aktgjykim të formës së prerë

1. Rasti Skender Bislimi

Gjykata Themelore në Prishtinë

Numri i lëndës: PKR.nr.3/17

Vepra penale: "Krimet e luftës në shkelje të rëndë të nenit 3 të përbashkët të Konventave të Gjenevës"

Kryetari i Trupit Gjykses: Arben Hoti

Prokuror : Charles Hardaway, Drita Hajdari

I pandehur: Skender Bislimi

Faza e procedurës: Aktgjykim përfundimtar

Nga ngritja e aktakuzës deri në vërtetimin e aktgjykimit nga Gjykata e Apelit kanë kaluar 956 ditë apo 2 vite, 7 muaj e 14 ditë

Sipas aktakuzës, ekziston dyshimi i bazuar se Skender Bislimi ka kryer veprën penale "krime kundër popullatës civile" siç parashikohet me nenet 22 dhe 142 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, aktualisht i penalizuar sipas neneve 31 dhe 152 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Në aktakuzë thuhet se më 26 mars të vitit 1999, në Fushë Kosovë, në bashkëkryerje me të paktën dhjetë autorë tjerë të njohur dhe të panjohur, duke vepruar si pjesëtarë të forcave të armatosura serbe, Bislimi ka dhunuar integritetin trupor dhe shëndetin e më shumë se 40 civilëve, meshkuj shqiptarë të Kosovës.

Sipas aktakuzës, Bislimi ka aplikuar masat e frikësimit dhe terrorit, dhe ka kryer arrestime ilegale dhe ka marr pengje duke përfshirë këtu edhe viktimat Bujar e Haki Bajrami.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit:

Në këtë rast akti akuzues është ngritur me 6 janar 2017. Përderisa, shqyrtimi fillestar është mbajtur me 28 prill 2017, apo tre muaj e 22 ditë pas ngritjes së aktit akuzues, duke mos respektuar kështu afatin ligjor të përcaktuar me Kod të Procedurës Penale.

Ivica Radivojeviq, ka qenë duke u hetuar së bashku me Bislimin në vitin 2012. Pasi Radivojeviq është akuzuar e gjykuar, më 24 maj 2015, është dënuar me gjashtë (6) vjet burgim, pasi është shpallur fajtor për krime lufte në Kosovë.

Kurse, Bislimi më 9 dhjetor të vitit 2016, ishte ekstraduar nga Bosnja e Hercegovina në Kosovë e më pas i ishte caktuar paraburgimi.

Gjatë këtij gjykimi ishin dëgjuar disa dëshmitarë në gjykatore. Akuza ishte përfaqësuar nga prokurori i EULEX-it, Charles Hardaway deri në përfundim të mandatit të EULEX-it.

Ai me 28 maj 2018 ka dorëzuar këtë rast te prokurorët vendorë, e më pas këtë rast e kishte përfaqësuar prokurorja Drita Hajdari. Në këtë rast, janë mbajtur disa seanca të shqyrtimit kryesor.

Në seancën e mbajtur me 25 janar 2018, ishin dëgjuar dy dëshmitarë. Dëshmitari Bujar Bajrami, kishte deklaruar se i akuzuari për krime lufte kundër popullatës civile, Skender Bislimi, më 26 mars të vitit 1999, derisa po largoheshin nga shtëpia me familjen e tij, u kishte thënë se nuk kanë ku të shkojnë, pasi do të vriteshin të gjithë. Për këtë ngjarje, dëshminë e kishte dhënë edhe gruaja e të ndjerit Haki Bajrami, Hasife Bajrami. Hasife Bajrami kishte deklaruar se kur kanë dashur të hipnin në autobus, i dënuari Ivica Radivojeviq dhe Skender Bislimi dhe një person tjetër që nuk e njeh kanë vrapuar dhe i kanë mbyllur dyert. Bajrami, kishte deklaruar se burrat i kanë rrahur e i kanë maltretuar, i kanë detyruar të këndonin këngë serbe, kurse tha se i kujtohet shumë mirë Bislimi, që me një automat apo me diçka e ka shtyrë atë.

Sipas Bajramit, përderisa Radivojeviq i ndante burrat e gratë, Bislimi i rrahte burrat. Bislimin, kishte thënë se e ka dalluar nga zëri dhe ka dëgjuar kur e kanë thirrur në emër dhe nuk ka asnjë dyshim për këtë, pasi sipas tij, ai ka pasur maskë të zezë, duke shtuar se në disa raste edhe e ka hequr atë. Më pas duke u përgjigjur në pyetjet e trupit gjykues, Bajrami kishte thënë se Bislimi në dorë ka pasur diçka të metaltë, me siguri pushkë, duke shtuar se me të i shtynte, sepse sipas saj, kishte frikë mos po i largohej dikush. Bajrami, tha se nuk i kujtohej nëse sulmuesit kanë pasur uniformë të veshur apo veshje të zakonshme, kurse tha se burri i saj, tashmë i ndjerë, nuk ka qenë i armatosur apo pjesëtar i ndonjë formacioni ushtarak. Ndërsa, i akuzuari Bislimi kishte deklaruar se nuk i njeh dëshmitarët.⁸⁰

Në seancën e mbajtur me 20 mars, dëshmitarja Nesife Breznica, kishte deklaruar se kur ishte kthyer në shtëpi pas përfundimit të luftës, një fqinje i kishte thënë se babain e saj e kishte vrarë i akuzuari.⁸¹

Në seancën e 24 prillit ishte bërë dëgjimi i Haxhere Jasharit, e cila kishte deklaruar se se kur ishin ndaluar nga policia serbe në Fushë Kosovë, i kishin rrahur burrat dhe i kishin detyruar ata të këndonin këngë serbe. Në këtë seancë ishte aprovuar propozimi i avokatit Nebojsa Vlajiq, mbrojtës i të akuzuarit Bislimi, i cili kishte propozuar që si dëshmitarë të dëgjohen edhe Silvana Bislimi, vajza e vëllait të të akuzuarit, bashkëshortja e tij Shukrije Beraj dhe Ali Beraj.⁸²

Në seancën e 4 qershorit, gjykata kishte vendosur që Sabit Jashari, të dëgjohet në shtëpinë e tij në cilësinë e dëshmitarit pasi i njëjti vuante nga një sëmundje dhe është pothuajse i

⁸⁰ “Dëshmitarët: I akuzuari për krime lufte na tha se do t’iu vrasim të gjithëve”. Betimi për Drejtësi. 25 janar 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/deshmitaret-i-akuzuari-per-krime-lufte-na-tha-se-do-tiu-vrasim-te-gjitheve/>). (Qasur së fundi me 6 gusht 2020).

⁸¹ “Gjykimi për krime lufte, dëshmitarja: Pasluftës finjët më thanë se babanë tim e ka vrarë i akuzuari Bislimi”. Betimi për Drejtësi. 20 mars 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/gjykimi-per-krime-lufte-deshmitarja-pasluftes-finjet-me-thane-se-babane-tim-e-ka-vrare-i-akuzuari-bislimi/>). (Qasur së fundi me 6 gusht 2020).

⁸² “Gjykimi për krime lufte, dëshmitarja thotë se policia serbe i kishin detyruar burrat të këndonin këngë serbe”. Betimi për Drejtësi. 24 prill 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/gjykimi-per-krime-lufte-deshmitarja-thote-se-policia-serbe-i-kishin-detyruar-burrat-te-kendonin-kenge-serbe/>). (Qasur së fundi me 6 gusht 2020).

palëvizshëm. Gjykatësi Hoti, kishte deklaruar se nuk beson që gjykata ka kapacitete teknike të realizojë lidhjen përmes videolinkut me të, andaj do të zhvendosen fizikisht në shtëpinë e tij, me të cilin paraprakisht përmes telefonit janë koordinuar lidhur me kohën. Gjykata gjithashtu kishte marr aktvendim që të lexohen deklaratat e dëshmitarëve Shpresa Gërvalla dhe Naile Bajrami të dhëna në policinë e EULEX-it, meqenëse ato janë të paarritshme për organet e ndjekjes për shkak se jetojnë jashtë Kosovës.⁸³

Pas përfundimit të gjykimit, me 25 tetor 2018, trupi gjykues i udhëhequr nga Arben Hoti, ka shpallur fajtor të akuzuarin duke e dënuar me 10 vite burgim.⁸⁴

Ndërkaq, me 20 gusht të vitit 2019, në Gjykatë të Apelit, i akuzuari përmes mbrojtësve të tij ka kërkuar që të lirohet nga akuza apo t'i zbutet dënimi.

Në anën tjetër, të kënaqur me dënimin e shqiptuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë, kishin mbetur Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, që nuk kishin ushtruar fare ankesë në shkallën e dytë.⁸⁵ Gjykata e shkallës së dytë ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë. Në aktgjykimin e Apelit thuhej se ankesat e mbrojtësve të të akuzuarit Bislimi, janë të pabazuara.

“Gjykata e Apelit me vëmendje ka shqyrtuar aktgjykimin e shkallës së parë, ankesat e mbrojtësve të akuzuarve, si dhe shkresat e lëndës dhe vlerëson se aktgjykimi i atakuar me ankesë nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale por as shkelje të tjera të cilat kjo gjykatë sipas detyrës zyrtare është e obliguar ti shqyrtojë. Kjo për faktin se gjykata ka dhënë arsyet për faktet vendimtare, ka arsyetuar secilën provë veç e veç, duke i ndërlidhur me njëra tjetrën dhe duke vërtetuar një gjendje faktike të drejtë dhe të ligjshme”, thuhej ndër të tjera në aktgjykim.⁸⁶

Ndërkaq, Gjykata Supreme e ka refuzuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë së paraqitur nga ana e mbrojtjes së Skënder Bislimit.

Kundër aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kishte paraqitur mbrojtja e Bislimit, me pretendimet për shkelje të ligjit penal dhe shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale.

Mbrojtja e Bislimit, i kishte propozuar Gjykatës Supreme që ta aprovojë si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të ndryshojë aktgjykimet e kundërshtuara dhe të dënuarin ta lirojë

⁸³ “Në gjykimin ndaj të akuzuarit për krime lufte dëshmitari do të dëgjohet në shtëpinë e tij”. Betimi për Drejtësi. 4 qershor 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ne-gjykimin-ndaj-te-akuzuarit-per-krime-lufte-deshmitari-do-te-degjohet-ne-shtepine-e-tij/>). (Qasur së fundi me 6 gusht 2020).

⁸⁴ “Dhjetë vjet burg për të akuzuarin për krime lufte, Skender Bislimi”. Betimi për Drejtësi. 25 tetor 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/dhjetje-vjet-burg-per-te-akuzuarin-per-krime-lufte-skender-bislimi/>). (Qasur së fundi me 6 gusht 2020).

⁸⁵ “Mbrojtja kërkon nga Apeli që Skënder Bislimi të lirohet nga akuza për krime lufte, ose t'i zbutet dënimi”. Betimi për Drejtësi. 20 gusht 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/mbrojtja-kerkon-nga-apeli-qe-skender-bislimi-te-lirohet-nga-akuza-per-krime-lufte-ose-ti-zbutet-denimi/>). (Qasur së fundi me 6 gusht 2020).

⁸⁶ “Apeli vërteton dënimin prej 10 vjetësh burg ndaj të akuzuarit për krime lufte në Kosovë”. Betimi për Drejtësi. 10 tetor 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-verteton-denimin-prej-10-vjetesh-burg-ndaj-te-akuzuarit-per-krime-lufte-ne-kosove/>). (Qasur së fundi me 6 gusht 2020).

nga akuza për veprën penale, për të cilën është gjykuar, ose aktgjykimet e kundërshtuara t'i anulojë dhe lëndën ta kthej në rivendosje.

Sipas kërkesës së mbrojtjes, aktgjykimet e kundërshtuara janë marrë me shkelje të rënda të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, pasi nuk janë paraqitur qartë dhe në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyes i konsideron të vërtetuara apo të pavërtetuara.

Sipas kërkesës së mbrojtjes, në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë në gjetjet e gjykatës theksohet se gjendja faktike është vërtetuar në bazë të dëshmive të dëshmitarëve dhe provave materiale të cilat janë nxjerrë në shqyrtimin gjyqësor edhe pse sipas mbrojtjes, nuk kishte pasur prova materiale të administruara.

Po ashtu, mbrojtja e Bislimit pretendonte në kërkesën e saj se gjykata e shkallës së parë ka arritur në përfundim jo të drejtë dhe të gabuar se këtë vepër penale mund ta kryejë çdo person, pasi që kryerës i kësaj veprë penale mund të jetë vetëm pjesëtari i ushtrisë, organizatës politike apo palë në konflikt ose çdo person që është në shërbim të tyre, e që në rastin konkret, i dënuari Bislimi sipas mbrojtjes nuk ka qenë nuk ishte në shërbim ushtarak.

Mirëpo, këtë kërkesë si të pabazuar e ka vlerësuar kolegji i Gjykatës Supreme, në përbërje nga gjykatësit, Valdete Daka, Agim Maliqi dhe Rasim Rasimi.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimi i mbrojtësit të të dënuarit, është i pabazuar, ngase aktgjykimet kundër të cilave është parashtruar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, nuk përmbajnë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe as shkelje të ligjit penal të cilat pretendohen.

“Gjykata e shkallës së parë me rastin e arsyetimit të aktgjykimin të saj në mënyrë të qartë ka paraqitur konkludimet e saja përkitazi me veprën penale e cila i është vënë në barrë të dënuarit sipas aktakuzës, dhe për më tepër, duke u bazuar në dispozitën e nenit 142 të LP të RSFJ-së, ka 5 gjetur se në veprimet e të dënuarit janë manifestuar të gjitha elementet objektive dhe subjektive të kësaj veprë penale”, thuhet në aktgjykimin e Supremes.

Në aktgjykimin e saj, Supremja thekson se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka vlerësuar se veprën penale mund ta kryejë kushdo dhe se për kryerjen e kësaj veprë penale nuk është e nevojshme që kryerësi të jetë pjesëtar i ndonjë formacioni ushtarak, paraushtarak apo ndonjë formacioni tjetër.

“Në rastin konkret me të drejtë gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se në veprimet e të dënuarit janë manifestuar të gjitha elementet të veprës penale për të cilën është shpallur fajtor dhe është dënuar i dënuari, meqë veprimet e tij kanë qenë të drejtuara ndaj popullatës civile dhe fakti se nuk ka qenë pjesëtar i asnjërës palë në konflikt në asnjë rrethanë nuk e ka detyruar

që të mos i respektoj ligjet dhe rregullat e të drejtës ndërkombëtare përkitazi me sjelljet e tij”, thuhet në aktgjykimin e Supremes.⁸⁷

⁸⁷ “Gjykata Supreme e lë në fuqi dënimin ndaj të akuzuarit për krime lufte, Skënder Bislimi”. Betimi për Drejtësi. 11 mars 2020. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/gjykata-supreme-e-le-ne-fuqi-denimin-ndaj-te-akuzuarit-per-krime-lufte-skender-bislimi/>). (Qasur së fundi me 6 gusht 2020).

2. Rasti BELLANICA

Gjykata Themelore në Gjakovë

Numri i lëndës: PKR.nr.154/16

Vepra penale: “Përgjegjësia e komandës”, neni 129 i Kodit të Përkohshëm Penal

Kryetari i Trupit Gjykses: Nikollë Komani

Prokuror special: Drita Hajdari

I pandehur: Fatmir Limaj

Faza e procedurës: Aktgjykim i plotfuqishëm

Nga ngritja e aktakuzës e deri kur aktgjykimi ka marrë formën e prerë kanë kaluar mbi dy vite

PSRK-ja, aktakuzën ndaj Limajt e kishte ngritur me 28 tetor 2016, lidhur me vrasjen e dy civilëve shqiptarë gjatë luftës në Kosovë 1998-1999. Sipas PSRK-së, Limaj dyshohej se në cilësinë e komandantit ushtarak të Brigadës 121, të UÇK-së, nuk ka ndërmarrë masa të arsyeshme dhe të nevojshme brenda kompetencave të tij, për të parandaluar apo ndaluar vrasjen e Ramiz Hoxhës nga fshati Bellanicë dhe Selman Binishit, nga fshati Banjë, Komuna e Malishevës, të cilët me arsyetimin se janë bashkëpunëtorë të okupatorit serb, janë marrë peng nga disa persona me maska, më 2 tetor 1998, dhe më pas janë ekzekutuar. Sipas PSRK-së, i akuzuari ka shkelur nenin 3 të Konventave të Gjenezës dhe Kodin Penal, i cili e inkriminon si vepër penale edhe “përgjegjësinë e komandës”.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit:

Aktakuza në këtë rast ishte ngritur me 28 tetor 2016, ndërsa shqyrtimi fillestar për këtë rast ishte mbajtur me 13 janar 2017, apo mbi dy muaj, edhe pse ishte dashur të mbahej brenda afatit 30 ditësh nga ngritja e aktakuzës, siç është përcaktuar me KPPK.

Në periudhën qershor 2017 – mars 2018 lidhur me këtë rast janë mbajtur tetë seanca gjyqësore kurse dy seanca që ishin paraparë të mbaheshin më 4 dhe 5 shtator 2017, kishin dështuar të mbahen për arsye shëndetësore të avokatit mbrojtës të Limaj. Në seancën e mbajtur me 16 tetor 2017, ishin dëgjuar tre dëshmitarë Nuhi Binishi, Hajriz Hoxha dhe Enver Hoxha, dëshmia e të cilëve kishte zgjatuar më shumë se gjashtë orë, pasi të njëjtit kishin rrëfyer për vrasjen e Ramiz Hoxhës nga Bellanica dhe Selman Binishit nga Banja, që kishte ndodhur më 2 tetor 1998.⁸⁸

⁸⁸ “Familjarët e Ramiz Hoxhës e Selman Binishit dëshmojnë në gjykimin për krime lufte ndaj Fatmir Limajt”. Betimi për Drejtësi. 16 tetor 2017. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/familjaret-e-ramiz-hoxhes-e-selman-binishit-deshmojne-ne-gjykimin-per-krime-lufte-ndaj-fatmir-limajt/>). (Qasur së fundi me 6 gusht 2020).

Seanca e radhës kishte vazhduar me 17 tetor 2017, në të cilën kishin dëshmuar Fadil Hoxha, Skender Hoti, Ymer dhe Ejup Hoxha.⁸⁹ Në këtë gjykim kishin dëshmuar një numër i madh personaliteteve nga politika si Jakup Krasniqi, Rexhep Selimi, Azem Syla etj. Në seancën e mbajtur me 15 janar 2018, kishte dhënë dëshminë e tij shefi i deputetëve të Lëvizjes Vetëvendosje Rexhep Selimi, i cili kishte demantuar një komunikatë të lëshuar nga shtabi i përgjithshëm i UÇK-së, sipas së cilës ishte dhënë njoftimi për ekzekutimin e Ramiz Hoxhës dhe Selman Binishit.⁹⁰

Një ditë më pas, me 16 janar 2018, kishte dhënë dëshminë ish-komandanti i shtabit të përgjithshëm të UÇK-së, Azem Syla, i cili kishte deklaruar se nuk kishte pasur njohuri dhe se nuk e din se kush e kishte shkruar komunikatën e publikuar në “Zëri i Kosovës”.⁹¹

Të njëjtën ditë kishte dhënë dëshminë e tij edhe avokati Sokol Dobruna, i cili kishte qenë kryetar i Gjykatës Ushtarake të UÇK-së, ku kishte deklaruar se nuk kishte dëgjuar për vrasjen e Ramiz Hoxhës e Selman Binishit.⁹²

Me 2 shkurt 2018, në cilësinë e dëshmitarit është dëgjuar kryetari i Këshillit Kombëtar të Nismës Socialdemokrate, Jakup Krasniqi, i cili kishte qenë zëdhënës i UÇK-së. Ai në këtë seancë kishte mohuar që Shtabi i Përgjithshëm të ketë lëshuar kumtesën, më 4 nëntor 1998, që ishte publikuar në gazetën “Kohën Ditore”, e në të cilën ishin përmendur emrat e dy civilëve shqiptarë të vrarë, Ramiz Hoxha e Selman Binishi, në Malishevë.⁹³

Të njëjtën seancë është dëgjuar edhe kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, njëherësh ish-bashkëluftëtari i Fatmir Limajt, i cili kishte mohuar të ketë qenë në vendin e ngjarjes, kur ishin gjetur trupat e vrarë të dy civilëve shqiptarë, Ramiz Hoxha dhe Selman Binishi.⁹⁴ Përpos

⁸⁹ “Dëshmitari thotë se bashkë me Fatmir Limajn i panë kufomat e Ramiz Hoxhës e Selman Binishit”. Betimi për Drejtësi. 17 tetor 2017. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/deshmitari-thote-se-bashke-me-fatmir-limajn-i-pane-kufomat-e-ramiz-hoxhes-e-selman-binishit/>). (Qasur së fundi me 6 gusht 2020).

⁹⁰ “Gjykimi i Fatmir Limajt për krime lufte – Rexhep Selimi demanton komunikatën e UÇK-së që merrte përgjegjësinë për vrasjen e dy civilëve”. Betimi për Drejtësi. 15 janar 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/gjykimi-i-fatmir-limajt-per-krime-lufte-rexhep-selimi-demanton-komunikaten-e-uck-se-qe-merrte-pergjegjesine-per-vrasjen-e-dy-civileve/>). (Qasur së fundi me 6 gusht 2020).

⁹¹ “Azem Syla thotë se nuk kishte njohuri për komunikatën që merrte përgjegjësinë për vrasjen e dy civilëve shqiptarë”. Betimi për Drejtësi. 16 janar 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/azem-syla-thote-se-nuk-kishte-njohuri-per-komunikaten-qe-merrte-pergjegjesine-per-vrasjen-e-dy-civileve-shqiptare/>). (Qasur së fundi me 6 gusht 2020).

⁹² “Sokol Dobruna thotë se nuk kishte dëgjuar për rastin e vrasjes në fshatin Bellanice”. Betimi për Drejtësi. 16 janar 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/sokol-dobruna-thote-se-nuk-kishte-degjuar-per-rastin-e-vrasjes-ne-fshatin-bellanice/>). (Qasur së fundi me 6 gusht 2020).

⁹³ “Jakup Krasniqi thotë se Shtabi i Përgjithshëm nuk e lëshoi kumtesën që merrte përgjegjësinë për vrasjen e dy civilëve”. Betimi për Drejtësi. 2 shkurt 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/jakup-krasniqi-thote-se-shtabi-i-pergjithshem-nuk-e-leshoi-kumtesen-qe-merr-pergjegjesine-per-vrasjen-e-dy-civileve/>). (Qasur së fundi me 6 gusht 2020).

⁹⁴ “Ragip Begaj mohon të ketë qenë në vendin ku u gjetën trupat e dy civilëve të vrarë”. Betimi për Drejtësi. 2 shkurt 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ragip-begaj-mohon-te-kete-qene-ne-vendin-ku-u-gjeten-trupat-e-dy-civileve-te-vrare/>). (Qasur së fundi me 6 gusht 2020).

dëgjimit të këtyre dëshmitarëve në seancën e 2 shkurtit 2018, i akuzuari Limaj, kishte shfrytëzuar të drejtën e tij ligjore për tu mbrojtur në heshtje.⁹⁵

Me 6 mars 2018, ishte dhënë fjala përfundimtare në të cilën PSRK-ja kishte kërkuar dënimin e Limajt, ndërsa mbrojtësi i të akuzuarit Limaj, avokati Tahir Rrecaj kishte kërkuar që i mbrojturi i tij të lirohet nga akuza.⁹⁶

Përfundimisht, më 9 mars 2018, Gjykata Themelore në Gjakovë në mungesë të provave kishte liruar nga akuzat Fatmir Limajn. Sipas këtij aktgjykimi, gjykata nuk ka gjetur elemente të veprës penale, me të cilën do të ngarkohej Limaj.

“Nga provat e administruara nuk është vërtetuar se personat që e kanë ekzekutuar kanë qenë pjesëtarë të UÇK-së, nën të cilën komandë kanë qenë dhe se a kanë pasur raporte vartëse me Fatmir Limajn”, kishte deklaruar kryetari i trupit gjykues, gjykatësi Nikollë Komani, me rastin e shpalljes së aktgjykimit.⁹⁷

Në nëntor 2018, aktgjykimin e shkallës së parë e kishte vërtetuar edhe Gjykata e Apelit.⁹⁸

⁹⁵ “Fatmir Limaj zgjedh të mbrohet në heshtje lidhur me akuzën për krime lufte”. Betimi për Drejtësi. 2 shkurt 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/fatmir-limaj-zgjedh-te-mbrohet-ne-heshtje-lidhur-me-akuzen-per-krime-lufte/>). (Qasur së fundi me 6 gusht 2020).

⁹⁶ “Mbrojtja kërkon që Fatmir Limaj të lirohet nga akuza për krime lufte”. Betimi për Drejtësi, 6 mars 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/mbrojtja-kerkon-qe-fatmir-limaj-te-lirohet-nga-akuza-per-krime-lufte/>); “Prokuroria Speciale kërkon që Fatmir Limaj të dënohet për krime lufte në rastin “Bellanica””. Betimi për Drejtësi, 6 mars 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/prokuroria-speciale-kerkon-qe-fatmir-limaj-te-denohet-per-krime-lufte-ne-rastin-bellanica/>). (Qasur së fundi me 6 gusht 2020).

⁹⁷ “Fatmir Limaj lirohet nga akuza për krime lufte në rastin “Bellanica””. Betimi për Drejtësi, 9 mars 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/fatmir-limaj-lirohet-nga-akuza-per-krime-lufte-ne-rastin-bellanica/>). (Qasur së fundi me 6 gusht 2020).

⁹⁸ “Apeli vërteton pafajësinë e Fatmir Limajn për rastin “Bellanica””. Bëtimi për Drejtësi, 14 nëntor 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-verteton-pafajesine-e-fatmir-limajt-per-rastin-bellanica/>). (Qasur së fundi me 6 gusht 2020).

3. Rasti i ish-policit rezervë serb i dyshuar për krime lufte në Prishtinë gjatë vitit 1999

Gjykata Themelore në Pejë

Numri i lëndës: PPS.nr.75/2014

Vepra penale: “Krimet e luftës në shkelje të rëndë të nenit 3 të përbashkët të konventave të Gjenevës”

Kryetari i Trupit Gjykses: Kreshnik Radoniqi

Prokuror special: Fikrije Fejzullahu, pastaj Habibe Salihi

I pandehur: Milorad Zaiqi

Faza e procedurës: Aktgjykim përfundimtar

Nga ngritja e aktakuzës e deri kur aktgjykimi ka marrë formën e prerë kanë kaluar 433 ditë apo 1 vit e 2 muaj

Kallëzimi penal në këtë rast ishte parashtruar me 12 shkurt 2008, ndërsa hetimet zyrtare kishin filluar me 26 maj 2014, ku prokuroria në gusht të vitit 2015 e kishte autorizuar Policinë e Kosovës për të hetuar rastin, ndërsa hetimet në këtë rast janë ndërprerë në prill të vitit 2016. Por në mars 2018 ishin rihapur prapë hetimet, ndërsa aktakuza ishte ngritur me 25 korrik 2018.

Sipas aktakuzës së PSRK-së, Milorad Zaiqi dyshohej se gjatë periudhës kohore qershor-korrik të vitit 1998, në fshatin Dush të Komunës së Klinës, aktivisht kishte marrë pjesë si ushtar dhe paramilitar serb në ofensivat kundër popullatës shqiptare, duke përgatitur edhe shtëpinë e tij që të shërbente si bazë e forcave serbe.

“Me datë 19 qershor 1998, rreth orës 12:00 në fshatin Dush, i pandehuri i veshur në pjesën e epërme me uniformë ushtarake dhe në pjesën e poshtme me pantollë civil, nga vetura e tij ‘Zastava’, ngjyrë e verdhë, shkarkoi tek shtëpia e tij në Dush, armë të kalibrit të ndryshëm”, thuhet në aktakuzë. Më pas, sipas aktakuzës, ai kishte shtënë prej shtëpisë së tij, me automatik në drejtim të shtëpive të shqiptarëve.

Ndërsa, në pasditen e së njëjtës datë, siç thuhet në aktakuzë, kishin filluar sulmet e serbëve në drejtim të fshatit Dush, dhe nga shtëpia e të pandehurit ishin dhanë urdhra për ofensivë. Si pasojë e këtyre sulmeve, në tërësi ishin djegur shtëpitë e shqiptarëve në fshatin Dush dhe ishin djegur Zade, Osman dhe Haradin Marmullaku, i cili ishte i paralizuar. Në aktakuzë thuhet se pjesë e këtyre sulmeve ofensive kishte qenë edhe vet i pandehuri Milorad Zaiqi.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit:

Pasi aktakuza ishte ngritur me 25 korrik 2018, pas 22 ditësh apo brenda afatit ligjor të përcaktuar me KPPK, ishte caktuar shqyrtimit fillestar, por i cili kishte dështuar për shkak se i akuzuari dhe mbrojtësi i tij, përpos aktakuzës nuk kishin qenë të pajisur me asnjë shkresë të

lëndës.⁹⁹ Me 22 gusht 2018, pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurores Fikrije Fejzullahu, i akuzuari ishte deklaruar i pafajshëm për krime lufte.¹⁰⁰

Pas 35 ditësh, apo brenda afatit të përcaktuar me KPPK, ku shqyrtimi i dytë caktohet jo më herët se tridhjetë (30) ditë pas shqyrtimit fillestar dhe jo më vonë se dyzet (40) ditë pas shqyrtimit fillestar, me 26 shtator 2018, ishte mbajtur shqyrtimi i dytë në këtë rast, në të cilën seancë i akuzuari kishte kërkuar hedhjen e aktakuzës, ndërsa prokurorja Fejzullahu kishte deklaruar se kishte prova të mjaftueshme ndaj tij.¹⁰¹

Në tetor 2018, Gjykata Themelore në Pejë kishte refuzuar kërkesën e të akuzuarit për hedhjen e aktakuzës, pasi sipas kësaj gjykate përshkrimi i gjendjes faktike në aktakuzë përmban elementet e mjaftueshme inkriminuese ndaj të pandehurit dhe se sipas shkresave të lëndës ekziston dyshimi i bazuar mirë se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.¹⁰²

Në seancën e 16 janarit 2019, ishin dëgjuar katër dëshmitarë Enver, Hajdin, Burim dhe Magjun Marmullaku, të cilët kishin qenë bashkëfshatarë me të akuzuarit dhe të cilët kishin deklaruar se sulmet ndaj shtëpive të shqiptarëve në fshatin Dush të Klinës, kishin ardhur nga shtëpia e Milorad Zajiq.¹⁰³

Me 8 shkurt 2019, ishte dëgjuar dëshmitari Ali Marmullaku, i cili kishte deklaruar se kishte parë të akuzuarin Zajiq në ditën e 19 qershorit 1998, të veshur në pjesën e mësipërme me uniformë ushtarake duke shkarkuar armatim tek shtëpia e tij.¹⁰⁴

Me 25 shkurt 2019, i akuzuari kishte dhënë mbrojtjen e tij ku përpos që kishte mohuar fajësinë, kishte deklaruar se më 19 qershor 1998, kishte shkuar në fshatin Dush të Klinës, por ka thënë se nuk kishte pasur me vete armatim.¹⁰⁵ Me 8 mars 2019, Gjykata Themelore në Pejë, e kishte

⁹⁹ “Dështon seanca fillestare për krime lufte në Klinë, i akuzuari kërkon të mos i ndryshohet masa e arrestit shtëpiak”. Betimi për Drejtësi. 16 gusht 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/deshton-seanca-fillestare-per-krime-lufte-ne-kline-i-akuzuari-kerkon-te-mos-i-ndryshohet-masa-e-arrestit-shtepiak/>). (Qasur së fundi me 6 gusht 2020).

¹⁰⁰ “Deklarohet i pafajshëm i akuzuari për krime lufte në Klinë, Milorad Zajiq”. Betimi për Drejtësi. 22 gusht 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/deklarohet-i-pafajshem-i-akuzuari-per-krime-lufte-ne-kline-milorad-zajiq/>). (Qasur së fundi me 6 gusht 2020).

¹⁰¹ “I akuzuari për krime lufte kërkon hudhjen e aktakuzës, prokurorja thotë se ka prova të mjaftueshme”. Betimi për Drejtësi. 26 shtator 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/i-akuzuari-per-krime-lufte-kerkon-hudhjen-e-aktakuzes-prokurorja-thote-se-ka-prova-te-mjaftueshme/>). (Qasur së fundi me 6 gusht 2020).

¹⁰² “Refuzohet kërkesa për hudhje të aktakuzës ndaj të akuzuarit për krime lufte në Klinë”. Betimi për Drejtësi. 24 tetor 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/refuzohet-kerkesa-per-hudhje-te-aktakuzes-ndaj-te-akuzuarit-per-krime-lufte-ne-kline/>). (Qasur së fundi me 6 gusht 2020).

¹⁰³ “Gjykimi për krime lufte, dëshmitarët thonë se sulmet në fshat ishin bërë nga shtëpia e të akuzuarit, Milorad Zajiq”. Betimi për Drejtësi. 16 janar 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/gjykimi-per-krime-lufte-deshmitaret-thone-se-sulmet-ne-fshat-ishin-bere-nga-shtepia-e-te-akuzuarit-milorad-zajiq/>). (Qasur së fundi me 6 gusht 2020).

¹⁰⁴ “Gjykimi për krime lufte ndaj Milorad Zajiq, dëshmitari thotë se e kishte parë atë duke zbarkuar armatim”. Betimi për Drejtësi. 8 shkurt 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/gjykimi-per-krime-lufte-ndaj-milorad-zajiq-deshmitari-thote-se-e-kishte-pare-ate-duke-zbarkuar-armatim/>). (Qasur së fundi me 6 gusht 2020).

¹⁰⁵ “I akuzuari thotë se ushtria serbe ishte vendosur në shtëpinë e tij, por mohon se ai ishte pjesë e grupeve paramilitare”. Betimi për Drejtësi. 25 shkurt 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/i-akuzuari-thote-se-ushtria-serbe-ishte-vendosur-ne-shtepine-e-tij-por-mohon-se-ai-ishte-pjese-e-grupeve-paramilitare/>). (Qasur së fundi me 6 gusht 2020).

liruar nga akuza për krime lufte, pasi sipas kësaj gjykate nuk ishte provuar se i akuzuari Zaijiq kishte marrë pjesë në sulmet ndaj shqiptarëve në fshatin Dush të Klinës. Të njëjtën ditë, atij i është ndërprerë edhe masa e arrestit shtëpiak.¹⁰⁶

Këtë vendim të shkallës së parë, në tetor 2019 e kishte vërtetuar edhe gjykata e shkallës së dytë, duke e refuzuar si të pabazuar ankesës e PSRK-së dhe e kishte vërtetuar aktgjykimin lirues të Themelores. Sipas Apelit, në kohën e luftës, ushtria paramilitare serbe kishte mundur të shfrytëzojë shtëpinë e të pandehurit për të bërë sulmet ndaj shqiptarëve, mirëpo që siç thuhet, nuk ishte provuar se Zaijiq ishte pjesëmarrës.

Pretendimet e PSRK-së që dëshmitarët kishin gjetur dhe poseduar fotografi në shtëpinë e të pandehurit, Apeli i kishte cilësuar si të paqëndrueshme pasi sipas kësaj gjykate, gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë e kishte vërtetuar gjendjen faktike. Po ashtu, sipas Apelit, të gjithë dëshmitarët vetëm e kishin krijuar bindjen se pjesëmarrës i këtyre sulmeve ishte i akuzuari Zaijiq, mirëpo në anën tjetër, e kishin pranuar se drejtpërsëdrejti nuk e kishin vërejtur të akuzuarin Zaijiq të ketë marrë pjesë në ushtrinë paramilitare serbe që kanë qenë të vendosura në shtëpinë e tij. Ndërsa, në lidhje me fotografitë e gjetura ku shihen ushtarët serbë, Apeli kishte theksuar se sipas deklaramit të dëshmitarit Ibish Marmullaku rezulton se fotot ishin gjetur në shtëpinë e një qytetari serb, e jo në shtëpinë e të akuzuarit.¹⁰⁷

Gjykata Supreme, pas kërkesës së mbrojtjes për ligjshmëri të parashtruar nga ana e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, ka konstatuar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, në rastin që Gjykata Themelore në Pejë e kishte shpallur të pafajshëm të akuzuarit për krime lufte, Milorad Zaijiq, vendim që e kishte vërtetuar edhe Gjykata e Apelit.

Në vendim thuhet se veprimet që i vihen në barë të pandehurit kanë qenë qenia anëtarë i grupit, i cili ka qenë i organizuar për kryerjen e veprave penale, (nga përmbajtja e mëtutjeshme del se është fjalë për veprat penale kundër jetës së popullsisë civile) e pastaj veprimet konkrete të cilat i ka ndërmarrë në këtë cilësi, siç janë përgatitjet për sulm (vendosja e thasëve me rërë në çatinë dhe ballkonin e shtëpisë së tij), shkarkimi i armëve në po atë shtëpi dhe të shtënat me armë në drejtim të popullatës së pambrojtur civile, me pasojat e përshkruara.

Sipas Supremes, në aktgjykimin e shkallës së parë përshkruhet përmbajtja e deklaratave të dëshmitarëve I., Xh., G., A., V., B., M., E., H., R., A. dhe A.M., por nga arsyetimi rezulton se gjykata nuk iu ka kushtuar besim sepse ka pasur shumë ndryshime në deklaratat e tyre të dhëna në procedurën paraprake dhe te prokurori i shtetit si dhe disa prej tyre nuk kanë dëshmuar për ngjarjet të cilat personalisht i kanë pa, por për atë se çka i kanë treguar të tjerët.

¹⁰⁶ “Shpallet i pafajshëm i akuzuari për krime lufte në Klinë, Milorad Zaijiq”. Betimi për Drejtësi. 8 mars 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/shpallet-i-pafajshem-i-akuzuari-per-krime-lufte-ne-kline-milorad-zaijiq/>). (Qasur së fundi me 6 gusht 2020).

¹⁰⁷ “Apeli vërteton pafajësinë e të akuzuarit për krime lufte në Klinë, Milorad Zaijiq”, Betimi për Drejtësi. 17 tetor 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-verteton-pafajesine-e-te-akuzuarit-per-krime-lufte-ne-kline-milorad-zaijiq/>). (Qasur së fundi me 6 gusht 2020).

“Në tërë arsyetimin e aktgjykimit bëhet fjalë për veprimet konkrete e të pandehurit, siç janë prania e tij në vendin e ngjarjes në kohën kritike, përgatitjet për ofensivën siç janë sjellja e thasëve me rërë dhe vendosja në ballkonin dhe çatinë e shtëpisë së të pandehurit, sjellja e armatimit dhe veprimet tjera siç janë sulmet e tij nga arma ndaj popullatës civile, e të cilat veprime, sipas aktgjykimeve të kundërshtuara, nuk janë vërtetuar. Mirëpo, sipas nenit 160 par.1 të KPK veprën penale organizimi i grupeve për kryerjen e gjenocidit, krimeve kundër njerëzimit dhe krimeve të luftës e kryen kushdo që organizon një grup me qëllim të kryerjes së ndonjë prej veprave penale nga nenet 148 -156 të këtij Kodi ndërsa veprën penale nga par.2. i këtij neni, kushdo që bëhet anëtarë i grupit nga par.1 të këtij neni.”, thuhet në vendim.

Tutje, sipas kësaj gjykate, në rastin konkret, në aktgjykimet e kundërshtuara nuk bëhet fjalë për organizimin e grupit nga neni 160 të KPK e as për bërjen anëtar të tij, edhe pse fjala është për elementin qenësor të veprës penale nga aktakuza.

“Në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë pretendohet se disa rrethana, e posaçërisht fakti se vet i pandehuri ka deklaruar se natën kritike ka qenë duke kujdestaruar, tregon se ka qenë anëtar i grupit që mori pjesë në kryerjen e krimeve të luftës në atë kohë. Megjithatë, këtij fakti nuk i është dhënë rëndësi, që paraqet shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 pika12 të KPPK. Në aktgjykimet e veta, gjykatat nuk kanë bërë dallim në mes anëtarësimit në grup i cili definohet në nenin 160 par.2 të KPK dhe kryerjes së veprimeve për të cilin grupi është themeluar edhe pse fjala është për dy veprime të cilat ligji qartazi i dallon. Kështu, organizimi i grupit dhe anëtarësimi në grup, paraqet veprim i cili inkriminohet si vepër individuale penale. Ai paraqet një stad paraprak dhe për të ekzistuar kjo vepër penale, nuk kërkohet që anëtari i grupit edhe të kryej veprën penale për të cilin grupi është themeluar”, thotë Supremja.

Sipas saj, përkundrazi, mjafton vetëm organizimi i grupit gjegjësisht anëtarësimi në grup. Në rast se ekzekutori e kryen veprën penale për të cilin grupi është themeluar (gjenocidi etj.) atëherë fare nuk ekziston vepra penale nga neni 160 të KPK por vepra penale për kryerjen e së cilës grupi është organizuar (gjenocid etj.).

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, mungesa e plotë e arsyeve për këtë element qenësor të veprës penale për të cilën i pandehuri është akuzuar paraqet shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni i cekur më lartë, për çka kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë ishte e bazuar dhe si e tillë u aprovua.

Gjykata Supreme ka vërejtur se në përshkrimin e veprimeve inkriminuese në aktakuzë, por edhe në aktgjykimin e shkallës së parë, mungon precizimi se për kryerjen e cilës vepër penale grupi është organizuar edhe pse sipas nenit 160 par.1 të KPK kjo vepër penale ekziston nëse grupi organizohet për kryerjen e ndonjëres prej veprave penale nga neni 148 -156 të KPK.

Megjithatë, sipas kësaj gjykate, gjykatat në aktgjykimet e kundërshtuara nuk e kanë liruar të pandehurin duke u ndërlidhur me këtë fakt, por për mos vërtetimin e kryerjes së veprimeve kundër popullsisë civile dhe për këtë shkelje eventuale, nuk ishte paraqitur kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë.

“Andaj, aktgjykimet e kundërshtuara janë marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 pika 12 të KPPK e cila shkelje, konform dispozitës së nenit 438 paragrafi 2 të KPPK u konstatua, pa ndikuar në vendimin e formës së prerë, sepse kërkesa ishte paraqitur në dëm të pandehurit”, thuhet në këtë vendim.¹⁰⁸

¹⁰⁸ Vendimi i Gjykatës Supreme, 18 shkurt 2020, dërguar nga zëdhënësja e kësaj gjykate Antigona Uka-Lutfiu më 28 maj 2020.

17. Anex II: Analizë e detajuar e rasteve karakteristike që janë në proces

1. Rasti Nenad Arsiq

Gjykata Themelore në Prishtinë

Numri i lëndës: PS.nr.55/19

Vepra penale: “Krimet e luftës në shkelje të rëndë të konventave të Gjenevës”

Kryetari i Trupit Gjykues: Albina Shabani-Rama

Prokuror: Drita Hajdari

I pandehur: Nenad Arsiq

Faza e procedurës: Në proces

Nga ngritja e aktakuzës e deri me 31 maj 2020 kanë kaluar 177 ditë apo 5 muaj e 25 ditë

Njësia për Hulumtimin e Krimeve të Luftës (NJHKL) të Policisë së Kosovës pas kryerjes së hetimeve, me 5 shtator 2019, ia kishte dorëzuar prokurorisë kallëzimin penal kundër Nenad Arsiqit me dyshimin se ka kryer veprën penale “krime të luftës”.

Prokuroria me 22 tetor 2019, ia kishte dorëzuar Departamentit Special të Gjykatës Themelore në Prishtinë aktvendimin për fillimin e hetimeve, ndërsa një ditë më pas me 23 tetor 2019, të akuzuarit Arsiq i ishte caktuar masa e paraburgimit prej një muaj, dhe me 6 dhjetor 2019 PSRK-ja e kishte ngritur aktakuzën në këtë rast.

Sipas aktakuzës, Arsiq gjatë kohës së luftës në Kosovë, si pjesëtar i forcave policore të njësisë rezervë të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë, ka shkelur rëndë rregullat e të drejtës ndërkombëtare humanitare kundër personave dhe pasurisë që janë të mbrojtura me dispozitat përkatëse në Konventat e Gjenevës të 12 gushtit 1949. Siç thuhet në aktakuzë, i akuzuari më 21 maj 1999, në bashkëkryerje me personat tjerë të forcave policore serbe, deri më tani të paidentifikuar, kanë marrë pjesë në aksionin kundër popullatës civile të nacionalitetit shqiptarë, ashtu që kanë shkuar në pronën e familjes Shala në lagjen “Emshir” në Prishtinë, ku fillimisht kishin larguar të gjithë personat që kishin ikur nga zonat e konfliktit dhe ishin strehuar tek familja Shala.

Sipas aktakuzës, pasi në shtëpi kishin mbetur vetëm të dëmtuarit Jakup dhe Skender Shala, i akuzuari me dashje ka vepruar në mënyrë çnjerëzore dhe ka cenuar integritetin trupor, shëndetin, mirëqenien fizike dhe mendore të dëmtuarve duke i rrahur për një kohë të gjatë me mjete të forta në pjesë të ndryshme të trupit, duke iu shkaktuar vuajtje dhe dëmtime të rënda trupore, duke i fyer dhe sharë dhe me dashje ka marrë pjesë në poshtërimin dhe trajtimin çnjerëzor të dëmtuarit Jakup Shala, i cili edhe pas ishte i lënduar rëndë, e kishte detyruar me forcë të pijë alkool dhe të këndoje këngë serbe, të cilët të dëmtuar vuajnë edhe sot nga këto tortura.

Me këto veprime, prokuroria e ngarkon të akuzuarin se në bashkëkryerje ka kryer veprën penale krimet e luftës kundër popullsisë civile, nga neni 142, lidhur me nenin 22 të Ligjit Penal të Republikës Socialiste Federative të ish-Jugosllavisë, aktualisht e penalizuar si Krimet e Luftës

në shkelje të rëndë të Konventave të Gjenevës nga neni 144, paragrafi 2, nën paragrafi 2.2 dhe 2.3 lidhur me paragrafin 1, nën paragrafin 1.2, lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Gjithnjë sipas aktakuzës, të njëjtën ditë kohë dhe në vendin e lartcekur, i akuzuari në bashkëkryerje me personat tjerë të forcave policore serbe, të paidentifikuar, në aksionin kundër popullatës civile, me dashje kanë marrë pjesë në shkatërrimin masiv të pasurisë si dhe përvetësimin që nuk mund të justifikohet me nevojat ushtarake.

Në aktin akuzues thuhet se ata në kërkim të parave dhe gjërave me vlerë, kanë marrë pjesë në bastisjen e shtëpive të familjes Shala, me ç'rast kanë dëmtuar pronën dhe kanë bastisur fermën e të dëmtuarit Jakup Shala, me ç'rast kishin gjetur dhe përvetësuar 3200 litra naftë të mbushura në fuqi, 200 mijë marka të fshehura në shtëpi si dhe kanë përvetësuar shtatë makina të ndryshme të familjes Shala.

Me këto veprime prokuroria e ngarkon të akuzuarin se në bashkëkryerje ka kryer veprën penale krimet e luftës kundër popullsisë civile nga neni 142, lidhur me nenin 22 të Ligjit Penal të Republikës Socialiste Federative të ish-Jugosllavisë, aktualisht e penalizuar si Krimet e Luftës në shkelje të rëndë të Konventave të Gjenevës nga neni 144, paragrafi 2, nën paragrafi 2.4, lidhur me paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit:

Pas aktakuza në këtë rast ishte ngritur me 6 dhjetor 2019, seanca e shqyrtimit fillestar ishte mbajtur me 24 dhjetor 2019, apo pas 18 ditësh, brenda afatit ligjor të përcaktuar me KPPK. Në këtë seancë pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurores speciale Drita Hajdari, i akuzuari nuk e kishte pranuar fajësinë për krime lufte.¹⁰⁹

Pas paraqitjes së kërkesës për hudhjen e aktakuzës dhe kundërshtimin e provave, Gjykata Themelore në Prishtinë, ia kishte refuzuar të akuzuarit këtë kërkesë si të pabazuar. Njëjtë kishte vepruar edhe Gjykata e Apelit e cila i kishte hudhur poshtë pretendimet e të akuzuarit lidhur me aktakuzën. Seanca e shqyrtimit kryesor ishte caktuar me 20 mars 2020, mirëpo për shkak të gjendjes së krijuar me COVID-19 ishte pamundësuar mbajtja e kësaj seancë. Ndërsa seanca e radhës ende nuk është caktuar.

¹⁰⁹ “Deklarohet i pafajshëm i akuzuari për krime lufte në Prishtinë gjatë vitit 1999”. Betimi për Drejtësi. 24 dhjetor 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/deklarohet-i-pafajshem-i-akuzuari-per-krime-lufte-ne-prishtine-gjate-vitit-1999/>). (Qasur së fundi me 6 gusht 2020).

2. Rasti Goran Stanishiq

Gjykata Themelore në Prishtinë

Numri i lëndës: PS.nr.11/20

Vepra penale: “Krimet e luftës kundër popullsisë civile” nga neni 142, lidhur me nenin 22 të Ligjit Penal të Republikës Socialiste Federative të ish-Jugosllavisë, aktualisht e penalizuar si Krimet e Luftës në shkelje të rëndë të nenit 3 të Konventës së Gjenevës nga neni 146, paragrafi 1, dhe neni 2, nën paragrafi 2.1, lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Kryetari i Trupit Gjykses: Valon Kurtaj

Prokuror : Drita Hajdari

I pandehur: Goran Stanishiq

Faza e procedurës: Në proces

Nga ngritja e aktakuzës deri më 31 maj 2020 kanë kaluar 95 ditë apo 3 muaj e 5 ditë

Sipas aktakuzës së ngritur nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, i pandehuri Goran Stanishiq, si pjesëtar i forcës policore rezervë të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë, në muajin prill të vitit 1999, gjatë luftës në Kosovë, në kundërshtim me rregullat e të drejtës ndërkombëtare humanitare, gjatë një sulmi të gjerë dhe sistematik të forcave ushtarake paramilitare dhe policore serbe kundër popullatës civile shqiptare, në fshatrat Sllovi dhe Tërbovc, në bashkëveprim me pjesëtarë të tjerë të këtij njësi, kishte marrë pjesë në dëbimin e popullatës civile shqiptare dhe në kryerjen e vrasjeve dhe veprimeve të tjera të kundërligjshme.

Siç thuhet në aktakuzë, më 15 prill 1999, në fshatin Sllovi të Komunës së Lipjanit, i pandehuri në bashkëveprim me pjesëtarë të tjerë të njësitit, kishin shkuar në oborrin e shtëpisë së familjes G, kanë urdhëruar anëtarët e kësaj familje të dalin nga shtëpia, dhe pasi që ata kishin dalë, i kishin ndarë meshkujt nga gratë, i kishin detyruar gratë dhe fëmijët të dalin nga oborri në rrugë, ku më pas, në prezencë të dëshmitarëve Z.G dhe vajzës së saj Xh.H, që ende nuk kishin dalë nga oborri, i kishin rreshtuar pranë murit të oborrit të shtëpisë M.G, dy djemtë e tij O.G dhe E.G, dhe dy nipat e tij, A.G dhe B.H, e pastaj kanë shtënë në drejtim të tyre me armë automatike, dhe që të gjithë i kishin vrarë në vend, e pastaj e kishin detyruar Z.G dhe X.H që të largoheshin nga oborri.

Tutje, në aktakuzë thuhet se të njëjtën ditë dhe në të njëjtin fshat, në bashkëveprim me pjesëtarë të tjerë të njësitit, me automjet kishin shkuar në oborrin e shtëpisë së familjes B. Pasi kishin dal nga vetura, kishin shtënë me armë automatike në drejtim të F.G, B.B, F.B dhe R.B, të cilët kishin qenë në oborr afër bunarit, dhe e kishin vrarë F.B duke e qëlluar në shpinë, ndërsa F.G, B.B dhe R.B kishin shpëtuar duke ikur me vrap në drejtime të ndryshme nga vendi i ngjarjes.

Gjithnjë sipas aktakuzës, të njëjtën ditë dhe në të njëjtin fshat, në afërsi të shkollës së vjetër të fshatit, kishin ndarë nga kolona e popullatës civile shqiptare që i kishin detyruar të braktisin fshatin, J.K, B.G, V.P, R.K, A.I dhe F.B, dhe pasi që i kishin rreshtuar përball një muri, kishin shtënë në drejtim të tyre me armë automatike, duke i vrarë të gjithë në vend.

Më 16 prill 1999, në fshatin Tërbovc të Komunës së Lipjanit, në vendin e quajtur “Lugu i Lakrave”, i pandehuri së bashku me katër persona të tjerë të uniformuar dhe të armatosur kishin ndaluar të dëmtuarën A.I së bashku me tani të ndjerën Z.G, të cilat kishin qenë duke shkuar nëpër mal për t’iu bashkangjitur bashkëfshatarëve dhe familjeve të tyre.

Siç thuhet në aktakuzë, e dëmtuara A.I kishte nxjerrë një pako të cigareve me kërkesë të të pandehurit, dhe duke ua dhënë ai cigaret personave të tjerë, ajo kishte shfrytëzuar rastin dhe kishte filluar që të vraponte për të ikur, ndërsa i pandehuri me persona të tjerë të armatosur kishin shtënë në drejtim të saj që ta vrasin, ku e kishin goditur në pjesën e kofshës së djathtë, për çka ajo ishte rrëzuar, dhe ishte rrokullisur deri tek përroi, ku në mbrëmje e kishin gjetur fshatarët, dhe pasi që ajo ua kishte treguar vendin se ku ishte ndarë me të ndjerën Z.G, fshatarët kishin shkuar aty dhe të njëjtën e kishin gjetur të vrarë.

Për këtë, prokuroria e ngarkon të akuzuarin se në bashkëveprim me pjesëtarë të tjerë të panjohur të njësitit rezervist të policisë serbe dhe persona të tjerë të armatosur, ka kryer veprën penale “krimet e luftës kundër popullsisë civile” nga neni 142, lidhur me nenin 22 të Ligjit Penal të Republikës Socialiste Federative të ish-Jugosllavisë, aktualisht e penalizuar si Krimet e Luftës në shkelje të rëndë të nenit 3 të Konventës së Gjenevës nga neni 146, paragrafi 1, dhe neni 2, nën paragrafi 2.1, lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit:

Kallëzimi penal i është dorëzuar PSRK-së më 14 maj të vitit 2018 ndaj Goran Stanishiqit dhe 30 të dyshuarve të tjerë. Kallëzimi është dorëzuar për shkak të dyshimit të bazuar se të dyshuarit kanë kryer veprën penale “krim i luftës kundër popullatës civile”, e po ashtu edhe vepra të tjera penale.

Pas arrestimit të Stanishiq me 20 korrik, me 22 korrik të vitit 2019, ishte mbajtur seanca dëgjimore për caktimin e masës së paraburgimit ndaj të akuzuarit në fjalë, seanca kishte qenë e mbyllur për publikun me kërkesë të PSRK-së.

Në po të njëjtën ditë, Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti Special, kishte aprovuar kërkesën e PSRK-së për caktimin e masës së paraburgimit. Kjo gjykatë, përmes një komunikate për media, kishte bërë të ditur se ndaj Stanishiq është caktuar masa e paraburgimit në kohëzgjatje prej një muaji. Në komunikatë thuhej se janë përmbushur kushtet e parapara ligjore për caktimin e kësaj mase, kurse kundër këtij vendimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit.¹¹⁰

Kurse, Departamenti Special i Gjykatës së Apelit, e kishte refuzuar si të pa bazuar ankesën e avokatit mbrojtës, kundër caktimit të masës së paraburgimit. “Gjykata e Apelit, gjeti se aktvendimi për caktimin e paraburgimit, ndaj të pandehurit është i drejtë dhe i ligjshëm, ngase ekziston dyshimi i bazuar, se ai e ka kryer veprën penale për të cilën dyshohet, ndërkaq

¹¹⁰ “Një muaj paraburgim ndaj të dyshuarit për krime lufte ndaj popullatës civile, Goran Stanishiq”. Betimi për Drejtësi. 22 korrik 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/nje-muaj-paraburgim-ndaj-te-dyshuarit-per-krime-lufte-ndaj-popullates-civile-goran-stanishiq/>). (Qasur së fundi me 6 gusht 2020).

ekzistojnë arsye për te besuar, se mund të ikë ose arratiset, më qellim të shmangies se procedurës penale, të ndikoj në prova ose dëshmitarë ose të kryej ndonjë vepër penale të re.”, thuhej në komunikatën për media të Gjykatës së Apelit.¹¹¹

Aktakuza në këtë rast është ngritur me 6 shkurt 2019 nga prokurorja e PSRK-së, Drita Hajdari.

Më 26 shkurt 2020, i akuzuari është paraqitur në gjykatore dhe është deklaruar i pafajshëm në seancën fillestare. Pas leximit të aktakuzës nga prokurorja speciale, Drita Hajdari, i akuzuari Stanishiq nuk e ka pranuar fajësinë, duke thënë se nuk ndihet fajtor për asnjë pikë të aktakuzës. Pas kësaj, kryetari i trupit gjykues, gjykatësi Valon Kurtaj, e kishte udhëzuar atë në të drejtën e tij ligjore, që në afat prej 30 ditësh të paraqes kërkesën për hedhje të aktakuzës dhe kundërshtimin e provave. Ndryshe, në fillim të kësaj seance, gjykatësi Kurtaj kishte njoftuar se gjykatësi i procedurës paraprake ka marrë vendim me të cilin ka urdhëruar që të mos publikohen emrat e dëshmitarëve.¹¹² Në këtë rast, gjykata e shkallës së parë, ka refuzuar kërkesën për hedhje të akuzës të parashtruar nga mbrojtja e Stanishiq.

¹¹¹ “Apeli lë në paraburgim të dyshuarin për krime lufte ndaj popullatës civile, Goran Stanishiq”. Betimi për Drejtësi. 6 gusht 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-le-ne-paraburgim-te-dyshuarin-per-krime-lufte-ndaj-popullates-civile-goran-stanishiq/>). (Qasur së fundi me 6 gusht 2020).

¹¹² “Deklarohet i pafajshëm i akuzuari për krime lufte ndaj popullatës civile në Kosovë”. Betimi për Drejtësi. 26 shkurt 2020. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/deklarohet-i-pafajshem-i-akuzuari-per-krime-lufte-ndaj-popullates-civile-ne-kosove/>). (Qasur së fundi me 6 gusht 2020).

3. Rasti i krimeve të luftës në lagjen “Kristal” në Pejë

Gjykata Themelore në Prishtinë

Numri i lëndës: PS.nr.15/19

Vepra penale: “Krimet e luftës në shkelje të rëndë të nenit 3 të përbashkët të konventave të Gjenevës” që ndiqet sipas nenit 152, paragrafi 1 i Kodit Penal të Kosovës dhe nenit 142 të Kodit Penal të RSFJ-së, “Krimet e luftës në shkelje të rëndë të ligjeve dhe zakoneve që zbatohen në konfliktet e armatosura e që nuk janë karakterit ndërkombëtar” që ndiqen sipas nenit 153, nënparagrafi 21.,2.2,2.5,2.8, 212 dhe 2.15 dhe nenit 3 të KPK-së.

Kryetari i Trupit Gjykses: Arben Hoti

Prokuror : Habibe Salihi

I pandehur: Zoran Gjokiq

Faza e procedurës: Në proces

Nga ngritja e aktakuzës deri më 31 maj 2020 kanë kaluar 366 ditë apo 1 vit e 1 ditë

Sipas aktakuzës së ngritur më 31 maj 2019, i pandehuri Zoran Gjokiq, akuzohet se gjatë muajit mars – prill të vitit 1999, në lagjen “Kristal” të Pejës, duke bashkëvepruar me një grup të organizuar kriminal, të veshur me uniforma policore, paramilitare, ushtarake ka shkaktuar vuajtje të mëdha apo cenim i integritetit trupor ose i shëndetit, aplikim i masave të frikësimit, ndaj popullatës së pambrojtur civile, vrasje, plaçkitja e një qyteti ose vendi, urdhërimi për zhvendosjen e popullsisë civile ose ndaj individëve të veçantë civilë që nuk marrin pjesë drejtpërdrejt në konflikt.

Në aktakuzë thuhet se i pandehuri këtë e ka bërë në atë mënyrë që duke bashkëvepruar me personat deri më tani të paidentifikuar, ka shkuar në lagjen e lartcekur dhe kanë hyrë dhunshëm nëpër shtëpitë e qytetarëve shqiptarë, i kanë detyruar të largohen nga shtëpitë e tyre, i kanë maltretuar fizikisht dhe psikikisht, ashtu që me të arritur te shtëpia e Hilmi Zeqiraj, tanimë i ndjerë, i pandehuri me personat e paidentifikuar kishin hyrë dhunshëm në shtëpi e tani të ndjerit dhe derisa i njëjti kishte qenë në shtëpi, së bashku me familjen e tij dhe vëllait të tij, Skenderit, tani i ndjerë, dhe me familjen e të dëmtuarit Shaban Kalijani, serbët kishin detyruar familjarët të largohen nga shtëpitë e tyre.

Akti akuzues thotë se fillimisht e kishin rrahur të dëmtuarin Kalijani, pastaj i kishin maltretuar të ndjerët e lartcekur, i kanë plaçkitur, detyruar të ua dorëzojnë të gjitha të hollat që i kishin ata dhe familjet e tyre duke ia marrë arin e familjes, pastaj në oborrin e kësaj shtëpie fillimisht e rrahin përsëri të dëmtuarin Kalijani, në atë mënyrë që e godasin në fytyrë dhe ia thyejnë dhëmbët. Ndërsa, thuhet se të dëmtuarin Skender e detyrojnë të shkojë për të siguruar të holla, e në ndërkohë e vrasin Hilmi Zeqiraj dhe me të arritur Skender Zeqiraj e sheh vëllain e vranë, në gjendje të keqe, fillon të bërtas dhe detyrohet t’ua dorëzojë 1000 marka dhe më pas i detyrojnë të largohen nga shtëpia ku ishin.

Pasi dalin jashtë shtëpisë, sipas aktit akuzues, Skenderi e Shabani takojnë Bashkim Berishën, tanimë i ndjerë, të cilin paramilitarët serb e kishin detyruar të largohet nga shtëpia, me të arritur

te dera e Asllan Mulës, për afërsisht 70 metra nga ku u vra Hilmiu, i kanë ndarë nga kolona e qytetarëve shqiptarë të cilët i kishin larguar dhunshëm nga shtëpitë e tyre.

Tutje, thuhet se i pandehuri Zoran i ka ndaluar që të tretë, Skenderin, Bashkimin e Shabanin, duke i detyruar të kthehen me fytyrë nga ai, me t'u afëruar që të tretë një metër përpara tij, iu kishte drejtuar Skenderit e Bashkimi "ju dy hyni brenda" në oborrin e Asllan Mulës.

Sipas aktakuzës, Skenderin e Bashkimin i kishte futur brenda në oborr 4 -5 metra, pastaj me kallashnikovë ka gjuajtur në drejtim të tyre, duke i lënë të dytë të vdekur. Në aktakuzë thuhet se ai i është drejtuar Shabanit me fjalët "ngaj çka po pret", e atëherë i dëmtuari Shaban duke vepruar sipas urdhrat të pandehurit arrin të largohet, rrugës takon Riza Mamaj, tanimë i ndjerë, i cili ishte me një karrocë në dorë, të cilën paramilitarët e pyesin se ku ishte nisur, derisa i njëjti u tregon, vazhdon rrugën me karrocë për në shtëpinë e kushëririt, të njëjtin e gjuan me armë në gjoks dhe rrëzohet mbi karrocë dhe vdes, pastaj Shabani vazhdon rrugën dhe vendoset fillimisht në shtëpinë e babait të tij për tu larguar të nesërmen për në Mal të Zi.

Me këtë, i akuzuari pretendohet se ka kryer veprat penale, Krimet e luftës në shkelje të rëndë të nenit 3 të përbashkët të konventave të Gjenevës, që ndiqet sipas nenit 152, paragrafi 1 i Kodit Penal të Kosovës dhe nenit 142 të Kodit Penal të RSFJ-së, Krimet e luftës në shkelje të rëndë të ligjeve dhe zakoneve që zbatohen në konfliktet e armatosura që nuk janë të karakterit ndërkombëtar, që ndiqen sipas nenit 153, paragrafi 1, nën paragrafët, 2.1,2.2,2.5,2.8,2.13 dhe 2.15 dhe nenit 3 të KPK-së.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit:

Më 5 tetor të vitit 2018 ishte pranuar kallëzimi penal në këtë rast nga ana e drejtorisë përkatëse të Policisë së Kosovës. Më 8 tetor të vitit 2018, PSRK kishte nxjerrë aktvendimin për fillim të hetimeve në këtë rast

Hetimet kishin filluar edhe kundër tre të dyshuarve të tjerë për krimet që kishin ndodhur në lagjen "Kristal" në Pejë, ndaj të cilëve nuk kishte qasje.

Pasi ishin hapur hetimet ndaj të dyshuarve, PSRK kishte kërkuar nga Departamenti për Krime të Rënda në Gjykatën Themelore në Pejë që të lëshoj urdhrat për sigurimin e të dyshuarve, kjo pasi dorëzimi i ftesave kishte qenë i pamundur meqenëse të dyshuarit nuk jetonin në adresat të cilat i posedonte prokuroria.

Më pas, Gjokiq ishte arrestuar më 1 shkurt 2019, nga Policia e Kosovës rreth orës 21:50 në pikën kufitare në Jarinjë si i dyshuar për krime lufte.

Gjokiq ishte paraqitur në Gjykatën Themelore të Pejës ku ka mohuar pretendimet e prokurorit special se ka kryer krime lufte në Pejë gjatë luftës në Kosovë më 1999. Gjykata kishte pranuar kërkesën e prokurorit që Gjokiqi të mbetet në paraburgim.¹¹³

Aktakuza në këtë rast ndaj të akuzuarit është ngritur me maj të vitit 2019.

Seanca e shqyrtimit fillestar ishte caktuar të mbahet me 21 qershor, 21 ditë pas ngritjes së aktit akuzues, duke respektuar afatet e përcaktuara ligjore nga Kodi i Procedurës Penale.

Më 21 qershor të vitit 2019, kishte dështuar të mbahej shqyrtimi fillestar në këtë rast, pasi i akuzuari nuk ishte sjellë nga Qendra e Paraburgimit në gjykatore. Gjykatësi Arben Hoti, kishte bërë të ditur se kjo gjykatë me kohë ka lëshuar urdhëresë ndaj Qendrës së Paraburgimit, respektivisht burgut të sigurisë të lartë, si dhe njësisë të transportit të Shërbimit Korrektues të Kosovës. Mirëpo, ai kishte deklaruar se më 20 qershor, përmes email-it zyrtar është informuar se urdhëresa nuk mund të realizohet pasi i pandehuri konsiderohet i sigurisë së lartë dhe se ata duhet të njoftojnë Policinë e Kosovës së paku 48 orë më herët që të marrin mbështetje për sigurinë e të pandehurit.

Gjykatësi Arben Hoti kishte bërë të ditur se edhe pse Departamenti Special ende nuk ishte funksionalizuar, mirëpo i akuzuari gjendet në paraburgim dhe është ngritur akti akuzues ndaj tij, e kanë parë të arsyeshme të bëhet caktimi i shqyrtimit fillestar në mënyrë që të respektohen afatet ligjore dhe të drejtat e të pandehurit.

Shqyrtimi fillestar, ku i akuzuari kishte mohuar fajësinë është mbajtur me 11 korrik të vitit 2019¹¹⁴, derisa me 14 gusht 2019 ishte mbajtur shqyrtimi i dytë në këtë rast. Mbrojtja e të akuzuarit përmes parashtresës së dorëzuar në gjykatë kishte kërkuar hedhjen e aktakuzës, si dhe kishte bërë kundërshtimin e provave.

Ndërkaq, prokurorja Habibe Salihi, kishte thënë se prokuroria ka prova, duke kërkuar nga gjykata të hedhet poshtë kjo kërkesë e mbrojtjes së të akuzuarit Gjokiq.¹¹⁵ Gjykata e shkallës së parë kishte refuzuar kërkesat e mbrojtjes për hedhje të aktit akuzues dhe kundërshtim të provave, ndërkaq këtë vendim e kishte konfirmuar edhe Gjykata e Apelit.

Më datën 18 nëntor të vitit 2019 kishte qenë e paraparë që të mbahet shqyrtimi kryesor në këtë rast, me ç'rast edhe do të fillonte trajtimi i rastit pas konfirmimit të akuzës, mirëpo kjo seancë nuk ishte mbajtur për shkak të mungesës së mbrojtësit.

¹¹³ “30 ditë paraburgim serbit të arrestuar në Jarinjë për krime lufte në Kosovë – hedh poshtë akuzat”. Koha.net. 2 shkurt 2019. (Shih linkun <https://www.koha.net/arberi/143062/30-dite-paraburgim-serbit-te-arrestuar-ne-jarinje-per-krime-lufte-ne-kosove-ndash-hedh-poshte-akuzat/>). (Qasur së fundi me 6 gusht 2020).

¹¹⁴ “Deklarohet i pafajshëm i akuzuari për krime lufte gjatë vitit 1999 në Pejë”. Betimi për Drejtësi. 11 korrik 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/deklarohet-i-pafajshem-i-akuzuari-per-krime-lufte-gjate-vitit-1999-ne-peje/>). (Qasur së fundi me 6 gusht 2020).

¹¹⁵ “Mbrojtja e të akuzuarit për krime lufte kërkon hudhjen e aktakuzës, PSRK thotë se ka prova”. Betimi për Drejtësi. 14 gusht 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/mbrojtja-e-te-akuzuarit-per-krime-lufte-kerkon-hudhjen-e-aktakuzes-psrk-thote-se-ka-prova/>). (Qasur së fundi me 6 gusht 2020).

Shqyrtimet kryesore në këtë rast janë mbajtur me 4 dhe 19 dhjetor të vitit 2019, si dhe me 20 janar e 21 shkurt e 6 mars të vitit 2020. Në seancën e 4 dhjetor para trupit gjykues kanë dhënë dëshmi dy dëshmitare, ato kishin thënë se kishin dëgjuar se përgjegjës për vrasjen e bashkëshortëve të tyre ishte tani i akuzuari.¹¹⁶ Edhe seanca e 19 dhjetorit ishte vazhduar me dëgjimin e dëshmitarëve, të cilët e kishin identifikuar të akuzuarin si person përgjegjës për disa vrasje.¹¹⁷

Njëri nga dëshmitarët e dëgjuar me 19 dhjetor 2019, kishte vazhduar të dëgjohet edhe në seancën e mbajtur me 20 janar 2020.¹¹⁸

Ndërkaq, edhe në seancën e mbajtur me 21 shkurt 2020, ishte dëgjuar një dëshmitare, kurse, në seancën e 6 marsit 2020, ishin dëgjuar tre dëshmitar. Një ish-pjesëtar i sigurimit të misionit OSBE në vitin 1999, Fatmir Shala kishte deklaruar se të akuzuarin e kishte identifikuar edhe në fotografitë që ia kishin prezantuar PSRK-ja gjatë dhënies së deklaratës në prokurori, ndërsa i njëjti në gjykatë ka deklaruar se kur kishte hyrë në sallë e ka parë që Gjokiq ishte i pandehur në këtë rast, por sipas tij ndryshimi në pamje kishte qenë i madh. Po ashtu, në këtë seancë ishte dëgjuar edhe Florim Manaj, djali i të ndjerit R.M dhe Selami Taraku ish-mbikëqyrës i sigurimit të misionit të OSBE-së.

Ndryshe, gjatë kësaj seance në dëshminë e tij, djali i të ndjerit R.M kishte thënë se në vitin e kaluar dëshmitari Shaban Kaliqani kishte shkuar në lokalin ku ishte duke punuar dhe i kishte rrëfyer rastin se si kishte ndodhur vrasja e babait të tij për të cilën ka thënë se kishte qenë i akuzuari Gjokiq pjesëmarrës në vrasjen e babait të tij.

I njëjti kishte thënë se për vrasjen e babait të tij kishte dëgjuar edhe shumë më herët para se ti tregonte dëshmitari Kaliqani, mirëpo në vitin 2005 kishte ardhur trupi i babait të tij të vrarë nga Bajatnica.

Ky rast po vazhdon të gjykohet në Departamentin Special i Gjykatës Themelore në Prishtinë.

¹¹⁶ “Gjykimi për krime lufte në Pejë, dëshmitaret thonë se kishin dëgjuar se përgjegjës për vrasjen e bashkëshortëve të tyre ishte tani i akuzuari”. Betimi për Drejtësi. 4 dhjetor 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/gjykimi-per-krime-lufte-ne-peje-deshmitaret-thone-se-kishin-degjuar-se-pergjegjes-per-vrasjen-e-bashkeshortëve-te-tyre-ishte-tani-i-akuzuari/>). (Qasur së fundi me 6 gusht 2020).

¹¹⁷ “Gjykimi për krime lufte, dëshmitarët thonë se nga fotografitë kishin identifikuar Zoran Djokicin si person përgjegjës për disa vrasje”. Betimi për Drejtësi. 19 dhjetor 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/gjykimi-per-krime-lufte-deshmitaret-thone-se-nga-fotografite-kishin-identifikuar-zoran-Djokicin-si-person-pergjegjes-per-disa-vrasje/>). (Qasur së fundi me 6 gusht 2020).

¹¹⁸ “Dëshmitari thotë se persona të ndryshëm kanë marr pjesë në vrasje gjatë vitit 1999, në lagjen “Kristal” në Pejë”. Betimi për Drejtësi. 20 janar 2020. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/deshmitari-thote-se-persona-te-ndryshem-kane-marr-pjese-ne-vrasje-gjate-vitit-1999-ne-lagjen-kristal-ne-peje/>). (Qasur së fundi me 6 gusht 2020).

4. Rasti i krimeve të luftës në fshatin Nerodime e Epërme

Gjykata Themelore në Prishtinë

Numri i lëndës: PS.nr.76/19

Vepra penale: “Krime lufte kundër popullatës civile” nga neni 142 lidhur me nenin 22 të LP të RSFJ-së, të paraparë edhe me Kodin Penal të Republikës së Kosovës, “Krimet e luftës në shkelje të rëndë të nenit 3 të përbashkët të Konventave të Gjenevës” nga neni 146, paragrafi 1 dhe 2, nënparagrafi 2.1, 2.2 dhe 2.3 të KPRK-së, ndërlidhur me nenin 31 të KPRK-së, “Krime lufte kundër popullatës civile” nga neni 142 LP të RSFJ-së, aktualisht e dënueshme edhe Kodin Penal të Republikës së Kosovës nga neni 146, paragrafi 2.2 “Krimet e luftës në shkelje të rëndë të nenit 3 të përbashkët të konventave të Gjenevës”.

Kryetari i Trupit Gjykses: Musa Konxheli

Prokuror Special: Valdet Gashi

Të pandehur: Zlatan Krstiq dhe Destan Shabanaj

Faza e procedurës: Në proces

Nga ngritja e aktakuzës deri më 31 maj 2020 kanë kaluar 152 ditë apo 5 muaj

Sipas aktakuzës së përpiluar më 30 dhjetor 2019, i akuzuari Krstiq, më 26 mars 1999, rreth orës 22:00, në fshatin Nerodime e Epërme, Komuna Ferizaj, në bashkëkryerje me pjesëtarë tjerë të policisë, ushtrisë dhe paramilitarë serb, i veshur me uniformë të policisë dhe i armatosur, me vetëdije e qëllim, duke vepruar sipas planit dhe urdhrave të eprorëve të tij, ka marrë pjesë direkte në sulmin e popullsisë civile të nacionalitetit shqiptar, konkretisht familjes Nuhaj që nuk kanë marrë pjesë aktive në konflikt të armatosur.

Gjithnjë sipas aktit akuzues, i njëjti gjatë këtij aksioni në bashkëveprim me pjesëtarë të tjerë të forcave policore, ushtarake dhe paramilitare, fillimisht me mjete motorike ushtarake dhe policore, ka hyrë në oborrin e shtëpisë së Osman Nuhës, e pastaj nën krisma të armëve dhe britmave në gjuhën serbe, rrëmbyeshëm dhe me formë kanë hyrë brenda në shtëpi, ku ishin të strehuar 19 anëtarët e kësaj familje, në mesin e tyre fëmijë, gra e burra.

Pastaj, thuhet se i pandehuri në bashkëveprim me kryerës të tjerë të cilët u përkisnin forcave policore, ushtarake dhe paramilitare, ka marrë pjesë në cenimin e rëndë të personalitetit dhe dinjitetit të pjesëtarëve të kësaj familje, ngase me forcë nën kërcënimin e armëve, duke ndjellë frikë për jetën e tyre, i kanë nxjerrë dhunshëm nga shtëpia dhe duke i trajtuar në mënyrë jo humane i kanë rreshtuar në oborr para shtëpisë duke i mbajtur nën frikë dhe presion për një kohë të gjatë.

Tutje, thuhet se në vazhdim derisa personat civil të familjes Nuha, ishin të rreshtuar në oborr, në prezencën e tyre, i pandehuri në bashkëveprim me kryerës të tjerë, ka marrë pjesë në shkatërrimin e paligjshëm dhe qëllimshëm të pasurisë së kësaj familje, djegien e shtëpive, kafshëve, ushqimit e kafshëve dhe gjithë pasurinë që gjendej në oborr, pasuri kjo që nuk justifikohet me nevojën ushtarake.

Pastaj, sipas akuzës, i pandehuri në të njëjtën kohë ka marrë pjesë edhe në dëbimin e 15 anëtarëve të kësaj familje, të cilët paraprakisht ishin të rreshtuar në oborr, ku në bashkëveprim edhe me kryerës tjetër, nën kërcënimin e armëve i kanë urdhëruar të shpërngulen nga vendbanimi i tyre duke i dëbuar me forcë në drejtim të panjohur.

Tutje, thuhet se i pandehuri ka marrë pjesë në marrjen peng të katër personave të kësaj familje, i cili duke vepruar në bashkëveprim me kryerës tjerë, fillimisht i ka ndarë nga pjesëtarë tjerë të familjes, personat Osman, Bajram, Agron dhe Brahim Nuha, tani të ndjerë. Pas marrjes të tyre, thuhet se thelbësisht ka kontribuar në trajtimin mizor të tyre, duke i maltretuar, torturuar, gjymtuar dhe përfundimisht vrarë me armë zjarri, kufomat e të cilëve me qëllim të fshehjes së krimit i kanë hedhur për skaj rrugës magjistrale Prishtinë – Ferizaj, konkretisht në fshatin Babush.

Për këtë, akuzohet se në bashkëkryerje ka kryer veprën penale “krime lufte kundër popullatës civile” nga neni 142 lidhur me nenin 22 të LP të RSFJ-së, të paraparë edhe me Kodin Penal të Republikës së Kosovës, Krimet e luftës në shkelje të rëndë të nenit 3 të përbashkët të Konventave të Gjenevës nga neni 146, paragrafi 1 dhe 2 , nën paragrafi 2.1,2.2 dhe 2.3 të KPRK-së, ndërlidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Kurse, i pandehuri Destan Shabanaj, sipas aktakuzës, më 1 prill 1999, në cilësinë e inspektorit policor, i armatosur me armë automatike, me qëllim të përdhosjes, poshtërimit dhe trajtimit nënçmues të trupave të pajetë, viktimave Osman Nuha, Brahim Nuha, Agron Nuha dhe Ismet Ramadani, ka urdhëruar që trupat e tyre të varrosen pa dinjitet dhe në kundërshtim me rregullat e luftës të përcaktuara me të drejtën humanitare ndërkombëtare.

Sipas akuzës, në një njëjtën ditë, sipas urdhrit të të pandehurit dhe pjesëtarëve tjerë policorë, trupat e pajetë të viktimave të cekura si më larë, përmes personave Halim Krasniqi, Ismet Asimi dhe një personi tjetër i quajtur “Rada”, me kamionin e tipit “FAP”, me ngjyrë të verdhë janë tërhequr nga Morgu i Prishtinës, ende pa u bërë autopsia dhe janë dërguar në afërsi të varrezave të qytetit të Ferizajt të quajtura “varrezat myslimane”, ku aty ishte duke i prituri i akuzuari Shabanaj, i cili menjëherë posa kanë arritur trupat e pajetë, ka urdhëruar personin e quajtur “Maksut”, që me ekskavator të fillojë hapjen e një gropë me qëllim të hedhjes së këtyre.

Ndërkaq, më pas, akuza thotë se pas hapjes së gropës me përmasa përafërsisht 2 deri në 3 metra e gjerë dhe 70 deri në 80 cm të thellë, i pandehuri Destan Shabanaj, ka urdhëruar që trupat e të vrarëve fillimisht t’i zbresin nga kamioni, e pastaj pa u respektuar traditat dhe ritet fetare janë hedhur në mënyrë të parregullt të gjithë në të njëjtën gropë masive.

Sipas akuzës, në përfundim, i pandehuri në kundërshtim me doket, zakonet dhe rregullat fetare të të vrarëve ka urdhëruar që përmes ekskavatorit trupat e pajetë të hedhur në gropë masive të mbulohen me dhe, duke mos mbajtur asnjë shënim për identitetin e të varrosurve dhe duke mos lënë asnjë shenjë identifikuese se aty ka varrezë.

Më këtë, akuzohet se ka kryer veprat penale “krime lufte kundër popullatës civile” nga neni 142 LP të RSFJ-së, aktualisht e dënueshme edhe Kodin Penal të Republikës së Kosovës nga

neni 146, paragrafi 2.2 “ Krimet e luftës në shkelje të rëndë të nenit 3 të përbashkët të konventave të Gjenevës”.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit:

Aktvendimi për fillim të hetimeve në këtë rast ishte nxjerrë më 13 prill të vitit 2019. Kurse, akti akuzues ishte ngritur me 31 dhjetor të vitit 2019.

Më 20 janar, në kuadër të Departamentit Special në Gjykatën Themelore në Prishtinë, ishte mbajtur seanca e shqyrtimi fillestar. Në këtë seancë, pas leximit të aktit akuzues nga prokurori special Valdet Gashi, dy të akuzuarit kanë mohuar fajësinë.

Shabanaj, i cili akuzohet se me qëllim të përdhosjes, poshtëritimit dhe trajtimit nënçmues të trupave të pajetë, urdhëruar që trupat e tyre të varrosen pa dinjitet dhe në kundërshtim me rregullat e luftës, të përcaktuara me të drejtën humanitare ndërkombëtare, kishte thënë se nga 26 marsi 1999, ka filluar procedura ligjore, ku në vend të ngjarjes kanë qenë personat kompetent dhe se krejt procedura në këtë rast, sipas tij, është zhvilluar sipas ligjit.

“Nga urdhri për autopsi dhe të gjitha procedurat, kemi punuar në bazë të urdhëresës së gjyqtarit hetues dhe me atë rast unë kam proceduar një kallëzim penal dhe i kemi respektu të drejtat ligjore”, kishte deklaruar ai.

Paraprakisht, mbrojtësit e të akuzuarve kishin deklaruar se kanë pranuar të gjitha shkresat e lëndës nga ana e prokurorit Gashi. Kurse, gjykatësi i Departamentit Special, Musa Konxheli, i kishte udhëzuar mbrojtjen e të akuzuarit për të drejtën e tyre për paraqitje të kërkesës për hushje të aktakuzës e kundërshtim të provave, brenda afatit të caktuar ligjor.

Gjithashtu, ai u kishte bërë me dije se mediave gjatë kësaj seance fillestare ua ka lejuar xhirimin e gjithë seancës.

“Sot ju lejova të gjithëve pasi u lexua aktakuza, në seancën e radhës duhet me bo kërkesë me shkrim, kurse ju lejojmë me marr sekuenca të caktuara”, ka thënë ai, duke iu referuar kërkesës për të xhiruar gjithë seancën.¹¹⁹

Ndryshe, kjo gjykatë ka refuzuar kërkesat për hedhje të akuzës nga ana e mbrojtjes dhe sipas avokatit Naim Rudari nuk kanë parashtruar ankesë ndaj aktvendimit të shkallës së parë në Apel.

¹¹⁹ “Deklarohen të pafajshëm dy të akuzuarit për krime lufte në Nerodime të Epërme në Ferizaj”. Betimi për Drejtësi. 20 janar 2020. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/deklarohen-te-pafajshem-dy-te-akuzuarit-per-krime-lufte-ne-nerodime-te-eperme-ne-ferizaj/>). (Qasur së fundi me 6 gusht 2020).

5. Rasti i krimeve të luftës në fshatin Krushë të Vogël

Gjykata Themelore në Prizren

Numri i lëndës: P.nr.35/18

Vepra penale: “Krimet e luftës në shkelje të rëndë të nenit 3 të Konventave të Gjenevës”

Kryetari i Trupit Gjykses: Artan Sejrani

Prokuror: Paul Flynn, Drew Engel, Drita Hajdari

I pandehur: Darko Tasiq

Faza e procedurës: Në proces

Nga ngritja e aktakuzës deri më 31 maj 2020 kanë kaluar 766 ditë apo 2 vite, 1 muaj e 5 ditë

Sipas aktakuzës, Tasiq akuzohet se fillimisht gjatë periudhës 15 – 26 mars 1999, ka marrë pjesë së bashku me forcat policore dhe para ushtarake serbe, për të plaçkitur dhe shkatërruar pasuritë e popullsisë civile, duke djegur shtëpi, duke marrë automjetet bujqësore dhe sendet tjera me vlerë të fshatarëve në përgjithësi dhe familjes Hajdari në veçanti.

Aktakuza e PSRK-së e ngarkon të akuzuarin Tasiq edhe me përdhosjen e trupave të pajetë, duke i djegur kufomat së bashku me forcat tjera policore dhe paramilitare dhe duke i hedhur kufomat në lumin Drin, në një vend jashtë fshatit Krushë e Vogël.

Sipas aktakuzës, i akuzuari me veprimet e tij ka kryer sulm mizor kundër dinjitetit njerëzor dhe kërkohet që i njëjti të dënohet sipas ligjit aktual me jo më pak se 5 vjet burgim ose me burgim afatgjatë ose sipas ligjit të mëhershëm, me jo më pak se 5 vjet ose deri në 20 vjet burgim efektiv.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit:

Më 31 maj të vitit 2012 është nxjerrë aktvendimi për fillim të hetimeve në këtë rast. Hetimet kishin filluar ndaj një numri të madh të dyshuarve lidhur me krimet që kishin ndodhur gjatë luftës në Kosovë në Krushë të Vogël dhe ishin ndërprerë në disa raste për shkak të mungesës së dyshuarve e më pas ishin rihapur sërish. Hetimet ishin ndërprerë për disa persona të dyshuar pas sigurimit të provave lidhur me ta, kishin filluar kundër personave të ri.

Gjatë vitit 2016, ishte lëshuar fletë arrest kundër 27 të dyshuarve. Tasiq, me vendbanim të përhershëm në Mal të Zi, ishte arrestuar nga ana e Policisë së Kosovës më 23 nëntor vitit 2017 në pikë kalimin kufitar në Bërnjak. Të njëjtit, Gjykata Themelore në Prizren, duke vendosur sipas kërkesës së Prokurorisë Speciale dhe pas mbajtjes së seancës së dëgjimit në prezencën e prokurorit special, Paul Flynn, më 22 nëntor, i kishte caktuar masën e paraburgimit prej një muaji.

Më pas, Gjykata e Apelit e Kosovës, e kishte refuzuar si të pa bazuar ankesën e të pandehurit Darko Tasiq, kundër aktvendimit mbi caktimin e masës së paraburgimit prej 30 ditësh, të nxjerrë nga Gjykata Themelore në Prizren, më 23 nëntor 2017. Gjykata e Apelit, kishte vlerësuar se meqenëse ekziston dyshimi i bazuar se i pandehuri ka kryer veprat penale në fjalë, ka bazë ligjore për caktimin e paraburgimit ndaj tij, konform dispozitave të Kodit të Procedurës

Penale.¹²⁰ Më 26 prill 2018, ishte përpiluar aktakuza nga ana e prokurorit të EULEX-it, Paul Flynn. Pas përfundimit të mandatit të EULEX-it, kjo aktakuzë është përfaqësuar nga ana e prokurores së PSRK-së, Drita Hajdari.

Më 14 maj të vitit 2018, ishte mbajtur shqyrtimi fillestar në këtë rast, ku pas leximit të aktit akuzues nga prokurori Drew Engel, i akuzuari ishte deklaruar i pafajshëm. Pas deklarimit të të akuzuarit, kryetari i trupit gjykues, Artan Sejrani, kishte shpallur të përfunduar shqyrtimin fillestar në këtë rast penal, ndërsa shqyrtimin e dytë e kishte caktuar për 14 qershor 2018.¹²¹

Më pas, gjykata e shkallës së parë kishte refuzuar kërkesën e mbrojtjes për hedhje të akuzës. Kurse, ndaj këtij vendimi ishte ushtruar ankesë në Gjykatë të Apelit, mirëpo edhe kjo e fundit kishte refuzuar ankesën. Gjykata e Apelit e Kosovës, kishte vlerësuar se gjykata e shkallës së parë, ka vepruar drejtë kur ka refuzuar kërkesën për hedhjen e aktakuzës si të pabazuar, në bazë të nenit 249 paragrafi 3 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, meqenëse nuk paraqiten asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 250 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4 të këtij kodi. Po ashtu Gjykata e Apelit, e kishte refuzuar si të pa bazuar ankesën e të pandehurit kundër aktvendimit mbi vazhdimin e masës së paraburgimit për dy muaj, të datës 26 qershor 2018.¹²² Shqyrtimi kryesor në këtë rast kishte filluar me 13 shtator të vitit 2018, që nga atëherë janë mbajtur një numër i madh seancash e janë dëgjuar shumë dëshmitarë.

Më 19 shkurt 2019, ishte mbajtur seanca e radhës, e cila ishte monitoruar nga IKD dhe “Betimi për Drejtësi”. Gjatë kësaj seance, në gjykatore ishte dëgjuar dëshmitari Gani Zylfiu, i cili ka deklaruar se tani të akuzuarin për krime lufte, Darko Tasiq, gjatë vitit 1999, e kishte parë me uniformë policore. Për më tepër, ai kishte thënë se tani më i akuzuari Darko Tasiq, në atë kohë lëvizte me makinën e tij policore të cilën e kishte personale. Në një moment gjatë rrëfimeve të tij rreth ngjarjeve të zhvilluara në fshat, dëshmitari Zylfiu, tha se nga disa bashkëfshatarë të tij, e ka kuptuar se i është vrarë babai bashkë me dy vëllezërit. Rreth mënyrës se si janë vrarë ata, dëshmitari Zylfiu, tha se sipas rrëfimeve të Agim Asllanit dhe Lutfi Ramadanit, ka dëgjuar se viktimat janë vrarë në një shtëpi të pabanuar, e më pas duke ua futur zjarrin. Duke u përgjigjur prokurores speciale, Drita Hajdari, rreth një kamioni i cili ndizej në Dri, dëshmitari tha se për këtë ka dëgjuar pasi që kanë dalë nga territori i Kosovës.

"Deri sa kam qenë në territorin e Kosovës nuk e kam ditur për atë kamion, por pasi që kemi dalur në Shqipëri, kam kuptuar se një kamion ngjyrë portokalli ka ardhur në fshatin Krushë e Madhe, i ngarkuar me trupa të njerëzve me jetë dhe pa jetë, i cili është afuar afër Drinit Lumbardh, i cili në pamundësi të praptohet, ka qenë 50% brenda në ujë e 50% jashtë", kishte thënë dëshmitari Zylfiu. Më pas, duke u përgjigjur në pyetjen e prokurores speciale, lidhur me

¹²⁰ “Gjykata e Apelit e lë në paraburgim të dyshuarin për krime lufte”. Betimi për Drejtësi. 13 dhjetor 2017. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/gjykata-e-apelit-e-le-ne-paraburgim-te-dyshuarin-per-krime-lufte/>). (Qasur së fundi me 6 gusht 2020).

¹²¹ “Deklarohet i pafajshëm serbi i akuzuar për krime lufte në fshatin Krushë e Vogël”. Betimi për Drejtësi. 14 maj 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/deklarohet-i-pafajshem-serbi-i-akuzuar-per-krime-lufte-ne-fshatin-krushe-e-vogel/>). (Qasur së fundi me 6 gusht 2020).

¹²² “Apeli konfirmon aktakuzën ndaj të akuzuarit për krime lufte, Darko Tasiq”. Betimi për Drejtësi. 16 korrik 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-konfirmon-aktakuzen-ndaj-te-akuzuarit-per-krime-lufte-darko-tasiq/>). (Qasur së fundi me 6 gusht 2020).

viktimat në fshatin Krushë e Vogël, kishte thënë se aty janë 113 të vrarë, prej moshës 13 vjeç e më të shtyrë, siç tha ai, janë edhe 63 persona të pagjetur.

Në një moment, dëshmitari Zylfiu, është ballafaquar me deklaratat kundërthënëse nga mbrojtësi i të akuzuarit Tasiq, avokati Dejan Vasiq. "Ju në deklaratën e vitit 2012, lidhur me ngjarjet e zhvilluara, nuk e keni përmendur të akuzuarin Darko Tasiq", shtoi avokati i të akuzuarit. Lidhur me këtë, dëshmitari Zylfiu, ka thënë se disa herë e ka parë të akuzuarin Tasiq, deri sa i ka marrë makinat e fshatarëve në Krushë të Vogël, mirëpo ditën e dhënies së asaj deklarate ka pasur aq shumë emocione sikur ditën që ka ndodhur masakra.

Ndërsa, në seancën e mbajtur me 4 prill 2019, janë dëgjuar si dëshmitarë, Bedri Limani dhe Fehim Ismajli, që kanë dëshmuar në cilësinë e policëve hetues të cilët janë marrë me rastin e të akuzuarit. Limani kishte deklaruar se në bazë të autorizimeve të prokurorit Flynn kanë qenë të autorizuar të dalin në vendin e ngjarjes, të mbledhin informacione e kontaktojnë me dëshmitarët okularë rreth kamionetës që është hedhur në breg Dri. Ai kishte thënë se kanë mbledhur informata për dëshmitarë të mundshëm dhe kanë biseduar me tre dëshmitarë për rastin se çka ka ndodhur në kamionete. Si dhe kishte thënë se kanë bërë raport nga vendi i ngjarjes, skica, fotografi nga vendi përkatës. Kurse, dëshmitari Ismajli kishte deklaruar se në bazë të dëshmitarëve të dëgjuar, e kanë identifikuar vendin se ku ka qenë i zbarkuar automjeti, i cili sipas dëshmitarëve që i kanë dëgjuar, brenda të njëjtit kishte pasur kufoma. Ai kishte thënë se rreshteri Bedri Limani, e ka përpiluar raportin e hetimeve, kurse ai i ka bërë dy raporte, njërin nga vendi i ngjarjes, dhe tjetrin siç tha ai, për vendin ku janë zbarkuar kufomat.

Gjatë vitit 2019, vazhdimisht ishte tentuar që të sigurohet dëshmitari nga Britania e Madhe, John Sweeney, lidhur me dokumentarin "Serb genocide against Albanians". Me qëllim të sigurimit të prezencës së tij, ishin shtyrë disa seanca, ndërsa në vitin 2020, konkretisht në muajin shkurt, ky dëshmitar kishte dhënë dëshminë e tij në gjykatore. Më 24 mars 2020, Gjykata e Apelit e kishte refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtjes së të akuzuarit Darko Tasiq, ndaj aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren, e cila ia kishte vazhduar të njëjtit paraburgimin edhe për dy muaj.¹²³ Më 22 qershor 2020, i akuzuari për krime lufte, Darko Tasiq është shpallur fajtor nga Gjykata Themelore në Prizren dhe ndaj tij është shqiptuar dënimi unik prej 22 vite burgim.¹²⁴

¹²³ "Apeli lë në paraburgim të akuzuarin për krime lufte ndaj popullatës civile, Darko Tasiq". Betimi për Drejtësi. 31 mars 2020 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-le-ne-paraburgim-te-akuzuarin-per-krime-lufte-ndaj-popullates-civile-darko-tasiq/>). (Qasur së fundi me 6 gusht 2020).

¹²⁴ "22 vite burgim për të akuzuarin për krime lufte në Krushë të Vogël", Betimi për Drejtësi, 22 qershor 2020 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/22-vite-burgim-per-te-akuzuarin-per-krime-lufte-ne-krushe-te-vogel/>). (Qasur së fundi me 6 gusht 2020).

6. Rasti Remzi Shala

Gjykata Themelore në Prizren

Numri i lëndës: P.nr.181/16

Vepra penale: “Krimet e luftës në shkelje të rëndë të nenit 3 të Konventave të Gjenevës”

Kryetari i Trupit Gjykses: Raime Elezi

Prokuror: Haki Geci

I pandehur: Remzi Shala

Faza e procedurës: Në proces pas kthimit në rivendosje nga Gjykata Supreme

Nga ngritja e aktakuzës deri në me 31 maj 2020 kanë kaluar 1129 ditë apo 3 vite, 7 muaj e 11 ditë

Remzi Shala akuzohet nga Prokuroria Speciale se gjatë kohës së luftës në Kosovë, më 26 qershor 1998, duke vepruar si pjesëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), së bashku edhe me disa pjesëtarë tjerë të paidentifikuar, kanë marrë nga shtëpia e tij, viktimën Haxhi Përteshi.

Sipas aktakuzës, Remzi Shala, i cili ishte i vetmi pa maskë në kokë, së bashku edhe me 5-6 pjesëtarë tjerë të UÇK-së, të maskuar, nën dyshimin se i ndjeri ishte bashkëpunëtor i forcave serbe, kanë shkuar në fshatin Duhël dhe të njëjtin e kanë dërguar në një vend të panjohur.

Në aktakuzë, thuhet se djali i viktimës, Agron Përteshi, i kishte parë ata të largoheshin, së bashku me babin e tij, në drejtim të fshatit Grajqevc dhe pas disa dite trupi i pajetë i të ndjerit ishte gjetur në afërsi të rrugës afër qendrës së fshatit Duhël.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit:

Kallëzimi penal në këtë rast ishte parashtruar më 7 mars të vitit 2003 nga ana e të dëmtuarit tek hetuesit në Policinë e UNMIK-ut. Hetimet kishin vazhduar nga EULEX-i. Më 24 prill të vitit 2014, organi i ndjekjes kishte nxjerrë aktvendimin për fillim të hetimeve. Më pas ky rast i ishte dorëzuar prokurorëve vendas në PSRK. Hetimet kishin rezultuar me përpilim të akuzës më 19 tetor të vitit 2016 dhe me ngritje të saj në gjykatë më 20 tetor të po këtij viti. I dyshuar kishte qenë edhe një person tjetër, mirëpo në mungesë të provave hetimet ndaj tij ishin ndërprerë.

Më 7 dhjetor të vitit 2016, 48 ditë pas ngritjes së aktit akuzues ishte mbajtur shqyrtimi fillestar në këtë rast, edhe pse sipas nenit 242 par. 4 të KPPK-së ishte dashur të mbahej brenda tridhjetë (30) ditëve pas ngritjes së aktakuzës.

Ndërkaq, me 6 mars të këtij viti ishte mbajtur shqyrtimi i dytë. Pas shqyrtimit të dytë, gjykata kishte konfirmuar aktin akuzues. Këtë vendim të gjykatës e kishte atakuar mbrojtësi i të akuzuarit, mirëpo e njëjta ishte refuzuar nga Gjykata e Apelit dhe në këtë formë ishte konfirmuar vendimi i gjykatës së shkallës së parë.

Në këtë rast janë mbajtur mbi 30 seanca gjyqësore e janë dëgjuar një numër i madh dëshmitarësh.

Seanca e paraparë të mbahej me 10 gusht nuk ishte mbajtur, për shkak të mungesës së mbrojtësit të akuzuarit, i cili kishte pasur rast vdekje. I akuzuari, Remzi Shala, nuk kishte pranuar që atij t'i caktohet një avokat tjetër zëvendësues me arsye se i njëjti nuk është i njohur

me rastin penal dhe provat e prokurorisë, andaj ka kërkuar që seanca të shtyhet për një datë tjetër dhe me këtë propozim ishin pajtuar edhe prokurori edhe avokati i palës së dëmtuar.¹²⁵

Më 22 shtator të vitit 2017, kishte filluar të dëgjohet një dëshmitar, mirëpo seanca ishte ndërprerë pasi avokati Asdren Hoxha që përfaqësonte palën e dëmtuar kishte kërkuar që seanca të ndërpritej sepse duhej ta përfaqësonte një rast në Gjykatën Themelore në Prishtinë dhe se rasti kishte të bënte me caktimin e masës së paraburgimit, e për të cilin veprim ka afat ligjor. Trupi gjykues, i kryesuar nga gjyqtarja Raime Elezi, kishte pranuar kërkesën e avokatit Hoxha dhe shqyrtimin e kishte shtyrë për 25, 26 dhe 27 tetor 2017, duke filluar nga ora 09:00, në të cilat seanca do të vazhdonte dëshminë Zejnulla Qatani dhe do të dëgjoheshin dëshmitarët tjerë të propozuar nga organi i akuzës. Me këtë vendim nuk ishin ndarë të kënaqur as pala e dëmtuar Agron Përteshi, djali i viktimës, Haxhi Përteshi, e po ashtu ka shprehur pakënaqësi edhe i akuzuari Shala, i cili kishte thënë se rasti po zgjatet shumë.¹²⁶ Më 26 tetor të vitit 2017, kishte vazhduar shqyrtimi ku ishte dëgjuar një dëshmitar.

Më 23 nëntor të vitit 2017, në gjykatore ishte dëgjuar Jetulla Qari, i njohur në kohën e luftës si komandant “Guri”. Ky dëshmitar, gjatë dëshmisë së tij, kishte thënë se viktimën Haxhi Përteshi e kanë vrarë forcat serbe e jo i akuzuari Shala, siç pretendon organi i akuzës.

Nga kjo deklaratë kishin reaguuar fëmijët e të ndjerit, të cilët ishin prezentë në seancë, të cilët kanë thënë se nëse babanë e tyre e kanë vrarë forcat serbe, atëherë i akuzuari ua ka dërguar forcave serbe, pasi që atë e ka marrë nga shtëpia e tyre, i akuzuari Shala. I dëmtuari, Agron Përteshi, i ishte drejtuar të akuzuarit me fjalët se ai ka qenë prezent kur ia ka marrë babanë, andaj i ka bërë thirrje që të tregojë se ku e ka dërguar. “Mos merr përgjegjësi që nuk të takojnë, trego me urdhër të kujt e ke marrë babën dhe kujt i’a ke dorëzuar”, kishte thënë Përteshi. Më pas, me ndërhyrjen e kryetares së trupit gjykues, Raime Elezi, mbrojtësit të të akuzuarit, avokatit Natal Bullakaj dhe policëve që ishin prezentë në seancë, situata ishte qetësuar dhe shqyrtimi kishte vazhduar.

Dëshmitari, ishte pyetur nga i dëmtuari Zenel Përteshi, se nëse babai i tij është vrarë nga forcat serbe, pse nuk është shënuar si martir i luftës si krejt të vrarët tjerë. Dëshmitari Qari ishte përgjigjur se nuk ka njohuri, pasi sipas tij, kjo ka qenë detyrë e Këshillit Organizativ të fshatit Duhël, të cilët kanë mbajtur evidencë për civilët e vrarë gjatë luftës.¹²⁷

Më 25 janar 2018, në gjykatore, dëshmitari Xhemajl Elshani, kishte deklaruar se ishte keqtrajtuar nga ana e të akuzuarit gjatë luftës.

¹²⁵ “Shtyhet gjykimi për krime lufte pasi mungon mbrojtësi i të akuzuarit”. Betimi për Drejtësi. 10 gusht 2017. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/shtyhet-gjykimi-per-krime-lufte-pasi-mungon-mbrojtesi-i-te-akuzuarit/>). (Qasur së fundi me 6 gusht 2020).

¹²⁶ “Dëshmitari thotë se të akuzuarin për krime lufte nuk e ka njohur më parë”. Betimi për Drejtësi. 22 shtator 2017. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/deshmitari-thote-se-te-akuzuarin-per-krime-lufte-nuk-e-ka-njohur-me-pare/>). (Qasur së fundi me 6 gusht 2020).

¹²⁷ “Familjarët s’pajtohen me dëshminë e ish-komandant “Guri” se Haxhi Përteshi u vra nga forcat serbe”. Betimi për Drejtësi. 23 nëntor 2017. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/familjaret-spajtohen-me-deshmine-e-ish-komandant-guri-se-haxhi-perteshi-u-vra-nga-forcat-serbe/>). (Qasur së fundi me 6 gusht 2020).

Dëshmitari kishte treguar se në qershor 1998 është mbajtur një mbledhje në fshatin Duhël në të cilën ka marrë pjesë edhe i akuzuari Shala. Ai ka thënë se atë ditë, prej mbledhjes e kanë marrë i akuzuari Remzi Shala, Fehrat Shala dhe një ushtar me emrin Xhemë dhe e kanë dërguar në fshatin Grejçevc ku ishte shtabi i UÇK-së dhe krejt kjo, sipas tij, është nxitur nga Bajram dhe Sherif Qatani. Ai kishte thënë se kur kishin arritur në dalje të fshatit Duhel, Xhema ia kishte lidhur duart ndërsa i akuzuari Remzi Shala ia kishte mbyllur sytë me shami, por ai ka thënë se e kishte kuptuar se po e dërgojnë në fshatin Grejçevc. Sipas dëshmitarit, kur kishin mbërritur në oborrin e shtabit në Grejçevc, atë e kishin rrëzuar në gjunjë dhe sipas tij, i akuzuari e kishte goditur me kondak të Kallashnikovit në nofull prej të cilës goditje dëshmitari e kishte humbur vetëdijen për disa minuta. Ai kishte thënë se para se ta godiste, i akuzuari e kishte pyetur se kush po ia paguan rrymën dhe se kënd ka dashur dëshmitari ta vrasë nga ushtarët e UÇK-së, ndërsa pasi i ishte kthyer vetëdija e ka parë veten në një bunker të hapur nga Serbët para se të fillonte lufta. Tutje dëshmitari ka treguar se i akuzuari dhe Fehrat Shala e kishin larguar nga bunkeri dhe e kishin dërguar në fshatin Luzhnicë ku e kishin vendosur për 6 ditë në një ahur të lopëve që kishte bajga deri në gjunjë. Ai ka thënë se po ashtu gjatë asaj kohe ka takuar një person tjetër aty me të cilin ushtarët e kishin detyruar të rreheshin me shkelma pasi që sytë dhe duart i kanë pasur të lidhura, ndërsa për vrasjen e Haxhi Përteshit ka thënë se ka kuptuar pasi është liruar dhe ka shkuar në shtëpi.¹²⁸

Në seancën e mbajtur me 5 mars 2018, ishin dëgjuar dy dëshmitarë. Dëshmitari Mustafë Përteshi, kishte deklaruar se kur ka marrë vesh se është vrarë Haxhi Përteshi, së bashku me vëllezërit e tij, kanë vendosur ta varrosin kufomën, por janë paralajmëruar nga banorët e fshatit që mos ta bëjnë një gjë të tillë.

Ky dëshmitar, kishte thënë se gjatë rrugës për të marrë trupin e të afërmit, ka takuar një bashkëfshatar i cili, sipas tij, i ka thënë se ‘komandant Guri ka thënë se kush e varros kufomën e Haxhi Përteshit, do ta gjejë e njëjta gjë edhe atë’.

Sipas këtij dëshmitari, Haxhi Përteshin, pasi që e kanë vrarë për inate personale ia kanë veshur akuzat për spiunazh, kinse ai ka bashkëpunuar me forcat serbe dhe i ka furnizuar ata me femra shqiptare, vetëm për të arsyetuar vrasjen e tij.

Në këtë seancë, kishte filluar dëshminë edhe dëshmitari Xhafer Shukolli, i cili kishte thënë se nuk e din kush e ka vrarë të ndjerin Haxhi Përteshi, duke thënë se një lajm të tillë e ka marrë nga xhaxhai i tij.¹²⁹ Ky dëshmitar kishte vazhduar të jap dëshminë edhe me 6 mars, ku kishte thënë se gjatë luftës, në popull dhe në mesin e ushtarëve, është biseduar se i ndjeri Haxhi Përteshi, u ka prirë forcave serbe deri në bazën e UÇK-së, në fshatin Grejçevc të Suharekës. Të dëmtuarit Agron dhe Zenel Përteshi, e kishin pyetur dëshmitarin nëse i kujtohej se janë takuar disa herë pas luftës për të biseduar rreth rastit dhe nëse i kujtohej dëshmitarit se kur

¹²⁸“Dëshmitari thotë se është keqtrajtuar nga i akuzuari për krime lufte”. Betimi për Drejtësi. 25 janar 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/deshmitari-thote-se-eshte-keqtrajtuar-nga-i-akuzuari-per-krime-lufte/>). (Qasur së fundi me 6 gusht 2020).

¹²⁹“Dëshmitari thotë se janë kërcënuar që të mos e varrosin të vrasin gjatë luftës”. Betimi për Drejtësi. 5 mars 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/deshmitari-thote-se-jane-kercenuar-qe-te-mos-e-varrosin-te-vrasin-gjate-luftes/>). (Qasur së fundi me 6 gusht 2020).

kishte filluar gjykimi ndaj Shalës, ai u kishte thënë se e kanë zënë njeriun e duhur dhe mos ta lëshojnë. Dëshmitari i kishte mohuar në tërësi këto deklaramë të të dëmtuarve, duke thënë se ai nuk ka asnjë informacion se kush ua ka marrë babanë e të dëmtuarve dhe se kush e ka vranë.¹³⁰ Më 20 qershor 2018, gjykimi nuk ishte mbajtur për shkak të mungesës së akuzuarit.

E në seancën e mbajtur më 28 shtator, i akuzuari kishte thënë se “Prokuroria që po më akuzon për këtë vepër, e njëjta më ka shpallur edhe veteran të rrejtshëm. Nuk e di se çfarë është duke ndodhur me këtë drejtësi në këtë vend, ku gjërat nuk janë të koordinuara ashtu siç duhet”. Gjatë kësaj seance, ishin dëgjuar dy dëshmitarë.¹³¹

Në seancën e mbajtur më 9 janar 2019, i akuzuari kishte munguar. Mbrojtësi i të akuzuarit, avokati Natal Bullakaj, kishte thënë se që nga momenti që i është dorëzuar ftesa nga Gjykata Speciale të akuzuarit Shala, ai nuk ka pasur më kontakt me klientin e tij, Bullakaj kishte thënë se që nga ky moment e revokon autorizimin ndaj të akuzuarit Remzi Shala, për shkak të arsyeve jo korrekte të tij, të cilat sipas avokatit Bullakaj, e pengojnë rrjedhën e gjykimit në vazhdim.¹³²

Ndryshe, ky i akuzuar ishte arratisur pasi kishte marrë ftesë për tu paraqitur për intervistim në Hagë nga Prokurori i Specializuar, ai kishte thënë se nuk e njeh institucionin e Gjykatës Speciale dhe nuk do të paraqitet vullnetarisht për intervistim.

Më pas, ai ishte arrestuar në shtëpinë e tij dhe të njëjtit i ishte caktuar masa e paraburgimit në afat prej 30 ditësh. Avokati i tij kishte bërë të ditur se Shala është arrestuar me urdhër të Gjykatës Themelore të Prizrenit, nën akuzën për krime lufte ndaj popullsisë civile, rast ky i cili ishte në procedurë.¹³³

Ndryshe, Gjykata Themelore në Prizren, Departamenti për Krime të Rënda më 8 korrik 2019, kishte marrë aktgjykim me të cilin të akuzuarin Shala e kishte shpallur fajtor për veprën penale krime lufte kundër popullatës civile duke e dënuar me 14 vite burg.

Më 26 nëntor 2019, në Gjykatën e Apelit, ai kishte kërkuar që të lirohet apo që të rigjykohej. Kurse, përfaqësuesi i familjes së të dëmtuarve, avokati Hoxha, kishte ushtruar ankesë kundër aktgjykimit të shkallës së parë sa i përket lartësisë së dënimit, me pretendimin se dënimi i shqiptuar është shumë i ulët në raport me peshën e veprës penale.¹³⁴

¹³⁰ “Dëshmitari thotë se ka pasur zëra se i vrari gjatë luftës ka bashkëpunuar me forcat serbe”. Betimi për Drejtësi. 6 mars 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/deshmitari-thote-se-ka-pasur-zera-se-i-vrari-gjate-luftes-ka-bashkepunuar-me-forcat-serbe/>). (Qasur së fundi me 6 gusht 2020).

¹³¹ “I akuzuari: Kjo prokurori që po më akuzon për krime lufte, më ka shpallur veteran të rrejtshëm”. 28 shtator 2018. Betimi për Drejtësi. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/i-akuzuari-kjo-prokurori-qe-po-me-akuzon-per-krime-lufte-me-ka-shpallur-veteran-te-rrejtshem/>). (Qasur së fundi me 6 gusht 2020).

¹³² “I akuzuari për krime lufte Remzi Shala s’i përgjigjet ftesës së gjykatës, dështon seanca ndaj tij”. 9 janar 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/i-akuzuari-per-krime-lufte-remzi-shala-si-pergjigjet-fteses-se-gjykates-deshton-seanca-ndaj-tij/>). (Qasur së fundi me 6 gusht 2020).

¹³³ “Ish-ushtarit të UÇK-së, Remzi Shalës, i caktohet masa e paraburgimit prej 30 ditëve”. Koha.net. 24 maj 2019. (Shih linkun <https://www.koha.net/kronike/164827/ish-ushtarit-te-uck-se-remzi-shales-i-caktohet-masa-e-paraburgimit-prej-30-diteve/>). (Qasur së fundi me 6 gusht 2020).

¹³⁴ “I dënuari me 14 vjet për krime lufte kërkon nga Apeli lirim ose rigjykim, të dëmtuarit kërkojnë dënim më të ashpër”. Betimi për Drejtësi. 26 nëntor 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/i-denuari-me-14-vjet-per-ashper/>).

Ndërkaq, Gjykata e Apelit ia ka zbutur dënimin ish-komandantit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), i njohur si komandant “Molla e Kuqe”, Remzi Shala.

Për këtë kishte njoftuar gjykata e shkallës së dytë, nëpërmjet një komunikate për media.

“Departamenti Special i Gjykatës së Apelit, më aprovimin e pjesshëm të ankesës së avokatit mbrojtës, por edhe sipas detyrës zyrtare, e ka ndryshuar aktgjykimin e Gjykatë Themelore në Prizren, të datës 03.07.2019, në rastin e të akuzuarit për krime lufte R.Sh. Kështu, nga 14 vjet burgim sa ishte gjykuar, nga ana gjykatës së shkallës së parë, të akuzuarit i është zbutur dënimi në 10 vjet burgim”, thuhet në njoftimin e Apelit.

“Gjykata e Apelit gjeti se në veprimet e të akuzuarit manifestohen vetëm elementet e veprës penale “*Krimet e luftës kundër popullsisë civile*” nga neni 142 lidhur me nenin 22 të Ligjit Penal Jugosllav, lidhur me nenin 3 (1.a) të Konventës së IV të Gjenevës, por jo edhe elementet e veprës penale nga neni 152 par. 1 dhe 2 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Sipas kolegjit të Apelit, vepra penale nuk mund të kualifikohet me dy ligje, pra edhe me ligjin penal të Jugosllavisë të vitit 1977 edhe me Kodin Penal të Republikës së Kosovës në fuqi nga viti 2013. Në rastin konkret aplikohet Ligji Penal Jugosllav, në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale, si ligj më i favorshëm për të pandehurin, sepse dënimi maksimal që parashihej me këtë ligj ishte 15 vite burgim, apo në rrethanat më të rënda, 20 vite burgim”, thuhet tutje në njoftim.

Sipas njoftimit, arsyet që e ka shtyrë kolegjin e Apelit për të zbutur dënimin, është fakti se i akuzuari është akuzuar dhe shpallur fajtor për marrjen peng të viktimës H.P., por jo për vrasjen e tij. “Në këtë drejtim gjykata e shkallës së parë ka mbivlerësuar rrethanat rënduese për të akuzuarin që kanë ndikuar në lartësinë e dënimit”, thuhet në njoftim.¹³⁵

Kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatë Supreme kishte parashtruar mbrojtësi i të akuzuarit, avokati Natal Bullakaj. Ndërsa, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit të Kosovës, kishte propozuar që kërkesa e mbrojtësit të të dënuarit të refuzohet si e pabazuar.

Në vendim të Supremes të siguruar nga “Betimi për Drejtësi” thuhet se kjo gjykatë ka gjetur se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e bazuar.

“Gjykata Supreme e Kosovës, konstaton se janë të bazuara pretendimet të paraqitura nga mbrojtësi i të dënuarit se aktgjyrimi i shkallës së parë përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale për faktin se, aktgjyrimi i gjykatës së shkallës së parë nuk përmban arsyetim lidhur me ekzistimin e veprës penale dhe përgjegjësisë penale të të dënuarit. Për më tepër, shkeljet e theksuara më lartë nuk janë eliminuar me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë i cili gjithashtu është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale

[krime-lufte-kerkon-nga-apeli-lirim-ose-rigjykim-te-demtuarit-kerkojne-denim-me-te-ashper/](#)). (Qasur së fundi me 6 gusht 2020).

¹³⁵ “Ishte dënuar me 14 vjet burg për krime lufte, ish-komandantit “Molla e Kuqe” i zbutet dënimi”. Betimi për Drejtësi. 26 dhjetor 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ishte-denuar-me-14-vjet-burg-per-krime-lufte-ish-komandantit-molla-e-kuqe-i-zbutet-denimi/>). (Qasur së fundi me 6 gusht 2020).

nga neni 384 par.1 nënpar.12 lidhur me nenin 370 par.7 të KPPK-së”, thuhet në vendim të Supremes.

Tutje, thuhet se bazuar në arsyetimin e gjykatës së shkallës së parë del se janë të bazuara pretendimet e paraqitura në kërkesë se nuk janë dhënë arsye përkitazi me ekzistimin e veprës penale dhe përgjegjësisë penale të të dënuarit dhe posaçërisht fakti i veprimit të të dënuarit dhe se veprimi i tij a kishte të bënte me dhënien e urdhrin apo kishte zbatuar ndonjë urdhër që ndaj popullatës civile të veprohej në kundërshtim me dispozitën e nenit 142 të ish LPJ-së, përkatësisht marrjen peng të civilëve.

“Gjykata e shkallës së parë nuk ka arsyetuar se si janë manifestuar elementet e veprës penale siç është përcaktuar me dispozitën e nenit 142 të ish LPJ-së “Kush duke shkelur rregullat e së drejtës ndërkombëtare gjatë kohës së luftës, të konfliktit të armatosur ose okupacionit urdhëron që kundër popullatës civile të bëhen vrasje, tortura,... marrje peng e njerëzve..., ose kush kryen ndonjë nga veprat e lartpërmendura””, thuhet në vendim.

Tutje, thuhet se gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e saj nuk ka dhënë arsyetim përkitazi me pozitën e të dënuarit se i njëjti a ka pasur ndonjë pozitë në hierarkinë ushtarake në vendin dhe kohën kur ka vepruar dhe më konkretisht rolin e tij në ditën kritike edhe pse nuk ishte kontestues rrethana se i njëjti ishte pjesëtar i UÇK-së.

“Megjithatë, për tu realizuar figura e veprës penale për të cilën është shpallur fajtor është e domosdoshme që të plotësohen dy kushte dhe atë: së pari do të duhej qartazi të definohej se kryerësi të jetë personi i cili kishte dhënë urdhër që nënkupton një pozitë më të lartë të tij në raport me personat që zbatojnë urdhrin, përkatësisht do të duhej të definohej saktësisht urdhërdhënësi për të vepruar kundër popullatës civile më konkretisht ndaj të dëmtuarit, apo që i dënuari të ketë zbatuar një urdhër të marrë nga eprorët e tij”, thuhet në vendimin e Supremes.

Në vijim, thuhet se në rastin konkret këto dy elemente qenësore të kësaj veprë penale kanë mbetur të papërcaktuara dhe kjo është në disharmoni edhe me dispozitivin e aktgjyimit të gjykatës së shkallës së parë meqë nuk janë përshkruar aspektet e veprimit të të dënuarit dhe me këtë kanë mbetur të papërcaktuara elementet esenciale të veprës penale për të cilin i dënuari është shpallur fajtor.

“Bazuar në dispozitivin e aktgjyimit të gjykatës së shkallës së parë fakti se në ngjarjen kritike përveç të dënuarit ishin edhe 5-6 pjesëtarë të tjerë të UÇK-së të paidentifikuar nuk e bën të dënuarin në asnjë rrethanë apriori si udhëheqës të këtij grupi dhe aq më tepër person që kishte dhënë urdhra personave të tjerë, siç konkludohet nga aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe i aprovuar nga ana e gjykatës së shkallës së dytë”, thuhet në vendim.

Tutje, Gjykata Supreme e Kosovës, ka vlerësuar se arsyetimi i aktgjyimit të gjykatës së shkallës së parë është kundërtë në vetveten.

“Meqë përderisa në faqen 30 të aktgjyimit theksohet se: “Mënyra e kryerjes së veprës penale krime lufte përbëhet në dhënien e urdhrave për zbatimin e veprimeve të ndaluara ose në kryerjen e veprimeve të tilla”, megjithatë në asnjë pasus të aktgjyimit të saj nuk e vlerëson

dhe nuk e zgjidh dilemën se a janë vërtetuar këto elemente edhe vet të cituara nga kjo gjykatë dhe nga kjo del se arsyetimi i tillë ishte në disharmoni të plotë me dispozitivin e aktgjyimit të gjykatës së shkallës së parë përkitazi me ekzistimin e veprës penale dhe përgjegjësisë penale të të dënuarit. Në rastin konkret duke u bazuar në dispozitivin e aktgjyimit të gjykatës së shkallës së parë nuk janë theksuar elementet e kësaj veprë penale së pari se si ka vepruar i dënuari përkatësisht a ka qenë personi që ka urdhëruar apo ka zbatuar urdhrin për të vepruar ndaj të dëmtuarit.”, thuhet në vendim.

Tutje, thuhet se në dispozitivin e aktgjyimit të gjykatës së shkallës së parë është përshkruar se “...kanë shkuar tek shtëpia e tij dhe e kanë privuar nga liria...”, mirëpo, duke marrë parasysh se dispozita e nenit 142 të ish LPJ-së, ka përcaktuar se objekt mbrojtës i kësaj veprë penale është popullata civile përkatësisht popullata që në asnjë formë nuk është e involvuar në konfliktin e armatosur dhe se vepra penale kryhet në mënyrë alternative, përkatësisht ekzistojnë disa forma të kryerjes së saj, megjithatë nuk është përcaktuar se ndër format e veprimit është edhe privimi nga liria, kurse pikërisht për këtë veprim është shpallur fajtor i dënuari.

“Nga të gjitha këto, Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se aktgjykimi i shkallës së parë është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nënpar.12 lidhur me nenin 370 par.7 të KPPK-së, të cilat shkelje nuk janë eliminuar me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë dhe me këtë kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë ishte e bazuar, që rezultoi me marrjen e vendimit për anulimin e aktgjykimeve të kundërshtuara dhe shqyrtim të serishëm të kësaj çështje”, thotë vendimi.

Sipas Supremes, në rigjykim gjykata e shkallës së parë duhet të veprojë në pajtim me vërejtjet e dhëna në këtë aktgjykim dhe të administroj provat ekzistuese e sipas nevojës edhe prova tjera e pas kësaj të marrë një vendim të drejtë dhe të ligjshëm në këtë çështje penalo juridike.

“Në rend të parë duhet të eliminoj paqartësitë e zhvillimit të ngjarjes, përkatësisht të vërtetoj hollësisht dhe saktësisht mënyrën e veprimit të të dënuarit, përkatësisht të sqarohet në mënyrë të plotë dhe të drejtë forma e veprimit të tij se a ka qenë personi që ka dhënë urdhra apo personi që ka zbatuar urdhëratë për veprimet e ndërmarra kundër popullatës civile dhe më konkretisht ndaj të dëmtuarit, meqë këto paraqesin elementet qenësore të figurës së veprës penale krime të luftës kundër popullatës civile të ndëshkueshme sipas dispozitës së nenit 142 të ish LPJ-së, meqë me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, nuk rezulton se janë qartësuar dhe arsyetuar mjaftueshëm”, thuhet në vendim.¹³⁶

¹³⁶ “Supremja e kthen në shkallë të parë rastin për krime lufte ndaj ish-komandatit “Molla e Kuqe”. Betimi për Drejtësi. 26 maj 2020. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/supremja-e-kthen-ne-shkalle-te-pare-rastin-per-krime-lufte-ndaj-ish-komandatit-molla-e-kuqe/>). (Qasur së fundi me 6 gusht 2020).

7. Rasti Zoran Vukotiq I

Gjykata Themelore në Mitrovicë

Numri i lëndës: P.nr.54/2017

Vepra penale: “Krimet e luftës në shkelje të rëndë të nenit 3 të përbashkët të konventave të Gjenevës”, “Krimet e luftës në shkelje të rëndë të ligjeve dhe zakoneve që zbatohen në konfliktet e armatosura që nuk janë të karakterit ndërkombëtar”, ushtrimi i ndikimit”

Kryetari i Trupit Gjykses: Arnout Louter

Prokuror special: Paul Flynn

I pandehur: Zoran Vukotiq

Faza e procedurës: Në proces pas kthimit në rigjykim

Nga ngritja e aktakuzës e deri me 31 maj 2020 kanë kaluar 1137 ditë apo 3 vite, 1 muaj e 11 ditë

Hetimet për të akuzuarin Vukotiq kishin filluar me 11 nëntor 2016, në të njëjtën ditë kur atij i ishte caktuar masa e paraburgimit prej një muaji, ndërsa pas pesë muajsh me 20 prill 2017 ishte ngritur aktakuza.

Sipas aktakuzës së ngritur nga PSRK-ja, i akuzuari Zoran Vukotiq në mes të datave 2 dhe 3 maj 1999, në kapacitetin e tij si zyrtar policor rezervist nga stacioni policor në Vushtrri, në bashkëpunim me persona të tjerë nga radhët e forcave serbe, ka marrë pjesë në sulmin ndaj popullatës civile shqiptare e cila po udhëtonte në kolonë nga fshati Studime e Poshtme në Studime të Epërme.

Në vazhdim të aktakuzës thuhet se gjatë kësaj kohe, popullata civile në mënyrë të qëllimshme u është nënshtruar vrasjeve brutale dhe të paligjshme, trajtimit johuman, vuajtjeve të pafundme, dëbimit si dhe aplikimit të masave të terrorit.

Bazuar në aktakuzë në mesin e këtyre civilëve të vrarë, plagosur dhe të trajtuar në mënyrë johumane për çfarë i pandehuri Zoran Vukotiq mban përgjegjësi, janë, Ekrem Mullaku, Xhavit Mullaku, Fatmir (Ahmet) Gërxhaliu, Eshref Rashica, Adnan Bunjaku, Rrahmon Ademi, një 14 vjeçar i painedentifikuar, Haki Ademi, Shaip Gërxhaliu, Musa Gërxhaliu, Bajram Gërxhaliu, Bahrije Gërxhaliu dhe Avdi Gërxhaliu.

Ai gjithashtu akuzohet se në periudhën maj deri në fillim të qershorit 1999, si një rezervist në stacionin policor në Vushtrri, si një roje burgu, në bashkëpunim me anëtarë të tjerë të forcave serbe, ka marrë pjesë në paraburgimin e paligjshëm të një numri të madh të civilëve shqiptarë në burgun e Smrekonicës në rajonin e Mitrovicës, gjatë së cilës periudhë këta civilë i'u ekspozuan qëllimisht trajtimit çnjerëzor, vuajtjeve të mëdha, torturave dhe rrahjeve për të cilat i akuzuari Zoran Vukotiq, mban përgjegjësi personalisht.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit:

Pasi aktakuza ishte ngritur me 20 prill 2017, shqyrtimi fillestar ishte mbajtur me 29 maj 2017,

apo 39 ditë nga dita e ngritjes së aktakuzës, pra 9 ditë pas afatit ligjor edhe pse ishte dashur të mbahej brenda afatit prej 30 ditësh nga ngritja e aktakuzës, siç është përcaktuar me KPPK.

Pas disa seancave të mbajtura, me 23 maj 2018, kishte përfunduar gjykimi në këtë rast, ku prokurori i rastit Paul Flynn kishte kërkuar një dënim të merituar, në mënyrë që të pasqyrohen krimet e kryera nga ana e të akuzuarit Vukotiq. Ndërsa mbrojtësi i të akuzuarit Vukotiq, avokati Nebojsa Vlajiq kishte kërkuar që i mbrojturi i tij të lirohet nga akuza, pasi sipas tij dëshmitë e dëshmitarëve kishin qenë kontradiktore. Lirim nga akuza kishte kërkuar edhe vet i akuzuari Vukotiq, i cili kishte deklaruar se asnjëri dëshmitar nuk kishte mundur të identifikojë atë si kryes të krimeve për të cilat po akuzohet.¹³⁷

Me 25 maj 2018, Gjykata Themelore në Mitrovicë, Vukotiqin e kishte shpallur fajtor për pikën 3 të aktakuzës, duke u dënuar me 6 vjet e 6 muaj burgim, për krime lufte kundër popullatës civile të sanksionuara me konventat e Gjenevës. Sipas gjykatësit Louter, atij do t'i llogaritet koha e kaluar në paraburgim nga 10 marsi 2016, e derisa ky aktgjykim të merr formën e prerë. Ndërkaq, i akuzuari Vukotiq, ishte liruar nga akuza për pikën 1, që e ngarkonte atë për pjesëmarrje në vrasjen e civilëve shqiptarë në fshatin Studime të Vushtrisë. Sipas kryetarit të trupit gjykues, Arnout Louter, nuk ishte vërtetuar se i akuzuari Vukotiq, ka kryer veprën penale.¹³⁸

Me 18 dhjetor 2018, Gjykata e Apelit kishte shqyrtuar ankesat e palëve lidhur me aktgjykimin e shkallës së parë. PSRK, kishte kërkuar nga Apeli që Vukotiq të dënohet edhe për pikën e aktakuzës nga e cila ishte liruar në shkallë të parë, si dhe rritje të dënimit për pikën 3 të aktakuzës për çka Vukotiq ishte shpallur fajtor, kurse mbrojtja kishte propozuar që të akuzuarin ta lirojë nga akuzat apo t'i shqiptojë një dënim më të butë.¹³⁹

Në maj 2019, Gjykata e Apelit e kishte kthyer rastin në rigjykim të pjesshëm duke e aprovuar ankesën e PSRK-së. Kështu, Apeli e kishte kthyer në rigjykim rastin sa i përket pikës I të aktakuzës, që e ngarkonte Vukotiqin për pjesëmarrje në vrasjen e civilëve shqiptarë në fshatin Studime të Vushtrisë, e nga e cila pikë, Vukotiq ishte liruar nga shkalla e parë. Kurse, për pikën II të aktakuzës, Gjykata e Apelit i'a ka vërtetuar dënimin e shqiptuar prej gjashtë vjet e gjashtë muaj të akuzuarit Vukotiq, pasi nuk ka gjetur shkelje në këtë pjesë, dhe si rrjedhojë ankesat i ka refuzuar si të pa bazuara.

“Siç rezulton nga përmbajtja e aktgjykimit të ankimuar, gjykata e shkallës së parë aktgjykimin lirues përveç në mbrojtjen e të akuzuarit e mbështetë edhe në dëshmitë e dëshmitarëve të dhëna në shqyrtimin gjyqësor, por pa dhënë arsye të mjaftueshme dhe konkrete përse gjykata nuk i

¹³⁷ “Përfundon gjykimi në rastin e dytë për krime lufte ndaj Zoran Vukotiq, prokuroria kërkon dënimin e tij, mbrojtja lirim nga akuza”. Betimi për Drejtësi. 23 maj 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/perfundon-gjykimi-ne-rastin-e-dyte-per-krime-lufte-ndaj-zoran-vukotiq-prokuroria-kerkon-denimin-e-tij-mbrojtja-lirim-nga-akuza/>). (Qasur së fundi me 6 gusht 2020).

¹³⁸ “Zoran Vukotiq dënohet me gjashtë vjet e gjysmë burgim për një rën pikë të aktakuzës për krime lufte”. Betimi për Drejtësi. 25 maj 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/zoran-vukotiq-denohet-me-gjashte-vjet-e-gjysme-burgim-per-njeren-pike-te-aktakuzes-per-krime-lufte/>). (Qasur së fundi me 6 gusht 2020).

¹³⁹ “Shqyrtohen në Apel ankesat e palëve në rastin e të dënuarit për krime lufte, Zoran Vukotiq”. Betimi për Drejtësi. 18 dhjetor 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/shqyrtohen-ne-apel-ankesat-e-paleve-ne-rastin-e-te-denuarit-per-krime-lufte-zoran-vukotiq/>). (Qasur së fundi me 6 gusht 2020).

ka marr parasysh deklaratat e dëshmitarëve të dhëna në fazat e mëparshme të procedurës paraprake, në polici dhe prokurori, të cilat janë dhënë në një kohë relativisht të shkurtër pas ngjarjes kritike, kur edhe dëshmitaret e kanë pasur memorien e freskët dhe kanë qenë më të sigurt në deklaratimet e tyre për ngjarjet e luftës, por edhe lidhur me kryerësit, gjegjësisht identifikimin e të akuzuarit sepse janë dhënë pas disa muajve ose pak vjet pas luftës.”, thuhet në arsyetimin e aktgjykimit të Apelit.¹⁴⁰

Pas kthimit në rigjykim rasti i është ndarë gjykatësit Bekim Veliqi.

¹⁴⁰ “*Kthehet pjesërisht në rigjykim rasti ndaj të akuzuarit për krime lufte, Zoran Vukotiq*”. Betimi për Drejtësi. 5 prill 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/kthehet-pjeserisht-ne-rigjykim-rasti-ndaj-te-akuzuarit-per-krime-lufte-zoran-vukotiq/>). (Qasur së fundi me 6 gusht 2020).

8. Rasti Zoran Vukotiq II

Gjykata Themelore në Mitrovicë

Numri i lëndës: P.nr.67/2017

Vepra penale: “Ushtrim i ndikimit”, “Krimet e luftës në shkelje të rëndë të ligjeve dhe zakoneve që zbatohen në konfliktet e armatosura që nuk janë të konfliktit ndërkombëtar”, “Fshehja ose moslajmërimi i terroristëve dhe grupeve terroriste”

Kryetari i Trupit Gjykses: Dariusz Sielicki

Prokuror : Paul Flynn

I pandehur: Zoran Vukotiq

Faza e procedurës: Në proces pas kthimit në rigjykim

Nga ngritja e aktakuzës deri më 31 maj kanë kaluar 1111 ditë apo 3 vite e 15 ditë

Sipas aktakuzës së ngritur nga PSRK, Zoran Vukotiq, gjatë kohës së luftës në Kosovë, më 5 maj 1999, në Vushtrri, i pandehuri i lartcekur në bashkëkryerje me të pandehurin Guroljub Paunoviq, në cilësinë e rezervistit në policinë serbe, të veshur me uniforma të policisë dhe ushtrisë serbe, si dhe të armatosur me thika, pistoleta dhe pushkë automatike, kanë plaçkitur persona civilë shqiptarë nëpër oborre dhe shtëpitë e tyre.

Bazuar në aktakuzë, Vukotiq dhe Paunoviq, me dashje i rrahin dhe pastaj i vrasin katër personat civilë shqiptarë, të identifikuar si Enver Rustolli, Hamdi Fazliu, Avdulla Fazliu dhe Fahredin Fazliu.

Gjithmonë sipas aktakuzës, katër të lartpërmendurit fillimisht janë rrahur dhe maltretuar nga rezervistët serbë në prani të Sanije Fazliut dhe Fikrije Fazliut, ku më pas në prani të tyre nga një afërsi kanë shtënë me armë në gjoks në Enver Rustollin, dhe pastaj vazhdojnë të shtënat me armë në kokë dhe në gjoks në tre personat e tjerë, Avdullah, Fahredin dhe Hamdi Fazliun, dhe nga ky veprim, sipas aktakuzës, dalin dhe largohen nga shtëpia.

Po ashtu, në kuadër të kësaj aktakuze, Zoran Vukotiq, në bashkëkryerje, akuzohet se në mënyrë ç’njëzore ka cenuar integritetin trupor, shëndetin, mirëqenien fizike dhe mendore të të dëmtuarve dhe dëshmitarëve, duke i torturuar, Sanije Fazliu, Fikrije Shaqiri, Vehbi Xhema, Zejnepe Xhema, Nexhmi Xham, Besart Xhema, Zeliha Xhema, Behar Pllana, Luljeta Rashica, Gani Maxhera, Halim Maxhera, Gazmend Shabani, Ahbet Sahiti, Skender Shabani, Bejt Osmani, Shukrije Osmani dhe Faik Musa, të cilët sipas kësaj aktakuze, janë rrahur me grushte, shqelma dhe mjete të tjera të forta, në pjesë të ndryshme të trupit, duke iu shkaktuar dhimbje të rënda fizike dhe mendore, pasoja të cilat të dëmtuarit e lartcekur i bartin edhe sot.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

Në këtë rast, aktvendimi për fillim të hetimeve është nxjerrë më 30 maj 2014. Hetimet janë ndërprerë më 18 mars të vitit 2016. Pasi që Vukotiq ishte arrestuar meqenëse kishte pasur fletë arrest ndërkombëtar të lëshuar ndaj tij, hetimet janë hapur sërish me 9 mars 2017. Përderisa me 16 maj 2017 ishte bërë përpilimi i akuzës nga ana e prokurorit Elez Blakaj.

Me 4 gusht 2017 është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar, kurse me 30 shtator, gjykata e shkallës së parë e kishte refuzuar kërkesën për hedhje të aktakuzës të parashtruar nga ana e mbrojtjes.

Me 7 shkurt 2018, në gjykatore janë dëgjuar dëshmitarët Gani e Halim Maxhera, të cilët kanë treguar se si më 5 maj të vitit 1999, janë rrahur në shtëpinë e tyre në Vushtrri, nga dy persona të armatosur, njëri i quajtur Guroljub Paunoviq dhe një tjetër, për të cilin kanë thënë se ishte me maskë. Halim Maxhera, kishte thënë se këtë ditë pasi që ishin dëgjuar disa të shtëna, kishte kuptuar se ishin vrarë fqinjët e tij, Abdullah, Hamdi, Fahredin Fazliu si dhe Enver Rustolli. I pyetur nga prokurori Flyyn, nëse e di se kush i ka vrarë ata, dëshmitari ishte përgjigjur se ata i kishte vrarë Zoran Vukotiq, duke shtuar se këtë e kishte kuptuar më vonë nga rrethi. Ai kishte thënë se e kishte parë, kur Paunoviq dhe Vukotiq, djalin e quajtur Fahredin, e kishin dërguar në shtëpinë e Hamdi Fazliut, dhe nga aty ishin dëgjuar katër të shtëna të njëpasnjëshme.¹⁴¹

Në seancën e 21 shkurtit të vitit 2017, dëshmitarja Sanije Fazliu, kishte deklaruar se Avdullah Fazliu ishte vrarë nga Zoran Vukotiq, ndërsa tha se Enver Rustolli, Hamdi dhe Fahredin Fazliu ishin vrarë nga Guroljub Paunoviq. Ajo kishte thënë se në fillim nuk i ka njohur me emra personat të cilët dhunshëm kishin hyrë në shtëpinë e saj, por ajo tha se nga bashkëshorti i saj, Bedriu e kishte kuptuar se kishin qenë Zoran Vukotiq dhe Guroljub Paunoviq, ngase sipas saj, Bedriu ka punuar në qebaptore ku i ka njohur më parë dhe i ka parë kur kanë hyrë në shtëpi. Gjatë kësaj seance ishte dëgjuar edhe një dëshmitar tjetër para trupit gjykues.¹⁴²

Me 20 mars 2018, ishte dëgjuar dëshmitarja Fikrije Shaqiri, e cila në fund të dëshmisë së saj, para trupit gjykues të përbërë nga gjykatësit e EULEX-it, kishte identifikuar të akuzuarin Zoran Vukotiq, për të cilin kishte thënë se është personi që i ka vrarë të afërmit e saj, duke thënë se sikur i akuzuari ta dinte se do ta mbante në mend, do ta vriste edhe atë.¹⁴³

Më 21 mars, kishin dëshmuar vëllezërit Vehbi dhe Nexhmi Xhama, Dëshmitari Vehbi Xhema, gjatë dëshmisë së tij, kishte treguar në detaje për rrahjet, torturat dhe kërcënimet me jetë që u'a kishin bërë dy personat e armatosur, për të cilët ka thënë se kanë qenë Zoran Vukotiq dhe Guroljub Paunoviq. Kurse, Nexhmi Xhema, kishte thënë se atë ditë ishte kërcënuar me vdekje nga ana e Zoran Vukotiq, nën kërcënimin se nëse nuk i jep para, do ta vras e se përveç tij, i akuzuari Zoran Vukotiq i kishte kërcënuar edhe me jetën e djalit të tij, dy vjeç e gjysmë, të cilit

¹⁴¹ “Dëshmitari thotë se njëri ndër policët që i ka vrarë katër finjët e tij ka qenë Zoran Vukotiq”. Betimi për Drejtësi. 7 shkurt 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/deshmitari-thote-se-njeri-nder-policet-qe-i-ka-vrare-kater-finjet-e-tij-ka-qene-zoran-vukotiq/>). (Qasur së fundi me 6 gusht 2020).

¹⁴² “Dëshmitarja thotë se Vukotiq dhe Paunoviq para syve të saj ia vranë të afërmit”. Betimi për Drejtësi. 21 shkurt 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/deshmitarja-thote-se-vukotiq-dhe-paunoviq-para-syve-te-saj-ia-vrane-te-afermit/>). (Qasur së fundi me 6 gusht 2020).

¹⁴³ “Gjykimi për krime lufte ndaj Zoran Vukotiq, dëshmitarja thotë se në prani të saj ia vranë bashkëshortin dhe të afërmit”. Betimi për Drejtësi. 20 mars 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/gjykimi-per-krime-lufte-ndaj-zoran-vukotiq-deshmitarja-thote-se-ne-prani-te-saj-ia-vrane-bashkeshortin-dhe-te-afermit/>). (Qasur së fundi me 6 gusht 2020).

tha se ia ka vendosur thikën në fyt.¹⁴⁴ Edhe me 22 e 27 mars, në gjykatore janë dëgjuar dëshmitarë.

Kurse, me 14 maj, ka dhënë mbrojtjen e tij i akuzuari Vukotiq. Ai kishte deklaruar se tij se nuk ka qenë në dijeni se më 5 maj të vitit 1999, në qytetin e Vushtrrisë, janë vrarë katër civilë shqiptarë. Vukotiq, më pas nuk kishte pranuar të tregojë emrat e komandantëve të policisë serbe dhe as të kolegëve të tij, me të cilët ka patrulluar në qytetin e Vushtrrisë, duke thënë se nuk do dhe nuk ka ndonjë arsye tjetër pse nuk pranon t'i tregojë këta emra. Ndërkaq, kishte thënë se nuk e di saktë se ku ka qenë më 1 dhe 2 maj të vitit 1999.

Ai kishte thënë se detyrë e tij ka qenë patrullimi në qytetin e Vushtrrisë dhe jo në fshatra, duke cekur se e kanë pasur të ndaluar të largohen nga qyteti i Vushtrrisë pa lejen e eprorëve të tij, për të cilët nuk pranoi të tregoi se kush kanë qenë.

Gjatë marrjes në pyetje nga prokurori Paul Flynn, Vukotiq është shprehur se familja e tij nuk është sulmuar nga UÇK-ja dhe se nuk ka humbur asnjë anëtar të familjes në luftën e vitit 1999. Ai më pas ka treguar se në momentin kur është mobilizuar, atij i është dhënë një armë automatike dhe një revole, ndërsa sa i përket furnizimit me municion është shprehur se ajo procedurë është kryer në stacionin policor duke cekur se sipas tij, nuk ka qenë e lejuar të përdoret municioni pa dijeninë e eprorëve të tij. Ndërkaq, përveç marrjes në pyetje të të akzuarit Zoran Vukotiq, trupi gjykues i kryesuar nga Dariusz Sielicki, paraprakisht në këtë seancë, ka marrë në pyetje edhe një herë dëshmitarin kyç të këtij rasti, Bedri Fazliun, lidhur me disa detaje dhe sqarime për shtëpitë e lagjes “Emin Duraku”, ku pretendohet se janë vrarë Enver Rustolli, Hamdi Fazliu, Avdulla Fazliu dhe Fahredin Fazliu. Duke iu referuar hartës në të cilën paraqitet lagjia “Emin Duraku”, tani “Haxhi Zeka” në Vushtrri, dëshmitari në pika të shkurtra ka treguar rrugën të cilën sipas tij, e kanë ndjekur Zoran Vukotiq dhe Guroljub Paunoviq, më 5 maj të vitit 1999, përderisa dëshmitari Bedri Fazliu po fshihej nga njëra shtëpi e lagjes në tjetrën. Ai më pas ka evidentuar me numra shtëpitë e viktimave në këtë rast dhe pozicionet e të akzuarit Vukotiq dhe Paunoviq, gjatë kohës kur në këtë lagje nga Vukotiq dhe Paunoviq janë rrahur, torturuar dhe vrarë civilë shqiptarë.¹⁴⁵

Më 15 maj 2018, ishte mbajtur fjala përfundimtare, ku prokurori dhe mbrojtësi i viktimave kanë kërkuar dënimin e Zoran Vukotiq, kurse mbrojtja lirimin e tij nga akuza.¹⁴⁶

Të nesërmen, me 16 maj, Vukotiq në mungesë të provave ishte liruar nga kjo akuzë. Sipas kryetarit të trupit gjykues, Dariusz Sielicki, fajësia duhet të provohet përtej dyshimit të bazuar. Trupi gjykues në arsyetimin e dhënë në prani të palëve, kishte thënë se nuk ka pasur dyshime

¹⁴⁴ “Dëshmitarët: Pasi që i kishin vrarë finjët tanë, Vukotiq dhe Paunoviq na rrahën e torturuan”. Betimi për Drejtësi. 21 mars 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/deshmitaret-pasi-qe-i-kishin-vrare-finjet-tane-vukotiq-dhe-paunoviq-na-rrahen-e-torturuan/>). (Qasur së fundi me 6 gusht 2020).

¹⁴⁵ “Zoran Vukotiq jep mbrojtjen e tij, thotë se nuk ishte në dijeni për vrasjen e katër civilëve shqiptarë”. Betimi për Drejtësi. 14 maj 2018 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/zoran-vukotiq-jep-mbrojtjen-e-tij-thote-se-nuk-ishte-ne-dijeni-per-vrasjen-e-kater-civileve-shqiptare/>). (Qasur së fundi me 6 gusht 2020).

¹⁴⁶ “Prokurori dhe mbrojtësi i viktimave kërkojnë dënimin e Zoran Vukotiq, mbrojtja lirimin nga akuza për krime lufte”. Betimi për Drejtësi. 15 maj 2018 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/prokurori-dhe-mbrojtja-i-viktimave-kerkojne-denimin-e-zoran-vukotiq-mbrojtja-lirimin-nga-akuza-per-krime-lufte/>). (Qasur së fundi me 6 gusht 2020).

për faktet të cilat kanë ndodhur më 5 maj të vitit 1999. Në arsyetimin e trupit gjykues thuhet se dëshmitarëve u është paraqitur fotografia e të akuzuarit Vukotiq, e cila i takon mjetit të tij identifikues, e cila sipas trupit gjykues, ishte bërë disa vite para ditës kritike. Lidhur me këtë, trupi gjykues në prani të palëve tha se nga të gjithë dëshmitarët, vetëm dy kanë arritur ta identifikojnë të akuzuarin Zoran Vukotiq, duke cekur më pas se kjo ka ngritur dyshimin se dorasi i vërtetë ka ngjashmëri të madhe me të akuzuarin. Më pas kryetari i trupit gjykues, gjykatësi Sielicki, kishte thënë se trupi gjykues i ka refuzuar disa prej deklaratave të dëshmitarëve të cilët e kanë njohur të akuzuarin Vukotiq, si të pa mbështetshme.¹⁴⁷

Ndryshe, përveç këtij rasti, i akuzuari Zoran Vukotiq është duke u gjykuar edhe për dy aktakuza të tjera, njëra për vrasjen e një 13 vjeçari në Vushtrri dhe për vrasjet brutale dhe keqtrajtimet ç'njerëzore ndaj civilëve shqiptarë në kolonën e fshatit Studime, më 2 dhe 3 maj të vitit 1999 dhe vuajtjeve të mëdha, torturave dhe rracheve në burgun e Smrekonicës në maj deri në qershor të vitit 1999. Më pas, Gjykata e Apelit, më 9 janar 2019, këtë rast e kishte kthyer në rigjykim, pas ankesës së PSRK-së dhe sipas detyrës zyrtare.

“Duke gjetur që në këtë mënyrë është bërë shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale, të cilat rezultojnë edhe në vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, u vendos që aktgjykimi i shkallës së parë, të anulohet, ashtu që në shqyrtimin e serishëm gjyqësor të eliminohen shkeljet në fjalë, duke marrë parasysh edhe pretendimet tjera ankimore, e sidomos ato që kanë të bëjnë me dëshmitë e dëshmitarëve, sidomos ato të dhëna në fazat e mëhershme, duke sqaruar pastaj faktet përkitazi me rrethanat e identifikimit në polici dhe atë duke marrë parasysh, përveç deklaratave të dëshmitarëve që e identifikojnë të akuzuarin edhe deklaratat e dëshmitarëve që mohojnë një gjë të tillë, por kuptohet, duke bërë një vlerësim të argumentuar e të bindshëm të gjitha deklaratave, krejt kjo me qëllim të eliminimit, të kundërtënëve përkitazi me identifikimin, e të akuzuarit, e pastaj, të vendoset në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme”, thuhet në vendim të Apelit.¹⁴⁸

Pas kthimit në rigjykim rasti i është ndarë gjykatësit Bekim Veliki.

¹⁴⁷“Zoran Vukotiq lirohet nga akuza për krime lufte”. Betimi për Drejtësi. 16 maj 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/lirohet-nga-akuza-per-krime-lufte-zoran-vukotiq/>). (Qasur së fundi me 6 gusht 2020).

¹⁴⁸ Vendimi i Gjykatës së Apelit, 9 janar 2019.

18. Historiku i disa rasteve të tjera të krimeve të luftës

1. Rastet Drenica 1 dhe Drenica 2

Të akuzuar në këtë rast ishin, Sylejman Selimi, Sami Lushtaku, Sahit Jashari, Ismet Haxha, Sabit Geci, Avni Zabeli dhe Jahir Demaku, Agim Demaj, Bashkim Demaj, Driton Demaj, Selman Demaj, Fadil Demaku, Jahir Demaku, Nexhat Demaku, Zeqir Demaku dhe Isni Thaqi.

Për shkak të numrit të madh të akuzuarve, rasti ishte ndarë në dy pjesë: “*Drenica 1*” ku bënë pjesë Sylejman Selimi, Sami Lushtaku, Sahit Jashari, Ismet Haxha, Sabit Geci, Avni Zabeli dhe Jahir Demaku, si dhe “*Drenica 2*”, ku bënë pjesë Agim Demaj, Bashkim Demaj, Driton Demaj, Selman Demaj, Fadil Demaku, Jahir Demaku, Nexhat Demaku, Zeqir Demaku, Sylejman Selimi dhe Isni Thaqi.

Aktakuza e ngritur nga ana e EULEX-it, pretendonte ekzistencën e një qendre të paraburgimit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) ku, thuhej se anëtarët e UÇK-së kishin kryer krime lufte kundër popullatës civile, ndër të tjera kryerjen me dashje të dhunës, trajtimin mizor, rrahjen, torturën dhe poshtërimin dhe trajtimin degradues kundër civilëve shqiptarë të Kosovës të paraburgosur në objektin e paraburgimit të UÇK-së në Likoc, të gjitha gjoja që kanë ndodhur në gusht dhe shtator 1998.

Akuzat e ngritura nga prokuroria, kishin të bënë me Krime Lufte kundër Popullsisë Civile të parashikuara dhe të dënuara nga Nenet 22 dhe 142 të KPRSFJ-së (aktualisht kriminalizuar sipas Neneve 31 dhe 152 të KPRK-së), në kundërshtim me Nenin 3 të Përbashkët me Konventat e Gjenevës dhe me Neni 4 i Protokollit Shtesë II, të gjitha këto janë rregullat e së drejtës ndërkombëtare efektive në kohën e konfliktit të brendshëm të armatosur në Kosovë.

Pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor në këtë rast, me 27 maj 2015 ishte shpallur aktgjykimi në këtë rast. Sipas komunikatës për media në ueb-faqe të Eulex-it, thuhet se gjyqtarët kanë vendosur se Lushtaku është fajtor për veprën penale “vrasje” dhe është dënuar me 12 vjet burgim. Kurse, Sylejman Selimi është fajtor për veprën penale “Krime të Luftës duke e shkelur rëndë Nenin 3 i përbashkët për Konventat e Gjenevës” dhe është dënuar me gjashtë vjet burgim. Kurse, thuhet se të gjithë të pandehurit tjerë janë liruar nga akuzat, pasi pretendimet kundër tyre nuk janë vërtetuar.¹⁴⁹

Pas ankesave në Gjykatë të Apelit, më 15 shtator 2016, paneli i përbërë nga dy gjyqtarë të EULEX-it dhe një gjyqtar kosovar ka ndryshuar këtë aktgjykim.

Ankesat e parashtruara në emër të pandehurve janë pranuar pjesërisht dhe në përputhje me këtë janë ndryshuar edhe aktgjykimet përkatëse, ku Sami Lushtaku është dënuar me 7 vite burgim dhe duke marrë parasysh dënimet e shqiptuara më parë në rastin e njohur si “Drenica II të datës 14 shtator 2016, Sylejman Selimit i është shqiptuar një dënim i përgjithshëm prej 10 vjet

¹⁴⁹ “Aktgjykimi për rastin Drenica 1”. Eulex – Kosovo. 27 maj 2015. (Shih linkun <https://www.eulex-kosovo.eu/?page=1,10,228>).

burgim. Kurse, të pandehurit Jahir Demaku i ka shqiptuar dënim të përgjithshëm prej 7 vitesh burgim.¹⁵⁰

Në korrik të 2017, Gjykata Supreme e Kosovës, kishte njoftuar për aktgjykimin e nxjerr në këtë rast. Sipas këtij aktgjykimi të Supremes, nga 10 vjet burgim, sa ishte dënuar nga Gjykata e Apelit, Selimit i është ulë dënimi në 8 vjet.

“Trupi gjykues nuk ka gjetur prova të mjaftueshme që e provojnë përtej dyshimit të bazuar përgjegjësinë komanduese të Sami Lushatakut dhe Sylejman Selimit mbi qendrën e ndalimit në Likoc”, thuhej në njoftimin e Supremes.

Kurse, është refuzuar si e pa bazuar ankesa e mbrojtjes së Jahir Demakut. Ndërsa, më 3 korrik, kjo gjykatë e kishte liruar tërësisht nga akuzat, ish-kryetarin e Skenderajt, Sami Lushtaku.

“Në lidhje me ankesat në shkallë të tretë, trupi gjykues e liroi Sami Lushtakun nga të gjitha pikat e akuzës; kjo ishte arsyeja që masa e paraburgimit kundër tij ishte ndërprerë disa javë më parë. Dënimi i Sylejman Selimit, ishte ndryshuar sepse ai ishte liruar për pikën IX lidhur me përgjegjësinë komanduese mbi qendrën e ndalimit në Likoc.

Megjithatë, dënimi i shqiptuar nga Gjykata e Apelit në lidhje me pikën IV (rrahja e një personi të pidentifikuar nga rajoni i Shipolit) ishte vërtetuar përkritazi me Sylejman Selimin dhe Jahir Demakun. Rrjedhimisht, Sylejman Selimit i ishte shqiptuar dënimi i ndryshuar prej tetë (8) vjet, ndërsa ishte vërtetuar dënimi i mëparshëm ndaj të pandehurit Jahir Demaku prej pesë (5) vjet burgim”, thuhej ndër të tjera në njoftimin e Supremes.¹⁵¹

Sa i përket rastit “Drenica 2”, Gjykata Themelore në Mitrovicë, në maj të vitit 2015, kishte shpallur fajtor dhe kishte dënuar me tetë vjet (8) burg Sylejman Selimin për keqtrajtim të të ndaluarve në fshatin Likoc gjatë luftës. Bashkë me Selimin, Isni Thaçi dhe Jahir e Zeqir Demaku ishin dënuar me nga shtatë vjet (7) burg, ndërsa me tri (3) vjet burg ishte dënuar Nexhat Demaku. Me nga tre (3) vjet burgim ishin dënuar edhe Agim, Selman, Driton e Bashkim Demajt dhe Fadil Demakut.

Në shtator të vitit 2016, Gjykata e Apelit, duke vendosur lidhur me ankesat e të akuzuarve kishte nxjerrë aktgjykim, duke vërtetuar në masë të madhe dënimet e shqiptuara nga Gjykata në Mitrovicë. Mirëpo, Gjykata e Apelit i kishte zbutur dënimin me një vit burg Sylejman Selimit. Gjykata Supreme, kishte refuzuar kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë nga ana e të dënuarve, mirëpo, Gjykata Kushtetuese në qershor të 2018-të, e kishte kthyer rastin në

¹⁵⁰ “Aktgjykimi për rastin Drenica 1”. Gjykata e Apelit. (Shih linkun <https://apeli.gjyqesori-rks.org/2016/11/16/aktgjykimi-ne-rastin-drenica-i/>). (Qasur së fundi me 6 gusht 2020).

¹⁵¹ “Supremja ia ulë dënimin për dy vjet Sylejman Selimit”. 25 korrik 2017. Betimi për Drejtësi. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/sylejman-selimit-supremja-ia-ule-denimin-per-dy-vjet/>). (Qasur së fundi me 6 gusht 2020).

rishqyrtim Gjykatës Supreme. E Gjykata Supreme, sërish kishte vendosur të refuzoj kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitura nga ana e mbrojtësve të të dënuarve.¹⁵²

Kurse, në vitin 2019, Sylejman Selimi ishte liruar nga paneli për lirim me kusht. Ndërkaq, Gjykata Kushtetuese kishte vendosur për kërkesën e Zeqir Demaku, Jahir Demaku, Fadil Demaku, Nexhat Demaku, Isni Thaçi, Bashkim Demaj, Selman Demaj, Driton Demaj dhe Agim Demaj, ku objekt i çështjes së kërkesës ishte vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës të datës 26 shtator 2018, me të cilin parashtruesit e kërkesës pretendonin se u janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 24 „Barazia para ligjit”, nenin 31, “E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm” të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, lidhur me nenin 6 “E drejta për një proces të rregullt” të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, si dhe me nenin 53 “Interpretimi i dispozitave për të drejtat e njeriut” të Kushtetutës.

Parashtruesit e kërkesës kanë kërkuar njëherësh nga Gjykata Kushtetuese që të vendosë masë të përkohshme, përkatësisht “të ndaloj ekzekutimin e vendimit të kontestuar” Ata, gjithashtu kanë kërkuar nga Gjykata që të vendosë masë të përkohshme, përkatësisht të bëjë “pezullimin e procedurës së ekzekutimit të dënimeve nga Gjykata Themelore në Mitrovicë lëndët me numër ED: 123, 125, 126 dhe 127, deri në vendosje të kësaj lëndë nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës”.

Kurse, gjykata, me vendim unanim të gjyqtarëve dhe në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 20 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe me rregullat 39(1)(a), 39(2) dhe 59(2) të Rregullores së punës, vendosi të deklarojë kërkesën të papranueshme. Gjykata Kushtetuese kishte vendosur të refuzojë kërkesën për masë të përkohshme në pajtim me nenin 27 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe me rregullin 57 të Rregullores së punës.¹⁵³

¹⁵²“ *Lirohet nga burgu ish-komandanti i UÇK-së, Sylejman Selimi*”. Betimi për Drejtësi. 25 janar 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/lirohet-nga-burgu-ish-komandanti-i-uck-se-sylejman-selimi/>). (Qasur së fundi me 6 gusht 2020).

¹⁵³ *Njoftimi i Gjykatës Kushtetuese*. (Shih linkun <https://gjk-ks.org/vendimet-nga-seanca-shqyrtuese-e-mbajtur-me-13-nentor-2019/>). (Qasur së fundi me 6 gusht 2020).

2. Rasti Kleçka

Për krime lufte, më 25 korrik 2011, aktakuzë ishte ngritur edhe kundër dhjetë ish-pjesëtarëve të UÇK-së: Arben Krasniqi, Naser Krasniqi, Nexhmi Krasniqi, Behlul Limaj, Fatmir Limaj, Refki Mazreku, Naser Shala, Sabit Shala, Shaban Shala, Besim Shurdhaj.

Fatmir Limaj dhe nëntë pjesëtarët e tjerë të UÇK-së u akuzuan për krime lufte kundër popullatës civile dhe krime lufte kundër të burgosurve të luftës, që siç supozohej të jenë kryer nga fillimi i vitit 1999, deri në mesin e qershorit të atij viti, në një qendër të improvizuar paraburgimi nga UÇK-ja, e që ndodhej në fshatin Kleçkë. Në këtë rast, në shkallë të parë, të akuzuarit ishin liruar nga akuza. Me aktgjykimin e datës 20 mars 2012 të Gjykatës së Qarkut, Arben Krasniqi, Behlul Limaj, Refki Mazreku, Sabit e Shaban Shala, si dhe Besim Shurdhaj ishin liruar nga akuzat që u viheshin në barrë.

Kurse, me aktgjykimin e datës 2 maj të vitit 2012, po ashtu ishin liruar nga akuza edhe Naser e Nexhmi Krasniqi, si dhe Fatmir Limaj e Naser Shala. E Gjykata Supreme, kishte marrë parasysh ankesat e organit të ndjekjes, duke i anuluar këto dy aktgjykime

Pas, rigjyimit, sërish, në vitin 2013, të akuzuarit ishin liruar nga akuza. Më 26 janar 2016, Gjykata e Apelit kishte konfirmuar aktgjykimin e shkallës së parë, duke konfirmuar sërish lirim të tyre nga akuza.

Kurse, me 12 maj të vitit 2017, Gjykata Supreme ka refuzuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë ndaj të akuzuarve në rastin “Kleçka”, e cila ishte parashtruar më 12 gusht 2016, nga Zyra e Prokurorit të Shtetit të Republikës së Kosovës. Kjo kërkesë, ishte parashtruar kundër aktgjyimit të Gjykatës së Apelit, i cili ishte marrë më 26 janar 2016.¹⁵⁴

¹⁵⁴ “Përfundon rasti “Kleçka”, refuzohet kërkesa e Prokurorisë”. Betimi për Drejtësi. 24 maj 2017. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/perfundon-rasti-klecka-refuzohet-kerkesa-e-prokuroris/>). (Qasur së fundi me 6 gusht 2020).

3. Rasti Oliver Ivanoviq etj.

Më 11 gusht 2014, EULEX-i kishte ngritur aktakuzën ndaj Dragoljub Delibashiq, Nebojsa dhe Ilija Vujaçiq, Aleksandar Llazoviq. Në këtë gjykim ishin mbajtur mbi 60 seanca gjyqësore.

Oliver Ivanoviq akuzohej për Krime lufte kundër popullatës civile, për shkelje serioze të nenit 3 & 1(a) i përbashkët për katër Konventa të Gjenevës të 12 gushtit 1949 lidhur me Mbrojtjen e Personave Civil në Kohë Lufte dhe nenin 4 & 2(a) të Protokollit Shtesë II lidhur me Mbrojtjen e Viktimave në Konfliktet e Armatosura Jo-Ndërkombëtare të 8 qershorit 1977, në pajtim me nenin 152 & 1 dhe 2.1 në lidhje me nenet 16 dhe 32 të Kodit Penal të Kosovës (KPK) dhe i dënueshëm gjithashtu edhe në kohën e kryerjes së veprës sipas nenit 142 të Kodit penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë të 28 shtatorit 1976 dhe më tutje në bashkëkryerje me Dragoljub Delibashiq për veprën penale të: Nxitjes për të kryer veprën penale të vrasjes së rëndë në formë të privimit nga jeta të një personi tjetër për shkak të motiveve kombëtare, në bashkë-kryerje dhe në pajtim me nenin 179 (1.10) në lidhje me nenin 31 dhe 32 të KPK dhe i dënueshëm gjithashtu edhe në kohën e kryerjes së veprës penale sipas nenit 30 Paragrafit (2) të LPKSAK-së në lidhje me nenet 22 dhe 23 të KP të RSFJ-së; nxitje për të kryer veprën penale të vrasjes së rëndë në tentativë në formë të privimit nga jeta të një personi tjetër për shkak të motiveve kombëtare, duke rezultuar në lëndim të rëndë trupor në bashkëkryerje, në pajtim me nenin 179 (1.10) dhe nenin 189 (2.1) dhe (5) në lidhje me nenet 28, 31 të KPK-së, dhe të dënueshëm gjithashtu edhe në 4 kohën e kryerjes së veprës penale sipas nenit 30 paragrafit (2) dhe nenit 38 paragrafit (2) të LPKSAK-së në lidhje me nenet 19, 22 dhe 23 të KP të RSFJ-së; nxitje për të kryer veprën penale të vrasjes së rëndë në tentativë në formë të privimit nga jeta të një personi tjetër për shkak të motiveve kombëtare në bashkëkryerje, në pajtim me nenin 179 (1.10) në lidhje me nenet 28, 31 dhe 32 të KPK-së, dhe të dënueshëm gjithashtu edhe në kohën e kryerjes së veprës penale sipas nenit 30 paragrafit (2) të LPKSAK-së në lidhje me nenet 19, 22 dhe 23 të KP të RSFJ-së.

Si dhe, Nebojsa dhe Ilija Vujaçiq si dhe Aleksandar Llazoviq për ‘Vrasje e rëndë’ në formë të privimit nga jeta të një personi tjetër për shkak të motiveve kombëtare në bashkëkryerje, në pajtim me nenin 179 (1.10) në lidhje me nenin 31 të KPK-së dhe të dënueshëm gjithashtu edhe në kohën e kryerjes së veprës penale sipas nenit 30 paragrafit (2) të LPKSAK-së në lidhje me nenin 22 të KP të RSFJ-së; ‘Vrasje e rëndë në tentativë’ në formë të privimit nga jeta të një personi tjetër për shkak të motiveve kombëtare në bashkëkryerje, duke rezultuar në lëndim të rëndë trupor në bashkëkryerje, në pajtim me nenin 179 & 1.10 dhe 189 & 2.1 dhe 5 në lidhje me nenin 28 dhe 31 të KPK-së dhe të dënueshëm gjithashtu edhe në kohën e kryerjes së veprës penale sipas nenit 30 & 2 dhe nenit 38 & 2 të LPKSAK-së në lidhje me nenin 19 dhe 22 të KP të RSFJ-së; ‘Vrasje e rëndë në tentativë’ në formë të privimit nga jeta të një personi tjetër për shkak të motiveve kombëtare në bashkëkryerje, në pajtim me nenin 179 & 1.10 në lidhje me nenin 28 dhe 31 të KPK-së dhe të dënueshëm gjithashtu edhe në kohën e kryerjes së veprës penale sipas nenit 30 & 2 të LPKSAK-së në lidhje me nenin 19 dhe 22 të KP të RSFJ-së.

Për ngjarjen e ndodhur me 14 prill 1999 në Jug të Mitrovicës, Ivanoviq, është gjetur fajtor për veprën penale të “Krimeve të Luftës kundër Popullatës Civile” të dënueshme sipas nenit 142

të Kodit Penal të Republikës Federative të Jugosllavisë (KP të RSFJ-së) dhe në shkelje të nenit 3 & 1(a) e përbashkët për katër Konventa të Gjenevës të datës 12 gusht 1949 lidhur me Mbrojtjen e Personave Civil në Kohë Lufte dhe nenit 4 & 2(a) të Protokollit Shtesë II lidhur me Mbrojtjen e Viktimave të Konfliktit të Armatosur Jo-Ndërkombëtar të datës 8 qershor 1977 dhe është dënuar nëntë vite burgim.

Gjykata ka gjetur se Ivanoviqi është përgjegjës për ngjarjen që kishte ndodhur në datën 14 prill të vitit 1999, në Mitrovicë, ku gjatë veprimeve të forcave paramilitare policore serbe ishin vrarë shqiptarët Fatmir Mustafa, Skender Paqarada, Avni Abazi dhe Mehmet Seferi.

Sipas vendimit të gjykatës, Ivanoviq ishte në dijeni për operacionin e dëbimit dhe vrasjes së shqiptarëve civil etnik dhe plotësisht kompetent në aspektin mendor. Tutje, thuhet se nuk ka mundur të vërtetohet përtej dyshimit të arsyeshëm se kur ka ndërmarr një gjë të tillë, Ivanoviq ka vepruar në cilësinë e një udhëheqësi të një njësie paramilitare/policore serbe dhe se ka nxitur grupin e paramilitarëve duke i urdhëruar ata për të kryer vrasje.

Për ngjarjet që kishin ndodhur me 3 shkurt 2000, veri të Mitrovicës, në orët e mbrëmjes, ku kishte ndodhur një shpërthim në kafiterinë “Bel Ami”, duke lënduar një numër serbësh. Pak kohë më vonë, në orët e natës, grupe spontane të serbëve hynë në ndërtesën që ndodhej në rrugën Knjaz Miloš, rrugën Lola Ribar, rrugën Tanaska Rajić, rrugën Sutjeska 8 dhe rrugën Kralja Petra e banuar nga familje të kombësisë shqiptare, me qëllim të dëbimit të tyre dhe kanë vrarë dhjetë persona, Ivanoviq ishte liruar nga akuza.

Për këtë ngjarje nga akuza ishte liruar edhe Dragoljub Delibashiq, si dhe Nebojsa dhe Ilija Vujaçiq, Aleksandar Llazoviq.¹⁵⁵

Gjykata e Apelit, këtë rast e kishte kthyer në rigjykim, vetëm lidhur me akuzën për krime lufte kundër popullatës civile ndaj të akuzuarit Ivanoviq.

Pas kthimit në rigjykim dhe procedimit të procedurës së rigjykimit, seancat e shqyrtimit kryesor ishin ndërprerë, kjo për arsye se prokurori kishte dorëzuar me 11 prill 2017, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kundër vendimit të Apelit në lidhje me pikën 1. Më 24 maj të vitit 2017, Gjykata Supreme e kishte hedhur poshtë kërkesën e prokurorit.

Me 7 dhjetor 2017, ishte bërë ndryshimi i aktit akuzues nga ana e prokurorit, ku akuzohej për krime kundër njerëzimit ishte akuzuar për tentim vrasje, vrasje, depërtim ose zhvendosje e dhunshme e popullatës. Kurse, si krime të luftës ishte akuzuar për vrasje, tentim vrasje, shpërngulje ose zhvendosje të dhunshme si dhe për persekutim.

Me 28 prill 2017, prokurori kishte paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë për të akuzuarit Oliver Ivanoviqin dhe Dragoljub Delibashiqin, lidhur me pikën 2 të aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të datës 19 dhjetor të vitit 2016, ku kërkesa e prokurorit ka pasur të bëjë me

¹⁵⁵ “Aktgjykimi i shkallës së parë”. (Shih linkun <https://www.eulex-kosovo.eu/eul/repository/docs/P. 98-14 - Jugment dated 30 March 2016 - Albanian Redacted.pdf>). (Qasur së fundi me 6 gusht 2020).

veprën penale nxitje për kryerje të veprës penale të vrasjes. Gjykata Supreme, me 28 prill korrik të po të njëjtit vit e kishte refuzuar kërkesën e prokurorit si të pabazë.

Ivanoviq, i cili ka qenë kryetar i Nismës Qytetare “Liri, Demokraci, Drejtësi”, është vrarë më 16 janar 2018, para selisë së partisë së tij, në Mitrovicën Veriore.

Për këtë arsye, Gjykata Themelore në Mitrovicë, zyrtarisht e kishte pushuar procedurën penale ndaj Ivanoviq¹⁵⁶.

¹⁵⁶ “Gjykata Themelore në Mitrovicë zyrtarisht pushon ndjekjen penale ndaj Oliver Ivanoviq”. Betimi për Drejtësi. 14 shkurt 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/gjykata-themelore-ne-mitrovice-zyrtarisht-pushon-ndjekjen-penale-ndaj-oliver-ivanoviq/>). (Qasur së fundi me 6 gusht 2020).

4. Rasti i “Komandant Remit” dhe “Komandant Latës”.

Në vitin 2002 ishte ngritur aktakuzë për krime lufte ndaj popullatës civile për njëmbëdhjetë (11) pika ndaj Latif Gashit “Komandat Lata”, Nazif Mehmeti me nofkë “Drini, Naim Kadriut me nofkë “Lumi”, si dhe Rustem Mustafës me nofkën “Komandant Remi”.

Në vitin 2003, gjykata e shkallës së parë kishte gjetur se janë provuar disa pika të caktuara të aktakuzës, përderisa për disa akuza të pandehurit ishin liruar. Për pikat e akuzës që ishin shpallur fajtor, të akuzuarve u ishin shqiptuar këto dënime: Rustem Mustafës, dënim me burg prej 17 vitesh, Nazif Mehmetit 13 vite, Latif Gashit i ishte shqiptuar dënim me burgim prej 10 vitesh, ndërkaq për Naim Kadriun ishte shqiptuar dënimi me pesë (5) vite burgim.

Të akuzuarit ishin ankuar në gjykatën e shkallës së dytë për pikat që janë shpallur fajtor, ndërkaq prokurori për dënimin e shqiptuar ndaj të akuzuarit Gashi. Gjykata e shkallës së dytë, rastin e kishte kthyer në rigjykim dhe kishte gjetur se disa veprime në disa pika të akuzës nuk kanë përbërë vepër penale, dhe se nuk ka prova se të akuzuarit kishin kryer vrasje, për të cilat ishin ngarkuar me anë të pikës 11 të aktit akuzues.

Më 2 tetor 2009, ishte shpallur aktgjyrimi i dytë i shkallës së parë pas rigjykimit, ku Latif Gashit i ishte shqiptuar dënim unik me burgim prej gjashtë (6) viteve, Rustem Mustafës, i ishte shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej katër (4) viteve, kurse Nazif Mehmetit i ishte shqiptuar dënim me burgim prej tri (3) viteve.

Pasi, prokurori kishte hequr dorë nga ndjekja penale për një pikë të aktakuzës që lidhej me Gashin e Mustafën ishte marrë aktgjykim refuzues. Kurse, procedura penale ishte pushuar ndaj Naim Kadriut, që kishte humbur jetën. Edhe ndaj këtij vendimi të shkallës së parë, mbrojtja e kishte ankimuar aktgjykimin në shkallë të dytë, ku më pas shkalla e dytë pjesërisht e kishte konfirmuar aktgjykimin e shkallës së parë të pjesës dënuese sipas dy pikave të aktakuzës, kurse për një pikë të akuzës e kishte kthyer lëndën në rigjykim.

Ndërkaq, në rigjykimin e dytë, më 7 qershor 2013, Latif Gashi ishte dënuar me gjashtë (6) vite burgim, Rustem Mustafa me katër (4) vite burgim, kurse Nazif Mehmeti me tre (3) vite burgim.

Pas ankesave në shkallë të dytë, gjykata e shkallës së dytë kishte refuzuar ankesën e Nazif Mehmetit të cilën e kishte konsideruar si të pabazuar. Kurse, ankesat e Rustem Mustafës e Latif Gashit, pjesërisht i kishte pranuar, kjo sa i përket kohës së kaluar në paraburgim, ku e njëjta me anë të këtij vendimi kishte llogaritur kohën e kaluar në paraburgim në dënimet e shqiptuara.

E më pas, sa i përket kërkesave për mbrojtje të ligjshmërisë, kërkesën që vet i akuzuari, Mehmeti e kishte parashtruar ishte konsideruar si e parashtruar jashtë afatit ligjor andaj ishte refuzuar. Ndërkaq, kërkesat e parashtruara për tre të pandehurit nga ana e avokatëve të tyre, ishin konsideruar të pabazuara, andaj si të tilla edhe ishin refuzuar

19. Rekomandimet

1. Institucionet kushtetuese dhe partitë politike në Republikën e Kosovës të ndërpresin praktikën e amnistimit të krimeve të luftës në Kosovës, përmes mos veprimit.
2. Partitë politike dhe institucionet kushtetuese të reflektojnë në raport me kërkesat e familjarëve të viktimave të luftës për të dhënë drejtësi lidhur me krimet e luftës në Kosovë.
3. Kuvendi i Republikës së Kosovës, si institucioni më i rëndësishëm kushtetues në Republikën e Kosovës, të miratojë strategjinë për hetimin dhe gjykimin e krimeve të luftës.
4. Republika e Kosovës të forcojë me kapacitete njerëzore dhe profesionale Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës, Gjykatat, Policinë, mbrojtësit e viktimave të krimit për të zhvilluar hetime, ndjekje dhe gjykim të pavarur, paanshëm dhe të drejtë të rasteve të krimeve të luftës.
5. Republika e Kosovës të ndaj buxhet të mjaftueshëm për institucionet përkatëse për të adresuar krimet e luftës në Kosovë.
6. Kuvendi i Kosovës përmes Strategjisë së miratuar të përcaktojë objektiva të qarta që institucionet përkatëse duhet të përmbushin në raport me adresimin e krimeve të luftës, ngritjen e përgjegjësisë dhe llogaridhënies në trajtimin e këtyre lëndëve.
7. Republika e Kosovës të ngritë bashkëpunimin me institucionet e Republikës së Kroacisë për të përfituar nga përvoja dhe ekspertiza e policëve, prokurorëve, gjykatësve dhe mbrojtësve të viktimave, duke përfshirë trajnimin dhe specializimin e zyrtarëve përkatës në Kosovë.
8. Sistemi prokurorial i Kosovës brenda një afati sa më të shkurtë kohor të dal me raport të detajuar për të informuar publikun lidhur me numrin e lëndëve për krime lufte që ka në punë, përfshirë raport të detajuar lidhur me numrin e lëndëve që ka marr në punë nga EULEX.